

ARTAK MOVSISJAN



# HISTORIA E ARMENISË





ARTAK MOVSISJAN

# HISTORIA E ARMENISË



Tiranë, 2019

Përktheu dhe përshtati nga origjinali: Berzh Piranjani

Redaktoi: Berzh Piranjani

Art Grafik: Orest Muça

Mundësuan botimin:

Berzh dhe Varuzhan Piranjani

Tirazhi: 100 kopje

ISBN: 978-9928-05-266-7

# PËRMBAJTJA E LËNDËS

<b>PJESA E PARË: KOHËT E LASHTA</b> .....	9
<b>KREU 1.</b> Atdheu i Armenëve.....	11
1. Malësitë Armene.....	11
2. Ndarjet politiko-administrative bazë të Armenisë historike .....	13
<b>KREU 2.</b> Lindja e kombit Armen .....	15
1. Legjendat që flasin për lindjen e kombit Armen.....	15
2. Historia e lindjes së kombit Armen sipas Historiografisë moderne.....	18
3. Të dhëna të vjetra historike mbi Armeninë dhe popullin Armen .....	18
<b>KREU 3.</b> Armenia në perceptimin shpirtëror të Lindjes së Lashtë .....	21
<b>KREU 4.</b> Armenia në mijëvjeçarin 3-2 para Krishtit.....	27
1. Organizimi i parë shtetëror. Aratta .....	27
2. Mbishkrimet më të vjetra të njohura ku shfaqen emërtimet “Armenia”; Armi, Armen(um), Aram.....	28
3. Mbretërimi njëqindvjeçar i Kutiakanit (Kordvacit).....	29
4. Malësitë Armene në shekujt XX-XVII para Krishtit .....	29
5. Mbretëria Mittani .....	30
6. Mbretëria Hajasa.....	31
7. Tokat Najiriane .....	32
<b>KREU 5.</b> Mbretëria e Vanit (Najiri, Biajnili, Urartu, Ararat) .....	33
<b>KREU 6.</b> Armenia ndën pushtetin e Dinastisë Hajkazun-Jervandun deri në vitin 331 para Krishtit .....	39

<b>PJESA E DYTË: KOHËT E VJETRA</b> .....	45
<b>KREU 7.</b> Mbretëritë Armene në vitet 331-201 para Krishtit .....	47
1. Aleksandri i Maqedonisë dhe Armenia .....	47
2. Historia e Aleksandrit dhe Armenia .....	49
3. Mbretëritë Armene dhe zotërimi Seleucid.....	49
<b>KREU 8.</b> Mbretëritë Armene në shekullin e II para Krishtit .....	53
1. (Armenia e Madhe, Armenia e Vogël, Xopku, Kummageni).....	53
2. Armenia e Madhe në kohën e sundimit të Artashesit të I.....	53
3. Mbretëritë e tjera Armene në shekullin e II para Krishtit .....	56
<b>KREU 9.</b> Armenia në kohën e sundimit të Tigranit të Madh (Tigranit të II) .....	59
1. Mbretëria e Tigranit të Madh .....	60
2. Qendrat e banuara të themeluara nga Tigrani i Madh .....	62
3. Lufta Romako-Armene. Beteja e Artashatit .....	63
<b>KREU 10.</b> Armenia në periudhën e rënies së Dinastisë Artashesiane .....	65
<b>KREU 11.</b> Mbretëria e Armenisë së Madhe në shekujt I-III .....	71
<b>KREU 12.</b> Besimi Armen paraKristian .....	77
1. Besimet e Hershme.....	77
2. Perënditë shtetërore Armene .....	78
3. Karakteristikat kryesore të besimeve të vjetra Armene .....	80
<b>KREU 13.</b> Kultura Armene paraKristiane .....	83
1. Kultura e Shkrimit para krijimit të Alfabetit Mashtotcian .....	83
2. Historia .....	84
3. Arkitektura.....	85
4. Astronomia.....	86
5. Folklori .....	87
6. Teatri .....	88
<b>PJESA E TRETË: PERIUDHA E MESJETËS</b> .....	89
<b>KREU 14.</b> Shfaqja e Krishterimit në Armeni .....	91
1. Hyrja e Krishterimit në Armeni në shekujt I-III .....	92
2. Shpallja e Krishterimit si fe zyrtare dhe organizimi i pavarur i Kishës Armene.....	93

<b>KREU 15.</b> Mbretëria Arshakuniane e shekujve IV-V .....	95
<b>KREU 16.</b> Luftërat për çlirim të Armenisë në shekullin e V .....	101
1. Beteja për liri e Armenisë e vitit 450-451 .....	101
2. Beteja për liri e Armenisë e vitit 481-484.....	103
<b>KREU 17.</b> Armenia në shekujt VI-IX .....	107
1. Armenia Lindore në shekullin e VI .....	107
2. Armenia Perëndimore në shekullin e VI .....	108
3. Fushatat Arabe dhe pushtimi i Armenisë.....	109
4. Kryengritjet Armene të shekujve VIII-IX kundër sundimit Arab .....	110
<b>KREU 18.</b> Kultura Armene në shekujt IV-VIII .....	113
<b>KREU 19.</b> Armenia në periudhën e mbretërisë Bagratuni .....	119
<b>KREU 20.</b> Fushatat e Turqve-Selxhukë në Armeni.....	125
1. Principata e Zakarianëve.....	125
<b>KREU 21.</b> Mbretëria Armene e Kilikisë (Cilicisë) .....	129
1. Principata Armene e Kilikisë.....	129
2. Shpallja e Mbretërisë. Levoni i II .....	130
3. Mbretëria Armene e Kilikisë në vitet 1219-1375 .....	132
<b>KREU 22.</b> Kultura Armene në shekujt IX-XIV.....	135
<b>KREU 23.</b> Armenia nga shekulli i XV deri në mesin e shekullit të XVII .....	139
1. Përpjekjet për çlirimin e Armenisë nga jashtë saj.....	140
2. Gjendja e Kulturës .....	141
<b>PJESA E KATËRT: KOHA E RE</b> .....	145
<b>KREU 24.</b> Lëvizja çlirimtare Armene nga mesi i shekullit të XVII deri në fundin e shek. të XVIII. Krijimi i Armenisë Lindore në pjesën Ruse ....	147
1. Lëvizja çlirimtare Armene në gjysmën e dytë të shekullit të XVII.....	147
2. Aktiviteti i Israel Oriit.....	148
3. Beteja çlirimtare e viteve 1722-1730 në Arcah dhe Sjunik .....	148
4. Beteja çlirimtare Armene në gjysmën e dytë të shekullit të XVIII.....	149
5. Pushtimi i Armenisë Lindore nga ana e Rusisë.....	151

<b>KREU 25.</b> Çështja Armene dhe lufta çlirimtare Armene në vitet 1878-1914.....	153
1. Lufta Ruso-Turke e viteve 1877-1878. Ndërkombëtarizimi i çështjes Armene.....	153
2. Krijimi i grupeve për çlirim kombëtar dhe i partive politike Armene.....	154
3. Lëvizja Fedaiste (guerile).....	155
4. Lëvizjet çlirimtare dhe çështja Armene në vitet 1894-1896.....	156
5. Armenia Lindore në fillim të shekullit të XX.....	157
6. Armenia Perëndimore në fillim të shekullit të XX.....	158
<b>KREU 26.</b> Genocidi Armen (1894-1923).....	161
1. Programi i asgjësimit të Armenëve .....	162
2. Realizimi i Genocidit Armen.....	163
3. Gjyqi i organizatorëve të Genocidit .....	165
<b>KREU 27.</b> Fronti Kaukazian në Luftën e Parë Botërore.	
Betejat vetëmbrojtëse të popullit Armen gjatë vitit 1915 .....	167
1. Fronti Kaukazian në Luftën e Parë Botërore.....	167
2. Lëvizja vullnetare Armene.....	168
3. Betejat vetëmbrojtëse të Armenëve të vitit 1915.....	169
<b>KREU 28.</b> Revolucionet Ruse të vitit 1917 dhe Armenia.	
Shpallja e Republikës Armene.....	173
1. Revolucioni Rus i Shkurtit 1917 dhe Armenia .....	173
2. Revolucioni Rus i Tetorit 1917 dhe Armenia .....	174
3. Fushata Turke e vitit 1918 dhe betejat heroike të Majit 1918 .....	175
4. Rimëkëmbja e Pavarësisë së Armenisë .....	177
<b>KREU 29.</b> Kultura Armene nga shekullit XVIII të deri në fillim të shekullit XX .....	179
1. Armenologjia.....	180
2. Letërsia.....	181
3. Arti .....	182
<b>KREU 30.</b> Republika e Armenisë (1918-1920).....	185
1. Rilindja e shtetit Armen. Gjendja e brendshme e Republikës së Armenisë .....	186
2. Trazirat e brendshme .....	187
3. Situata e jashtme e Republikës së Armenisë.....	188
4. Rënia e Republikës së Armenisë .....	189
<b>KREU 31.</b> Çështja Armene në vitet 1919-1923. Problemi i kufijve të Armenisë .....	191
1. Çështja Armene në Kongresin e Parisit dhe në Konferencën e San Remos.....	191

2. Traktati i Sevres dhe zgjidhja arbitrare e Udrou Uillsonit ..... 192
3. Çështja Armene në Traktatin e Londrës dhe të Lozanës..... 193
4. Çështja e kufijve të Armenisë Sovjetike në vitin 1921 ..... 193

**KREU 32.** Populli Armen në vitet e Luftës së Dytë Botërore..... 197

1. Armenia në prag të Luftës së Dytë Botërore ..... 197
2. Pjesëmarrja e Armenëve në Luftën e Dytë Botërore në përbërje të BRSS (Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike) ..... 198
3. Pjesëmarrja e Diasporës Armene në Luftën e Dytë Botërore ..... 199
4. Bashkëpunimi i detyrueshëm i Armenëve me rregjimin Hitlerian ..... 200

**KREU 33.** Beteja e Arcahut për liri. Rivendosja e Pavarësisë së Armenisë. .... 203

1. Zgjimi kombëtar në vitet 1960-1980 ..... 203
2. Lufta e Armatosur në emër të Gjqit Armen ..... 204
3. Etapa e re e betejës për çlirimin e Arcahut..... 205
4. Shpallja e Pavarësisë së Republikës së Armenisë ..... 207

**KREU 34.** Kultura Armene nga viti 1918 deri në ditët e sotme ..... 209

1. Kultura në Republikën Socialiste Sovjetike të Armenisë në vitet 1920-1945 ..... 209
2. Jeta kulturore në Republikën Socialiste Sovjetike të Armenisë pas Luftës së Dytë Botërore..... 211
3. Kultura në Diasporën Armene ..... 214

**ANEKSE**

**Harta shoqëruese dhe ilustruese të tekstit**

- Harta 1 (Ilustrimi i Kreut 1)..... 216  
Armenia sipas “Gjeografia” e shekullit V-VII
- Harta 2 (Ilustrimi i Kreut 4)..... 217  
Azia Perëndimore në shekujt XXIV-XXII para Krishtit
- Harta 3 (Ilustrimi i Kreut 5)..... 218  
Mbretëria e Vanit
- Harta 4 (Ilustrimi i Kreut 7)..... 219  
Fushatat e Aleksandrit të Madh dhe Armenia
- Harta 5 (Ilustrimi i Kreut 8)..... 220  
Armenia në shekullin e II para Krishtit
- Harta 6 (Ilustrimi i Kreut 9)..... 221  
Mbretëria e Tigranit të Madh
- Harta 7 (Ilustrimi i Kreut 15) ..... 222  
Armenia në vitet 298 deri 387

Harta 8 (Ilustrimi i Kreut 16) .....	223
Beteja e Vartanit për lirinë e Armenisë e viteve 450 - 451	
Harta 9 (Ilustrimi i Kreut 17) .....	224
Armenia në shekujt VII-IX	
Harta 10 (Ilustrimi i Kreut 19) .....	225
Mbretëria Bagratide në periudhën e Ashotit të I dhe Simbatit të I	
Harta 11 (Ilustrimi i Kreut 20) .....	226
Principata e Zakarianëve	
Harta 12 (Ilustrimi i Kreut 21) .....	227
Shteti Armen i Kilikisë në periudhën e Levonit të Madhërishtëm	

PJESA E PARË

# KOHËT E LASHTA



## KREU 1

# ATDHEU I ARMENËVE

### Malësitë Armene

Atdheu i Armenëve janë Malësitë Armene. Gjeografikisht, ajo është hapësira ku ka lindur dhe për mijëra vjet ka vazhduar të jetojë, të krijojë dhe të ndërtojë historinë dhe kulturën e tij populli Armen. Ato zënë pjesën më të madhe të hapësirës që shtrihet ndërmjet Detit të Zi, Detit Kaspik dhe Detit Mesdhe. Duke ju referuar të vërtetës historike, studiuesit evropianë atë hapësirë në shekullin XIX e emërtuan Malësitë Armene. Malësitë Armene ndodhen ndërmjet Azisë së Vogël dhe rrafshnaltave Iraniane. Nga jugu ato kufizohen me Mesopotaminë, nga veriu me Detin e Zi dhe luginën e lumit Kur. Hapësira e Malësive Armene zë një sipërfaqe rreth 400 mijë km<sup>2</sup>.

Lartësia mesatare e Malësisë mbi nivelin e detit është 1500-1800 metra. (Shënim i imi: në të gjitha rastet e mëposhtëme ku do të haset termi “Malësia Armene”, të kihet parasysh, që shpreh të njëjtin kuptim, që shpreh termi “Malësitë Armene”). Duke iu referuar ultësirave që e rrethojnë, ai ngjan si një ishull malor.

Maja më e lartë e Malësisë është Masisi (Ararati i madh), i cili është 5165 metra i lartë, nga ku merr fillësin dhe vazhdon në drejtim të perëndimit vargmali Armen, i cili e ndan Malësinë Armene në dy pjesë, në atë Veriore dhe Jugore.

Nga jugu, si fortësa natyrale të vargmalit shërbejnë Taurusi, Masiusi

(Masioni) dhe Kordvaci, nga jug-lindja është Armenakani (Karadaku), nga perëndimi është Antitaurusi, nga veri-perëndimi janë vargmalet e Pontakanit (Pontosit). Nga ana veri-lindore shpatet e Malësive Armene bien mbi lumin Kur.

Ndërmjet majave të larta të vargmalit ka edhe rrafshina pjellore. Më e madhja prej tyre është fusha e Araratit, njihen gjithashtu edhe rrafshinat e Mshoj-it, Shirak-ut, Alashkert-it, Harberd-it, etj.

Malësia Armene është shumë e pasur me rezerva ujore. Ndër liqenet Armenë, më i madhi është liqeni Urmia (i cili në kohët e vjetra quhej Deti i Kaltër), ku për shkak të niveleve të larta të kripës nuk rriten peshq. I dyti për nga madhësia është liqeni Van (në kohët e vjetra quhet Deti i Najirit, Deti i Kripur, Deti Pëznutiac, liqeni Haikai, etj.), i cili sot ka katër ishuj (nga të cilët më i madhi është Aghtamar-i). Edhe ai gjithashtu e ka ujin shumë të kripur dhe brenda tij rritet vetëm një lloj peshku, Harenga (Cërraga). I vetmi ndër liqenet e mëdhenj, i cili ka ujë të ëmbël dhe një shumëllojshmëri peshqish, dhe që sot ndodhet brenda territorit të Republikës së Armenisë, është liqeni Sevan (Deti Kehama ose Deti Keharkuniac). Ky liqen ka patur një ishull, i cili gjatë periudhës së qeverisjes sovjetike, për shkak të uljes së nivelit të liqenit, u shndërrua në gadishull.

Malësia është e pasur me liqene te madhësive te vogla dhe mesatare, si Deti i Veriut (tashmë Çildër), Arçishak (Arçak, sot Erçek), Xovk (sot Hazar), Parvanan, etj. Nga malësitë marrin fillesë shumë lumenj të mëdhenj të Azisë Perëndimore, si Eufrati, Tigri, Araksi (ose Jeras'h), Kur, Çoroh, Halis, Çahan, të cilët derdhen në Detin Persik, në Detin Kaspik, në Detin e Zi dhe në Detin Mesdhe. Brenda Armenisë, Eufrati përbëhet nga dy degë, dega perëndimore dhe lindore (Araxan). Po kështu është i formuar edhe lumi Tigër (Tigri lindor quhet gjithashtu edhe Xherm).

Duke filluar që nga kohët e lashta, Malësitë Armene kanë qenë të njohura për botën e pasur bimore dhe shtazore, dhe për shumëllojshmërinë e mineraleve të dobishme.

### **Ndarjet politiko-administrative bazë të Armenisë historike.**

Armenët e quajnë atdheun u tyre Haik ose Hajastan; të huajt atë e quanin Aratta-Ararat-Urtu, Arman(um)-Armina-Armenia-Ermanistan, Kuti(um), Nairi, Somheti, etj. Të tërë organizimet shtetërore Armene, me përjashtim të shtetit Armen të Kilikisë, ndodheshin brenda kufijve gjeografikë të Malësive Armene. Kufijtë e shtetit dhe të Malësive Armene megjithatë asnjëherë nuk kanë korresponduar me njëra-tjetrën. Për shembull: Armenia e madhe, duke zënë pjesën më të madhe të Malësisë Armene, në anën lindore përfshin krahinën e Pajtakaranit, e cila ndodhet jashtë kufijve të Malësive Armene. Armenia e vogël në perëndim kap dhe toka të cilat shtrihen në perëndim të Eufratit. Në periudhën rreth III mijëvjeçare të ekzistencës së shtetit Armen, brenda saj ndodhej edhe Kilikia e cila praktikisht ishte jashtë Malësive Armene. Duke marrë në konsideratë gjithë sa më sipër, hapësira e ndodhur ndërmjet Detit të Zi, Detit Kaspik dhe Detit Mesdhe, në përgjithësi konsiderohet me emërtimin Armenia historike.

Armenia historike, përgjatë kohës, ka patur ndarje të ndryshme administrative-politike. Prej tyre, katër ishin më të rëndësishmet: Armenia e Madhe, Armenia e Vogël, Komageni dhe Kilikia.

Sipas gjeografit grek, Ptolemeut (shekulli I - II i erës sonë), hapësira e Armenisë së Madhe ishte e ndarë në 20 krahina. Sipas hartës Armene, ajo ishte e ndarë në 15 krahina ose shtete: Armenia e Lartë, Xopk (Sophene), Ahcnik, Turuberan, Mok, Korçajk, Parskahajk (Armenia Perse), Vaspurakan, Sjunik, Arcah (Arcakh – Artsackh; prej këtu e tutje – Arcah), Pajtakaran, Utik, Gugark, Tajk dhe Ajrarat. Nga ana e tyre këto njësi ndaheshin në provinca, numri i përgjithshëm i të cilave shkonte në rreth 200.

Kufiri natyral ndërmjet Armenisë së Madhe dhe Armenisë së Vogël ishte Eufrati Perëndimor. Nga ana jugore në Armeninë e Vogël përfshihej edhe krahina e Malatisë (duke pasur në kufi majat e maleve Armene të Taurusit), kurse nga veriu sipas kronikanit Grek Straboni (shekulli I - II para Krishtit), arrinte deri në Detin e Zi, duke përfshirë edhe dhe Trabazonin dhe Parnakian.

Komageni (Kamah, Kumaha, Kumuh) ndodhet në skajin fundor jug-perëndimor të Malësive Armene, në shpatet jugore të maleve të Taurusit Armen, duke pasur si kufi në anën lindore lumin Euftrat. Ai në mijëvjeçarin e II para Krishtit dhe në kohën e mbretërisë së Vanit (Urartu, Ararat) ka qenë një mbretëri e vogël e pavarur, duke qenë aleati i këtij të fundit. Në periudhën e Jervantunëve (deri në vitin 201 para Krishtit) ai ka qenë i përfshirë në përbërje të mbretërisë Armene, pastaj nga viti 163 para Krishtit deri në vitin 72 pas Krishtit ekzistoi si një mbretëri e pavarur Armene, e udhëhequr nga një degë e Jervantunëve.

Kilikia ndodhet në bregun verilindor të Detit Mesdhe; nga veriu ajo kufizohet me malet e Taurusit Kilikian, kurse nga lindja me malet e Amanosit. Në anën verilindore, Kilikia kufizohet me Komagenin. Pavarësisht pranisë Armene në Kiliki që në kohë shumë të hershme, principata Armene e Kilikisë u shndërrua si mbretëri në Mesjetë, në shekujt XI - XIV. Pas kësaj ajo u bë një pjesë e pandashme e botës Armene ku, edhe pas Genocidit, Armenët e mbijetuar (së bashku me bashkësitë e tjera të krishtera) shpallën Republikën me 4 Gusht 1920.

Aktualisht, Republika e Armenisë ka një sipërfaqe rreth 30.000 km<sup>2</sup>, kurse Republika e Nagorno-Karabakut së bashku me zonat e çliruara prej saj, ka një sipërfaqe rreth 12.500 km<sup>2</sup>.

Republika e Armenisë shtrihet në hapësirat që i përkisnin Ajraratit të Armenisë së Madhe, Sjunikut, Gugarkut dhe Utikut, ndërsa Republika e Nagorno-Karabakut shtrihet në hapësirat që i përkisnin Arcahut, Sjunikut dhe Utikut.

## KREU 2

# LINDJA E KOMBIT ARMEN

Ku e ka origjinën kombi Armen, kur është formuar si një bashkim etnik i pavarur dhe në çfarë kohe përmendet si i tillë në shkrimet e gjetura në monumentet më të vjetra. Për t'i dhënë përgjigje këtyre pyetjeve, fillimisht duhet të kthehemi prapa në kohë, në legjendat që na kanë mbërritur të shkruajtura nga shekujt e kohëve të vjetra dhe të mesme dhe më pas historisë së lindjes së kombit Armen sipas fakteve të dala në dritë nga studimet shkencore të ditëve të sotme.

### **Legjendat që flasin për lindjen e kombit Armen**

Ka shumë legjenda me shkrim, lidhur me historinë e lindjes së kombit Armen, që i përkasin periudhave të hershme dhe shumë të hershme kohore. Legjendat Armene janë krijuar që në kohë shumë të hershme dhe deri tek ne kanë arritur falë shkrimit “Historia e Armenisë” të Moisi Horenacit (Movses Horenatsi).

Në periudhat e paraKrishterimit, paraardhësit e Armenëve të sotëm besonin që ishin pasardhës të Patriarkut të Madh, Hajkut. “Të parët e zotave ishin të frikshëm dhe të jashtëzakonshëm si edhe shkak i krijimit të mrekullive të mëdha, i krijimit të botës dhe popullimit të saj. Prej tyre doli fillimisht brezi i gjigantëve ...një prej të cilëve ishte...Hajku”.

Sipas shkrimeve të vjetra (shumero – akkadiane) kuneiforme (në formë pyke) të gjetura në monumentet e zbuluara në zonën e Lindjes



“Beteja e Hajkut me Belin” (vepër e piktorit Italian G. Zasso, 1885)

së Mesme merret informacioni, që zoti mbrojtës i mbretërisë më të vjetër të Malësive Armene (në shekujt XXVIII - XXVII para Krishtit) ka qenë Hajku, djali i zotit të urtësisë dhe i ujrave të gjithësisë - Haj(a).

Adhurimi i Haj(as) si zot lidhej me burimet e Tigrin dhe Euftratit, që e kishin zanafillën e tyre në Malësitë Armene, dhe nuk është rastësi, që ai paraqitej si krijuesi i këtyre burimeve.

Në vitin 301, kur Krishterimi u deklarua besim shtetëror brenda Armenisë, çdo besim tjetër i mëparshëm u ndalua ose ju përshtat botkuptimit Kristian. Sipas Biblës, në librin e parë mbi Gjenezën (lindjen e gjërave), të gjithë kombet e kanë prejardhjen nga tre bijtë e Noes: Japeti, Kami dhe Semi. Në këto kushte, legjenda Armene e periudhës së paraKrishterimit ju përshtat Librit të Shenjtë, Biblës. U krijua një legjendë e re, sipas së cilës Patriarku Hajk i përkiste grupit të pasardhësve të Japetit, djalit të Noes dhe ishte i biri i Patriarkut

Torkom. (Torkomi sipas Biblës paraqitet si paraardhës i famshëm i Shtëpisë (Familjes) Torkom dhe një nga Patriarkët më të vjetër që kanë kontribuar në formimin e shtetit Armen. Shtëpia e Torkomëve është zbuluar në zonën e pellgut të sipërm të lumit Euftrat dhe përmendet deri në shekujt XX - XVIII para Krishtit). Prej këtej rrjedhin edhe emrat e përmendur në burimet e shkruara të shekujve të Mesjetës që i atribuohen kombit Armen si: “Pasardhësit e Japetit”, “Pasardhësit e Torkomit”, “Kombi i Torkomit”.

Sipas legjendave, të përshtatura rishtas në Bibël në lidhje me gjenealogjinë Armene në kushtet e lindjes së Krishterimit, Armenët shfaqen si banorë vendas (autoktonë) në Malësitë Armene, që janë atdheu i tyre si edhe atdheu stërgjyshor i Armenëve të mbetur.

Në legjendën, që bën fjalë për lindjen e kombit Armen, pjesën më të rëndësishme e përbën tregimi “Hajku dhe Beli”, në të cilin është reflektuar konflikti i zgjatur shumëshekullor ndërmjet Mesopotamisë së Lashtë dhe Malësive Armene. Sipas legjendës, Kalendarit Original (Fillestar) Armen e ka filluesën në ditën kur Patriarku Hajk mundi gjigantin Bel. Sipas llogaritjeve të Kevond Alishanit kjo ka ndodhur në 11 Gusht të vitit 2492 para Krishtit (këtu duhet thënë që ka edhe llogaritje të tjera).

Sipas legjendës Armene, duke marrë shkas nga emri i Patriarkut Hajk, populli Armen u quajt “Haj” dhe vendi “Hajk” ose “Hajasdan”, dhe më pas, nisur nga emri i njerit prej Patriarkëve pasardhës, Aramit, i shtuan edhe emrat “Armen” dhe “Armenia”. Me emrin e Hajkut dhe të shumë Armenëve të tjerë u emërtuan edhe shumë vende brenda Malësive Armene (Aramajis – Armavir, Jerasti – lumi Jeras’h (ose Araks), Sharaji – krahina Shirak, Amasiaji – malet Masis dhe krahina Masiacit, Kehami – Deti Kehamjaj ose Keharkun’jac (Liqeni Sevan, sot) dhe krahina Keharkunik (Gegharkunik), Sisaki – krahina Sisakan (Sjunik), Bukuroshja Ara – krahina e Araratit, etj.

Për historinë e lindjes së kombit Armen janë marrë në konsideratë edhe burimet e vjetra të shkruajtura Greke, ato Ebreje të vjetra (Judish),

Gjeorgjiane dhe Arabe, brenda të cilave Armenët gjithnjë janë paraqitur me tipare mjaft positive; të pasurit lidhje gjaku me ta është konsideruar nder dhe e dëshirueshme.

Të njëjtën konsideratë e gjejmë edhe brenda një sërë legendash të shumë popujve Europeanë, të cilët lindjen e kombit të tyre e gjejnë të lidhur me Armeninë.

Në “Kronikat Anglo – Saksone” të shkruara në shekullin e IX pohohet që, në Ishujt Britanikë” banorët e parë kanë qenë Bretonët, të cilët kishin ardhur nga Armenia”. Sipas “Kronika Bavareze”, “Kënga e Anës”, “Kënga e Rolandit” dhe burimeve të tjera të Mesjetës del që Bavarezët e kanë zanafillën e tyre në Armeni, në malin Ararat, atje ku Noe qëndroi me barkën e tij. Zanafillën e tyre e lidhin me Armeninë edhe Baskët. Shënime interesante, të ruajtura deri në ditët e sotme, që kanë lidhje me Armeninë, ka edhe në përrallat ruse. Brenda tyre, më i famshmi, më i dashuri hero i Rusëve, Ilia Muromjeci, e merr fuqinë e tij nga vëllai i madh, Svjatogori (Svjatogor – në Rusisht do të përkthehej – Mali i Shenjtë), i cili banonte në “malet Ararat”....

### **Historia e lindjes së kombit Armen sipas Historiografisë moderne:**

Duke filluar nga shekulli i V dhe deri në mesin e shekullit të XIX, në trajtimin e çështjes së zanafillës së kombit Armen, një efekt subjektiv të padyshimtë pati edhe legjenda me ndikim Kristianizues mbi këtë çështje, e cila gjeti pasqyrim në faqet e librit “Historia e Armenisë” e historianit Armen, Moisi Horenaci.

Në gjysmën e dytë të shekullit të XIX, në shkencat muarrën hov disa teori të reja shkencore, ndërmjet të cilave edhe disa nga ato, të cilat vinin në pikëpyetje çështjen e autoktonisë së popullit Armen. Por pas disa dekadash u bë e qartë se këto teori ishin krejt pa baza.

Në fillim të viteve 1980 u konfirmua, që atdheu i stërlashtë i botës Indo-Europeanë në mijëvjeçarin e V - IV para Krishtit, ishte zbuluar në veri të Azisë Perëndimore, më saktësisht, në Malësitë Armene, në krahinat lindore të Azisë së Vogël, ndërmjet Mesopotamisë veriore



Vulë Shumere (mijëvjeçari i 3-të para Krishtit) ku perëndia armene Haj(a) përshkruhet si origjina e lumenjve Tigër dhe Eufrat

dhe krahinave veri-perëndimore të zëna nga pllaja Iraniane. Kështu, atdheu i stërlashtë i Indo-Europianëve është gjetur pikërisht brenda asaj hapësire ku është formuar dhe nëpër të cilën ka kaluar historia e popullit Armen.

### **Të dhëna të vjetra historike mbi Armeninë dhe popullin Armen:**

Për Malësitë Armene, të dhënat e para të njohura deri më tani, janë ato të ruajtura në mbishkrimet e përmendoreve (statujave) Shumere dhe që i përkasin shekujve XXVIII - XXVII të kohës para Krishtit. Brenda tyre përmendet formimi i shtetit të hershëm Aratta. Emri Aratta, në të vërtetë, është i ngjashëm me emrin Ararat, gjë që të bën ta mendosh këtë të fundit si pararendës të emrit Aratta.

Duke filluar nga shekulli i XXVI para Krishtit shkrimet origjinale Mesopotamase përmendin (kujtojnë) zotin Haj(a), si edhe tokën dhe popullin me të njëjtin emër. Është e ditur, që popujt e tjerë e njohin tokën dhe popullin Armen më tepër me emrat “Armenia” dhe “Armen”. Duke filluar nga shekujt XXIV - XXIII, brenda Malësive Armene fillojnë të shfaqen emrat “Arman(i)”, “Armi”, “Aram” si dhe emra të tjerë vendi, të cilët ishin pararendësit e emrit “Armenia”.

Në shkrimet e vjetra mbi statujat e shekujve XXIV - XXIII para Krishtit të zbuluara në Ebla (qytet i lashtë në veri të Sirisë së sotme) përmenden “bijtë e “Hajaji-s” (fëmijët e Armenisë – Armenët) që banonin brenda tokave të quajtura Armi.

Kështu, në periudhën ndërmjet shekujve XXVII - XXIII para Krishtit, brenda Malësive Armene përmenden emrat që i atribuohen Armenisë dhe Armenëve, si Aratta, Haja dhe Arman(i), të cilët vazhdojnë të mbeten të gjallë deri në ditët e sotme në formën si: Ararat, Hajk-Hajasdan dhe Armenia.

Sot mund të thuhet me bindje të plotë, që Armenët janë pjesë e kombit mëmë IndoEuropean, dhe duhet të jenë ndarë prej saj (dalë si degëzim më vete) nga fundi i mijëvjeçarit të IV<sup>të</sup> para Krishtit (sipas disa studimeve të kohëve të fundit mendohet që kjo ndarje të ketë ndodhur në gjysmën e dytë të mijëvjeçarit të VI<sup>të</sup> para Krishtit). Rreth atyre kohëve, tributë Armene fillojnë të marrin formën e “etnisë” dhe të shfaqen format e para të organizimeve “shtetërore”, dhe vetëm në gjysmën e parë të mijëvjeçarit të I para Krishtit, Armenët shfaqen si një organizim shtetëror mbarëArmen i unifikuar.

### KREU 3

## ARMENIA NË PERCEPTIMIN SHPIRTËROR TË LINDJES SË LASHTË

Në legjendat dhe mitet e Lindjes së Lashtë janë ruajtur të dhëna shumë interesante për Armenët dhe vendbanimin e tyre.


Në Bibël thuhet që Zoti e krijoi njerëzimin brenda parajsës, të quajtur Eden, nga ku buronin 4 lumenj: Eufrati, Tigri, Gehoni dhe Pisoni. Kjo nënkuptonte, që parajsa e quajtur Eden ishte vetë Armenia, toka ku ishin krijuar njerëzit e parë dhe ku ruheshin (fshiheshin) simbolet e Pavdeksisë dhe Diturisë: Genaci (simboli i Pavdeksisë) dhe Pemët e Diturisë – E Mira dhe E Keqja. Në Bibël thuhet, gjithashtu, se Arka e Patriarkut Noe, pas përmytjes së përbotëshme, ngeci “mbi malet Ararat”, pra në Malësitë Armene. Faktikisht, sipas Librave të Shenjtë, Armenia ishte një vend i bekuar, ku e kishte zanafillën njerëzimi, ku ruheshin (fshiheshin) simbolet e Pavdeksisë dhe Diturisë dhe që pas përmytjes së madhe ishte kthyer në vendin e rilindjes së njerëzimit.

Të njëjtën ide e gjejmë edhe tek burime të tjera të vjetra të Botës së Lashtë. Në mënyrë të veçantë, në legjendat e vjetra Mesopotamase përmendet Haj(a), Zoti i Diturisë, i cili së bashku me Nënë Mbretëreshë (Nënë Hyjnore) e krijoi njerëzimin brenda Malësive Armene. Në burimet Shumere, toka e quajtur Aratta hyjnizohet si “toka ku mbretërojnë ligjet e shenjta të Perëndive” dhe “toka e të Pavdekshmëve”. E para lidhet me pikëpamjen e lashtë, që pranë Haj(as), Zotit të Diturisë, brenda Malësive Armene, ruheshin ligjet e shenjta që rregullonin funksionimin e Botës.

Emërtimi i hyznizuar “Toka e të Pavdekshmëve” lidhet me Përmbytjen e Madhe dhe haset në mitologjinë Shumere, Babilonase dhe të tjera, sipas të cilave të shpëtuarit nga përmbytja fituan pavdeksinë dhe u vendosen si banorë brenda Malësive Armene (gjë që përputhet me atë që shkruhet në Librat e Shenjtë).

Heroi i legjendës Mesopotamase, Gilgameshi, në kërkim të pavdeksisë, merr “rrugën që të çonte në Aratta”, ecën drejt rrjedhës së sipërme të Eufratit dhe në rrugë e sipër mposht malet Mashu (Masu), të cilët në kufirin jugor të Malësive Armene janë malet Masius ose Masion.

Të njëjtën ide e gjejmë tek legjenda që i kushtohet Aleksandrit të Maqedonisë, e cila për herë të parë shfaqet e shkruar në vitin 240 para Krishtit. Sipas saj, duke synuar pavdeksinë, Aleksandri i Madh përsërit rrugën e Gilgameshit, heroit të gjithënjohur në Lindjen e Vjetër. Për



Ilustrimi biblik i Armenisë si vendlindja e njerëzimit (Londër, 1749).

hir të së vërtetës, Aleksandri , i cili nuk hyri kurrë në Armeni, mori rrugën “drejt Botës Armene, ku janë burimet e Tigris dhe Eufratis”, por gjatë rrugës ai mposht vargmalet Masis. Domethënë, aq thellë kishin hyrë në Botën e Lashtë legjendat për Armeninë si Toka e Pavdeksisë, sa heroin e famshëm Gilgamesh, aq shumë të njohur në epikën e Lindjes së Lashtë, në kërkim të pavdeksisë, e zëvendësojnë me heroin e famshëm të Botës së Lashtë, Aleksandrin e Madh, dhe jo vetëm kaq por, objektivi i të dyve ishte Toka e Pavdeksisë, Bota Armene. Aty paraqitet edhe e famshmjja “Pema e Pavdeksisë”, që i korrespondon Pemës së Jetës për të cilën flitet në Librat e Shenjtë.

Në Parajsën e Edenit, të përmendur në Librin e Shenjtë, Pema e Diturive të Mira dhe të Këqija janë simbole të Diturisë. Tashmë është pranuar, që Haj(a), babai i Patriarkut Hajk, në zonën e Azisë Perëndimore (zona e Lindjes së Afërme) ishte i njohur edhe si zoti i diturisë. Ndërsa sipas dorëshkrimeve të lashta Shumere “Dituria dhe Arti kanë zbritur poshtë nga tokat e Aratta-s”.

Në përshkrimet, që ndodhen brenda legjendave të vjetra të popujve të Lindjes së Lashtë, Armenia paraqitet si vendbanimi i Zotave (Perëndive), si vendi i qënieve më të shenjta. Po kështu paraqitet Armenia edhe në faqet e librit me tre volume “Babilonia” të Berosos, të shkruar mbi bazën e shkrimeve të vjetra kuneiforme Mesopotamase (shekulli IV - III para Krishtit). Në legjendën Mesopotamase “Gilgameshi”, Armenia quhet “Katedralja e Perëndive”; ishte pikërisht atje, vendi ku Perënditë i dhanë të drejtë njerëzimit të mbijetonte ( të rifillonte jetën). Ndërsa sipas mbishkrimeve kuneiforme (shekulli XIV - XIII para Krishtit) të gjetura në qytetin e lashtë Ugarit, të zbuluar në veri-perëndim të Sirisë së sotme, vendbanimi më i shenjtë i Perëndive gjendej pranë burimeve të Eufratis perëndimor (në burimin Mala), ku ndodhej vendi kryesor i kultit të Armenisë paraKristiane, Armenia e Lartë (Armenia e Sipërme).

Të njëjtat përshkrime janë ruajtur edhe në faqet e dorëshkrimeve Armene. Ja se si përshkruhet në librin “Gjeografia” krahina e Armenisë së Sipërme nën zotërimin e Hajkut të Madh: “Ashtu siç e thotë edhe vetë

emri i tij, kjo pjesë toke është me të vërtetë e lartë (hyjnore) jo vetëm për tokat që i përkasin Hajkut të Madh, por edhe për gjithë botën, prandaj quhet edhe “çatia e botës”. Prej aty shpërndahen lumenjtë në të katër anët e botës; prej aty marrin fillimin katër lumenj të mëdhenj. Të quajturit “Çatia e botës” të kujton emërtimin që i jepte Bota e Lashtë krahinës që i përkiste vendbanimit të Perëndive, pasi katër lumenjtë që rrjedhin prej andej nëpër të katër anët e botës, padyshim që të sjellin ndër mend katër lumenjtë që zenë fill nga parajsja e Edenit sipas Librave të Shenjtë...

Brenda Librave të Shenjtë, Edeni përmendet si “Ana Lindore”, gjë të cilës i duhet kushtuar vëmendje e veçantë. Po në atë libër, brenda një paragrafi tjetër tregohet që Arka e Noes ngeci mbi Malet Ararat (brenda Armenisë), nga ku më pas, njerëz që flisnin të njëjtën gjuhë, nga “pjesa lindore” shkuan në tokat Senaari (Shumer) dhe vendosën të ngrenë “Kullën e Babilonit”, një kullë që të arrinte deri në qiell; në të dy rastet Armenia paraqitet si “toka e Lindjes (Lindore)”, ndërsa sipas shkrimeve në Testamentin e Vjetër, thuhet, që ajo ndodhet në veri të tokave të Hebrenjve.

Tregime të tilla, tashmë janë prezente edhe në një sërë burimesh të tjera. Brenda legjendës Mesopotamase “Gilgameshi”, kufijtë e parajsës dhe Tokës së Pavdeksisë janë malet Mashu, vendi ku lindte dhe perëndonte dielli. Kjo do të thotë, që Malësitë Armene, të ndodhura në veri të Mesopotamisë dhe Palestinës, nuk janë “Lindje” vetëm në kuptimin gjeografik të fjalës, por edhe në kuptimin “Vendi ku lind dielli”. Me kalimin e kohës, ky kuptim fillestar u harrua, dhe kjo fjalë u përdor më tepër në kuptimin gjeografik të saj.

Paraqitja e Malësive Armene si një vendndodhje domethënëse e diellit është ruajtur, gjithashtu, edhe brenda burimeve Hittite, sipas të cilave dielli lindte nga “Deti i Lindjes”, me të cilin nënkuptonin Liqenin Van. Kjo është në harmoni të plotë me legjendat Armene, sipas të cilave, “substancia e artë” e diellit ndodhej në fundin e Liqenit Van, nga ku ai dilte çdo mëngjes herët dhe ku çdo mbrëmje kthente dritën e ditës.

Një informacion tepër interesant për Armeninë është ruajtur,

gjithshtu, edhe në legjendën “Մուսայ Ծոօր - Kreshnikët e Sasunit” (ose Davidi i Sasunit), brenda së cilës “Օւղիսարը – Zoti i Vetëtimave, Rrufeve) i këshillon djemtë e tij që të largohen nga Bagdati për në Armeni, me fjalët e mëposhtëme:

Mbathjani, shkoni në qytetin e mbretit të Armenisë.

Mbani si orientim yllin e ndritshëm të natës,

Gjatë ditës pyesni

Për tokën e mbretit të Lindjes.

Armenia, brenda legjendës Armene, quhet “Toka e mbretit të Lindjes”, një emërtim karakteristik ky, që mund të lindte dhe të ruhej vetëm dhe vetëm në kohët e lashta.

Fakti që Armenia është cilësuar “Lindje” në episodet më të rëndësishme të Biblës dhe në shumë prej burimeve më të vjetra, i dhanë shkas supozimit, se “Magjistarët e Lindjes (orientale)” të përmendur në Dhiatën e Re (Testamenti i Ri), të cilët erdhën të parët për të uruar lindjen e Jezu Krishtit, mund të jenë priftërinjtë e Armenisë.

Të gjitha faktet dhe argumentet e sipërpërmendura duhen ta vënë çdo Armen në mendime. Armeninë, si vendi i Krijimit, i Rikrijimit të njerëzimit pas përmytjes së madhe, i Pavdeksisë dhe Diturisë, i Diellit, e shohin jo vetëm paraardhësit e Armenëve, por edhe njerëzit që nuk kanë as edhe ndonjë farë lidhje të largët farefisnore me ta.

Si përfundim mund të themi se, në kohët e hershme ekzistonte një mendim i thjeshtë hyjnor (i shenjtë), që i kalonte kufijtë kombëtarë Armenë, brenda të cilit Malësitë Armene kishin një rol shumë të rëndësishëm. Përse pikërisht Malësitë Armene? Cila ishte ideologjia e këtij vendi, cila ishte e fshehta e hyjnzimit (shenjtërisë) të këtij vendi?

Shënim i imi (për sqarim):

*Të kihet parasysh që fjala Armene “Օւղի” është shumësi i fjalës “Օւղ” – që në Shqip do përkthehej – shmangie, lakim, devijim;*

*Titulli i poemës, “Մասնավոր Մոտիվ”, në varësi nga koha e përpunimit dhe përpunuesi i saj është vendosur me kuptimin “Kokëkrisurit, Të Marrët, Rebelët, Të Pabindurit, Kreshnikët e Sasunit”, pasi historikisht banorët e Sasunit janë njohur për shpirtin e tyre kryengritës ndaj shtypjes.*

*Ndërsa “Մոտիվային” ka në rrënjë fjalën “Մոտիվ” që në Shqip do përkthehej – det. Në poemë fjala “Մոտիվային”, në varësi nga koha e përpunimit dhe përpunuesi i saj është përdorur në kuptimin “Zoti i Detrave, Stuhive, Vetëtimave, Rrufeve, Ai që dërgon përmbytjet, etj”; me një fjalë “Zot i Plotfuqishëm”.*

## KREU 4

# ARMENIA NË

## MIJËVJEÇARIN III - II PARA KRISHTIT

### **Organizimi i parë shtetëror. Aratta**

Organizimi i parë shtetëror më i vjetër i njohur deri më sot në Malësitë Armene, siç është vënë në dukje edhe më sipër, është Aratta, për të cilin flasin edhe të dhënat e gjetura në dorëshkrimet e vjetra Shumere të shekujve XXVIII - XXVII para Krishtit.

Aratta ishte një vend me ligje teokratike (Teokracia është një formë qeverisjeje, ku besimi në një zot apo forcë të mbinatyrëshme është burimi nga i cili rrjedh i gjithë autoriteti qeverisës). Kjo formë organizimi shtetëror ishte e atij lloji, ku i gjithë autoriteti, si ai shpirtëror ashtu edhe ai laik (laik – jofetar, që nuk ka lidhje me besimin) ishte në dorë të udhëheqësit shpirtëror, i cili me emrin e Zotit drejtonte botën. Mbreti i Arattës ishte njëkohësisht edhe kryepriifti pagan i tokës. Kryepriifti pagan, njëkohësisht edhe Mbret, e drejtonte vendin së bashku me një Këshill të Diturish, që ishte Këshilli i të Vjetërve (Këshilli i Pleqve). Kujtohet edhe si funksionari kryesor ekonomik i vendit, i quajtur “Drejtuesi” (gubernator, administrator). Brenda Arattës kujtohen edhe një sërë funksionarësh të tjerë ekonomikë, si p.sh.: taksambledhësit, mbikqyrësit, etj.

Banorët e Arattës ishin importues të prodhimeve bujqësore, dhe në këmbim eksportnin metale dhe gurë të çmuar. Përveç këtyre, dërgonin në jug edhe një sasi të madhe “gurë malorë” që shërbenin për ndërtime.

Në burimet e shkruara, përmendja për herë të parë e mbarështimit (zbutjes, trajnimit dhe përdorimit për nevoja të njerëzve) të kuajve i referohet tokave të Arattës. Më pas, përdorimi i kuajve në ekonomi dhe ushtri, i dha këtyre një përparësi të paimagjinueshme.

Dorëshkrimet Shumere japin të dhëna për ushtrinë dhe kryeqytetin me mur rrethues të Arattës. Një nga informacionet më të rëndësishme për Aratta-n është fakti se ai vend përdor shkrimin e vet, gjë që vërtetohet edhe nga provat, që i përkasin mijëvjeçarëve IV - III para Krishtit, të gjetura në Malësitë Armene.

### **Mbishkrimet më të vjetra të njohura ku shfaqen emërtimet**

#### **“Armenia”; Armi, Armen(um), Aram**

Në shekujt XXVI - XXIII para Krishtit, në territoret ku shtrihet sot shteti i Sirisë, kishte filluar të forcohej shteti Ebla, i cili kishte lidhje të gjera tregtare me vendet që e rrethonin. Brenda dorëshkrimeve të gjetura nga zbulimet në territorin e saj përmendet vendi Armi (Armani), banorët e të cilës, “Bijtë e Haja-s” (haj vortinerë – në gjuhën Armene), kishin marrëdhënie reciproke shumë aktive me Eblën.

Në gjysmën e dytë të shekullit të XXIV para Krishtit, në qendër të Mesopotamisë, lind shteti i Akkadisë, Mbretëria Akkadiane. Në një nga dorëshkrimet e gjetura, që i përkasin kohës së themeluesit të saj, Sarkon Akkadiani, përmendet për herë të parë pararendësi i emrit “Armenia”, emri Arman(um) për tokat në jug të Malësive Armene.

Pasardhësi i katërt i Mbretërisë Akkadiane, Naram-Sin (shekulli XXIII para Krishtit) ndërmori një sërë fushatash ushtarake ndaj Malësive Armene. Hapësirën, që ndodhet ndërmjet liqenit Van dhe liqenit Urmia, ai e përmend si “toka e Aramit”. Këtu vlen të përmendet se, sipas të dhënave të Moisi Horenacit, emrat “Armen” dhe “Armenia” e kanë bazën në emrin e Aramit.

Naram-Sini ndërmori disa fushata ndaj zonave në brigjet e Detit Ver (sot - pellgu i liqenit Van) dhe burimeve të Tigrit dhe Eufratit.

Naram-Sini vetëlavdërohet (mburret) duke e cilësuar veten si “pushtuesi i tokave Arman(um)”, të cilat “që nga lindja e njerëzimit e deri më atëhere nuk kishte arritur t’i pushtonte asnjë mbret”.

Përballë Naram Sinit shfaqet lidhja (aleanca) e Malësive Armene dhe 17 organizimeve të tjera shtetërore (krahinave) me në krye tokat (krahinën) e mbretërisë Arman(um). Drejtimi i kësaj aleance nga Arman(umi) i kishte kaluar krahinës Lulupi që ndodhej në jug të liqenit Urmia. Përballë ushtrive të kësaj aleance, Naram Sini kishte dërguar tre ushtri, nga të cilat nuk u kthye as edhe një ushtar i gjallë. Më pas drejtimi i aleancës, nga krahina Lulupi, i kaloi krahinës Kutiakan (e cila në botën e vjetër njihej me emrin Kordvac), duke rënë më pas përfundimisht nën tiraninë e Naram-Sinit.

### **Mbretërimi njëqindvjeçar i Kutiakanit (Kordvacit)**

Naram-Sini ndërmoi disa akte përdhosjeje të paprecedentë; shkatërroi tempujt e zotave të deriatëhershëm dhe vendosi me detyrim nderimin e kultit të tij, duke e shpallur veten “Zot”. Popullsia pagane Shumere i kërkoi ndihmë Aleancës së 18 krahinave, drejtimi i së cilës kishte kaluar nga Lulupeja në dorë të krahinës së Kutiakanit. Malësorët e Malësive Armene ndërmorën një sulm të shpejtë në qendër të Mesopotamisë. Në luftë me ta, Naram-Sini, i vetëshpallur “Zot”, u vra.

Titulli “Mbret i katër anëve të botës”, me të drejtën e fitimtarit, i kaloi mbretërve të krahinës Kuti, zotërimi i të cilëve shtrihej nga malet Amanos deri në Elam, nga veriu i Malësive Armene deri tek Deti Persik.

Me rënien e mbretërimit të Kutiakanit, në shekullin XXI para Krishtit, Armenia e ruan fuqinë dhe pozitën e vet brenda të ashtuquajturës Lindje e Vjetër.

### **Malësitë Armene në shekujt XX - XVII para Krishtit**

Në shekujt XX - XVIII para Krishtit, krahinat veriore të Azisë Perëndimore zhvilluan tregtinë e metaleve nëpërmjet rrugës, që kalonte

nga qyteti Kanesh (qytet në lindje të Azisë së Vogël) deri në Ashur. Me krijimin e kësaj rruge trafiku, Malësitë Armene hynë brenda këtij aktiviteti me rreth 30 vendbanime, prej të cilëve eksportoreshin metale të ndryshme: ar, argjend, bakër, kallaj, etj. Në dorëshkrimet e Kaneshit përmenden rreth dhjetë mbretëri Armene: Xupana (Xopk), Tekarama (Tokarma, Shtëpia e Torkomëve), Hah(um), Tukrish, etj.

Përdorimi në masë të gjerë i metaleve pati shumë rëndësi si në çështjet ekonomike ashtu edhe në ato ushtarake. Në pajisjet luftarake një rëndësi të veçantë kishin pajisjet luftarake që përdoreshin për kalorësit dhe kuajt. Me sa duket, me krijimin e rrethanave të sipërpërmendura, duhet shpjeguar ai shpërthim luftërash, që zuri vend brenda Malësive Armene në shekujt XVIII - XVII para Krishtit: Kasidët marshuan në Babilon, Hyksosët në Egjipt, Ariasit në Indi. Të tre këto ekspedita përfunduan me fitore të bujshme.

### **Mbretëria Mittani**

Në shekullin e XVI para Krishtit, në zonën që përfshinte Armeninë jugore dhe Mesopotaminë veriore u krijua mbretëria Mittani me kryeqytet Vashukan (mbi malet Masion). Në burimet e vjetra Egjyptiane, Mittani përmendet me emrin “Naharina”, që me shumë gjasa, identifikohet me emrin “Najiri”.

Mbretërit e Mittanit mbanin titullin “Mbret i Madh”. Ndikimi i tyre shtrihej: nga lindja deri në luginat e lumenjve Botan dhe Zab i Madh, nga perëndimi shtrihej deri në brigjet e Detit Mesdhe dhe malet Taurus të Kilikisë; në veri shtrihej, të paktën, deri në Eufratin Perëndimor dhe zonat e trazuara të Araxanit.

Mittani ishte në konflikt dhe luftë të vazhdueshme me Egjiptin, deri sa ky i fundit, pasi nisi një sulm ndëshkues ndaj Hyksosve, i drejtoi goditjet ndaj Mittanit. Hapësira e madhe kohore e lufrave ndërmjet Egjiptit dhe Mittanit (gjysma e dytë e shekullit të XVI deri në fillim të shekullit XIV para Krishtit) përfundoi me nënshkrimin e një marrëveshjeje paqeje, sipas së cilës jugu i zonave të Mesdheut lindor

i kalonte Egjyptit, veriu Mittanit. Marrëveshja u përforcua me lidhje martesore; për disa breza me rradhë bijat e mbretërve të Mittanit u bënë gra të Faraonëve, nga të cilat më e famshmja ishte Nefertiti.

Në legendat (tradiçen) e shkruara Armene, këta drejtues të mbretërive Indoeuropiane shfaqen si mbretër autoktone Armenë dhe emrat e tyre i gjejmë në listën e mbretërve dhe udhëheqësve të Dinastisë Hajk të shkruar nga Moisi Horenaci (p.sh. Paratarna, zbuluar në shkrimet kuneiforme – Paret, sipas Horenacit), (Vasashata – Vashtak), etj. Shekulli i XIII para Krishtit shënon fundin e jetës së mbretërisë së Mittanit, të ndodhur përballë goditjeve të fuqishme të fuqisë në rritje të Asorëve.

### **Mbretëria Hajasa**

Në dorëshkrimet kuneiforme Hittite të shekujve XV - XIII para Krishtit, krahinat perëndimore të Malësive Armene përmenden si tokat Hajasa. Duke marrë për bazë emrin e tokës, edhe njerëzit që e popullonin atë u vetëquajtën Haj (në shkrimet Hittite emrat e vendeve formoheshin me prapashtesat -(a)sa). Qendra më e rëndësishme e Armenisë ishte Kumahani; më pas, në kohën e Armenisë së Madhe të Hajkut të Madh, Ani-Kamahu, ku ndodhej mauzoleu i madh i mbretërve Armenë.

Hajasa kishte oborrin e vet mbretëror, ushtrinë dhe drejtuesit civilë të qendrave të banuara. Ajo kishte gjithashtu sekretarët (kronikanët) e vet. Duke gjykuar nga korrespondenca me shkrim ndërmjet Hittitëve dhe Hajasëve, nxjerrë nga burimet identike Hittite, mund të thuhet se Hajasa kishte një dhomë sekretarësh (kronikanë), me shkruarit e vet, të cilët përgatisnin dokumentat me shkrim për nevojat e qeverisjes.

Në fushën e betejës, Hajasa ishte e aftë të nxirrte një ushtri me rreth 700 qerre luftarake dhe rreth 10 000 këmbësorë, gjë kjo, që për kohën e vet përbënte një fuqi të konsiderueshme.

Për herë të fundit, Hajasa përmendet në fund të shekullit të XIII para Krishtit.

## Tokat Najiriane

Emri “Najiri” për herë të parë shfaqet në mbishkrimet Asore me gdhendje, që datojnë të shekullit të XIII para Krishtit. Nën këtë emërtim përfshiheshin krahina e liqenit Van dhe krahinat që shtriheshin përqark tij, nga jugu dhe perëndimi. Në shekullin e XIII para Krishtit përmenden 40 prijësit e tokave Najiriane, të cilët në shkrimet Asore quheshin “Mbretër”. Në mbishkrimet mbretërore Asore, Najiri përmendet si “një vend i madh, me shtetas të parregjistruar dhe tokë të panjohur”, që kishte shumë “qytete të mëdha” dhe shumë pasuri.

Në shekullin e IX para Krishtit, në mbishkrimet Asore me gdhendje, Najiri përshkruhet si një bashkësi e organizuar tokash në një mbretëri të vetme. Po aty përmendet se “brenda tokave të Najirit ka 250 qytete, secili me garnizonin e vet ushtarak”. Po në atë shekull, shkruar me gdhendje në gjuhën Asore, në mbishkrimet e veta, mbretërit e mbretërisë Van, tokën e tyre e thërrisnin me emrin “Najiri”.

## KREU 5

# MBRETËRIA E VANIT

(NAJIRI, BIAJNILI, URARTU, ARARAT)

Në shekullin e IX para Krishtit brenda Azisë Perëndimore filloi të zgjerohej në mënyrë të konsiderueshme zotërimi i tokave nga ana e mbretërisë Van, e cila në dorëshkrimet Asore vazhdimisht ishte quajtur - Urartu, në mbishkrimet vendase - Najiri dhe BIAJNILI, në Librat e Shenjtë – Ararat. “Urartu”ja dhe “A(j)rarat”i ishin emërtime Asoro-Babilonase. Kështu emërtohej Armenia (Hajasdani) në mbishkrimet Asore dhe Babilonase deri në shekullin e IV para Krishtit, përfshirë edhe gjysmën e parë të tij.

Në burimet e shkruara Asore me një emër të tillë të ngjashëm, si mbret i parë i Urartu-s përmendet mbreti Aramu (“urartiani Aramu”), i cili përgjatë viteve 859-843 para Krishtit i kishte bërë ballë disa herë fushatave Asore.

Në burimet e shkruara Asore, si pasues i këtij mbreti, përmendet mbreti “urartian” Sarturi i I<sup>rë</sup>, i cili themeloi dhe ndërtoi si kryeqytet të tij qytetin Tushpa (Tosp, Van). Në vitet 830<sup>të</sup> para Krishtit të sundimit të tij, në mbishkrimet e gjetura në qytetin e tij, ai përmendet si “mbreti i tokave të Najirit” duke u marrë Asorëve titujt mbretërorë si “Mbret i Madh, Mbret i Botës, Mbret i Mbretërve..”. Këto tituj, padyshim, i kishin kaluar atij me të drejtën e fitimtarit, për shkak të fitoreve që kishte korrur mbi Asorët. Në fuqizimin dhe shndërrimin në fuqi rajonale të mbretërisë Van një rol të rëndësishëm luajti edhe djali i Sarturit të

I<sup>e</sup>, Ishbuni (rreth viteve 825-810 para Krishtit), duke filluar me ligjet e qeverisjes së mbretërisë, që vazhdoi me përmirësimet në qeverisje përgjatë kohës së mbretërimit të Menaji-t (rreth viteve 810-786 para Krishtit). Prej tyre, ja vlen të kujtohet veçanërisht ndryshimi për mirë në të shkruar, krijimi i shkrimit kuneiform vendas, ndryshimi i besimit, për të krijuar një besim të vetëm për tërë mbretërinë (i cili u gdhend mbi shkëmbin e quajtur “Dera e Mher-it), përmirësimet ushtarake si edhe në elemente të tjerë. Një vëmendje e veçantë i kushtohet ndërtimeve ushtarake; krijohet një rrjet i gjerë fortifikimesh në pikat strategjike ushtarake të vendit.

Në kohën e mbretërimit të Menajit, pjesa më e madhe e krahinave të Malësive Armene, që qeveriseshin në mënyrë të pavarur, u bashkuan në një qeverisje të vetme të përqëndruar, ndërsa mbretëritë e krahinave veriore, ndonëse nuk kishin hyrë brenda mbretërisë Van, e kishin pranuar rolin drejtues të saj dhe ishin shndërruar në vasalë taksapagues të saj. Në të njëjtën kohë, në periudhën e dytë të sundimit të tij, Menaji jo vetëm që e forcon më tepër sundimin e tij duke u shtrirë akoma më në jug të liqenit Urmia dhe në perëndim të Eufratit, por vendos kontrollin deri në malet Zagrosian nga lindja dhe mbi rrugët ushtarake që të çonin drejt Azisë së Vogël. Menaji korr fitore ndaj superfuqisë së deriatëhershme në ato krahina, Mbretërisë së Asorëve, dhe mbretërinë e Piajnili-Urartu-Ararat e rikthen në superfuqi të atyre krahinave.

Gjatë sundimit të mbretit Argishti I<sup>e</sup>, në vitet 786-764 para Krishtit, mbretëria Van arriti suksese të papara. Mbretëria e krijuar prej tij shtrihej nga brigjet jugore të liqenit Urmia deri, përfshirë Çavahkun, nga pellgu i liqenit Sevan dhe brigjet e lumit Kura deri në krahinat që ndodheshin nga bregu i djathtë i Eufratit (përfshirë tokat Melitea dhe Tabal), nga malet Masius dhe Kordvac deri në krahinën (pellgun) Çorohi. Kufijtë, mbi të cilët ai ushtronte të drejtën e sovranitetit (shtete vasale taksapagues) ishin akoma më të gjerë; ato përfshinin mbretëritë Luviakane (Lauviane) lindore të Azisë së Vogël dhe disa toka Mercurmiane nga Lindja deri në Detin Kaspik, ndërsa nga jugu shkonin deri në Babiloni, përfshirë atë.

Fushata e tij më e largët, që ishte edhe më e lavdishmja, ishte pushtimi i Babilonisë, pas një seri fushatash fitimtare drejt jugut nëpërmjet maleve Zakrosian. Nëpërmjet kësaj, ai e rrethoi Asorinë nga të tre anët, nga veriu, lindja dhe jugu. Shndrimi i mbretërisë Van në një fuqi të madhe ushtarake në Azinë Perëndimore gjatë sundimit të mbretit Argishti I<sup>ë</sup> dëshmohet në mënyrë të shkëlqyer edhe nga pohimi i bërë nga rivali i tij kryesor, kryekomandanti i ushtrive Asore, ku udhëheqësi i madh Armen cilësohet si një mbret “emri i të cilit është po aq i frikshëm sa edhe një stuhi e madhe, fuqitë e tij janë të pakufishme”.

Mbi figurën e Argishtit të I<sup>ë</sup>, falë gërmimeve arkeologjike, ka material mjaft të pasur. Interes të veçantë paraqet një helmë të gjetur në Kaukazin Verior, në të cilën, me shkrim kuneiform, është gdhendur emri i tij. Helmëta të tilla të ngjashme janë zbuluar gjithashtu në Abhazi, Oseti, Trrehek (në afërsi të Çavahkut, të cilat kompletojnë dhe konfirmojnë arritjet e suksesshme të Argishtit të I<sup>ë</sup> deri në zonat më veriore të hapësirës së Kaukazit Verior (Çavahk-Zapaha), të njohura nga burimet e shkruara. Nga gërmimet arkeologjike të bëra në jug deri në Babiloni, mund të shihet helmëta Biajnagane (që i përkasin krahinës Biajnili) e gjetur në Lurisdan (Kermanshah).

Duke i bërë një përmbledhje të dhënave që ka për zotërimet e mbretit Argishti I<sup>ë</sup>, shihet se, të drejtat e zotërimit të tij shtriheshin shumë më larg se kufijtë e mbretërisë së tij, deri në Azinë e Vogël dhe Babiloni, madje sfera e ndikimit të tij politik dhe shoqëror gjendet e shtrirë deri në Kaukazin Verior dhe në qendër të Zagrosit. Kjo ishte edhe pasqyra e Armenisë në kohën e zgjerimit të saj më të madh.

Gjatë kohës së sundimit të Sarturit të II<sup>ë</sup> në vitet 764-735 para Krishtit, pasardhësit të Argishtit të I<sup>ë</sup>, vihet re një interesim më i madh në çështje që i përkasin drejtimit të brendshëm të mbretërisë; ai filloi të asgjësojë mbretëritë vasale (mbase duke i konsideruar si armike), duke synuar që me asgjësimin e tyre t'i shërbejë unifikimit administrativ, duke kaluar nga një qeverisje konfederative në një qeverisje të përqendruar.

Në periudhën e qeverisjes së Sarturit të II<sup>ë</sup>, mbretëria e Vanit pati

shtrirjen e saj territoriale më të madhe. Nga veriu ajo arrinte deri në Detin e Zi (në krahinën e emërtuar Kulha), nga veri-lindja deri në lumin Kur (bashkësia e tokave Urtih-Arcah), nga lindja deri në Detin Kaspik (e emërtuar Pulvati), nga perëndimi deri në Azinë e Vogël (me nënshtrimin e tokave të Melitea-s, Mushani dhe Zapsha), nga jugu kishte përfshirë Babiloninë, nga jug-perëndimi mbretërinë e Damaskut (tokat e Ruishanit). Pra, ishte krijuar një shtet i fuqishëm që kishte pika takimi me katër dete.

Si konkluzion mund të thuhet se, gjatë periudhës së Menajit mbretëria e Vanit u shndrrua në një nga fuqitë e mëdha të Azisë Perëndimore, ndërsa gjatë periudhës së Argishtit të I<sup>të</sup> dhe Sarturit të II<sup>të</sup> u bë fuqia e vetme udhëheqëse. Kjo zgjati gjithsej pak më tepër se 100 vjet.

Ndërkohë, sulmet e Tiklatpalasarit të viteve 764-735 para Krishtit frenuan programin për izolimin e plotë të Asorëve dhe asgjësimin e shtetit të tyre. Pas kësaj shteti i Asorëve arriti të rimëkëmbë pozicionin e vet, duke u bërë, krahas Vanit, një nga dy shtetet më të fuqishëm të Azisë Perëndimore.

Vani vazhdoi të mbetej në Azinë Perëndimore një nga dy shtetet më të fuqishëm deri në mesin e shekullit të VII para Krishtit. Në këtë periudhë veçanërisht të rëndësishme ishin vitet e qëndrimit në front të mbretit Rusa II<sup>të</sup> (vitet 680 – 650 para Krishtit); janë të njohura fitoret e tij mbi vendet në perëndim: Tablani-Tabal, Kainaru, Mushkini, Halitu-Hahtik dhe Hati.

Në veri të Malësive Armene, Kimerët e forcuar, në shekullin e VIII para Krishtit ndërmorën fushata armiqësore ndaj mbretërisë Van. Nuk dihet se si, por është e dokumentuar që Rusa II<sup>të</sup> ja arriti të vendosë lidhje miqësore dhe të bëjë aleancë me Kimerët duke kontribuar në çvendosjen e tyre në zonën e Azisë së Vogël (hapësira e Kapadokisë në burimet mesjetare Armene përmendet me emrin Kamirk). Pas kësaj, Rusa II<sup>të</sup> ja arriti, që nga hapësirat e Azisë së Vogël t'i drejtojë Kimerët drejt Asorëve. Faktikisht, mbreti diplomat, jo vetëm që arriti të shmangë



Mbishkrimi i mbretit Argishti i Irë lidhur me themelimin e Erebunit (Jerevanit) në vitin 782 para Krishtit.

sulmet e mundshme të Kimerëve ndaj tokave të tij, por armikun e hershëm e ktheu në aleat të tij, dhe pastaj e drejtoi kundër një armiku tjetër të tij, ndaj Asorëve.

Pas Rrusa II<sup>të</sup>, me shumë gjasa, mbreti i vetëm ishte djali i tij, Sarturi III<sup>të</sup>, i cili përmendet në mbishkrimet Asore të viteve 643 para Krishtit. Pas Sarturit të III<sup>të</sup>, mbretëroi Sarturi i IV<sup>të</sup>, (Sarturi i djalit të Sarturit), për qeverisjen e të cilit në fakt nuk dihet asgjë.

Relativisht, më e ndriçuar është periudha e mbretërimit të mbretit Rrusa i III<sup>të</sup>, për të cilin, mbishkrimet e njohura të arritura deri në ditët e sotme janë ato të pellgut të Vanit lindor dhe vendbanimeve të vjetra të fushës së Araratit. Ato arrijnë të dëshmojnë edhe për tkurrjen e kufijve të mbretërisë në kohën e mbretërimit të Rrusa i III<sup>të</sup>.

Autoriteti mbretëror i mbretërisë Van po dobësohej gradualisht. Dobësimin e mbretërisë e vunë re edhe fiset invazore Skithe. Nuk ka ndonjë të dhënë të qartë për kohën e rënies së mbretërisë Van. Ka baza për të supozuar se kalimi i autoritetit mbretëror nga një familje në një familje tjetër është bërë pa luftë, me revolucion brenda pallatit mbretëror, përpara vitit 609 para Krishtit.

Në shekullin e VII para Krishtit, brenda Malësive Armene po formëzohej një zotërim i ri dhe i madh Armen me në krye Skajvortin. Rasti e solli që, djali i tij, Parujr Hajkazuni, të bënte të njohur një mbretëri të re në vitin 612 para Krishtit.



## KREU 6

# ARMENIA NËN PUSHTETIN E DINASTISË HAJKAZUN - JERVANDUN DERI NË VITIN 331 PARA KRISHTIT

Në vitin 681 para Krishtit, djemtë e mbretit Senekerim (Sinaherib) të Asorisë, Sarasari (Sanasari) dhe Atrameleku vrasin të atin dhe arratisen për në Armeni. Sipas Moisi Horenacit, atyre u dha strehim përfaqësuesi i një dege fisnike të Hajkazunëve, Skajorti, që i vendosi ata në një zonë në kufi me Asorinë.

Po sipas tij, djali i Skajortit, Parujri, bashkoi gjithë krahinat duke filluar nga liqeni Van deri në pjesën e poshtme të Eufratit dhe lidhi një marrëveshje me Marasdanin (Media) dhe Babiloninë kundër Asorëve. Në vitin 612 para Krishtit ushtritë e Lidhjes pushtuan kryeqytetin e Asorëve, Niniven. Për të marrë pjesë në këtë fushatë, mbreti i Medias e kurorëzoi Parujrin dhe atë e njohën si mbret të Armenisë. Kur ushtritë e Lidhjes, në vitin 609 para Krishtit, nga krahinat e Tushpa-Vanit po marshonin drejt Karkemishit, që ishte pika e fundit e mbrojtjes së Asorëve, në atë kohë krahina e Vanit ishte futur në lidhje, që do të thotë që ishte nën pushtetin e Parujrit. Kjo do të thotë, se kalimi i sundimit nga shtëpia mbretërore e Vanit tek Parujri duhet të ketë ndodhur në ato vite ose pak më përpara. Nga pasardhësit e Parujrit, në vitet 580-570 para Krishtit, më i njohuri u bë Jervanti i I<sup>ë</sup> Sakavakjaci, në bazë të emrit të të cilit u bë e njohur edhe një degë e dinastisë mbretërore të Hajkazunit, zotërimet e së cilës morën emrin Jervantagan, Jervantjan ose Jervantuni.

Jervant Sakavakjaci kishte një ushtri të përbërë nga 40 000 këmbësorë dhe 8 000 kalorës, e cila në atë kohë vlerësohej si një fuqi e madhe. Kufijtë e mbretërimit të tij nga veri-lindja arrinin deri në lumin Kur, nga veri-perëndimi deri në Detin e Zi, nga lindja deri në Media kurse nga jugu deri në Mesopotaminë Veriore.

Jervant Sakavakjaci në një luftë pa sukses ndaj mbretit të Medias, Kiaksar-Varbakesit (në vitet 625-585 para Krishtit) u detyrua të njohë vasalitetin Median. Pak kohë më pas, pikërisht në kohën e Ashtahak-Astiagesit (në vitet 585 - 550 para Krishtit), ai rebelohet ndaj Medias. Rebelimi dështoi dhe familja mbretërore Armene ra në nivelin e oborrtarit të familjes mbretërore Mediane. Pyetjes, se cili ishte motivi i rebelimit, mbreti Armen i përgjigjet me dinjitet: “Unë synoja lirinë, ...që të jem vetë i lirë dhe fëmijëve t’u le trashëgim lirinë.”

Sovraniteti i Mediave ra në mesin e shekullit të VI para Krishtit, kur djali i Jervantit të Irë, Tigran Jervantani, duke u bashkuar me mbretin e Persisë, me Kirin e Madh, u ngrit në kryengritje kundër Medias. Ortaku kryesor i Kirit të Madh në këtë kryengritje ishte Tigrani, sundimi i të cilit, përveç se mbi gjithë Armeninë, shtrihej gjithashtu edhe mbi Kapadokinë, Gjeorgjinë dhe Albanët (*bëhet fjalë për Albanët e Kaukazit – shënim i imi*). Sipas gojëdhënave Armene, thuhet që ishte vetë Tigrani ai që e asgjësoi mbretin Ashtahak.

Në vitin 550 para Krishtit, Kiri i Madh krijoi perandorinë Akemena (Achaeminide), e cila ishte perandoria më e madhe ndër të gjitha perandoritë e tjera të krijuara ndonjëherë me pushtime deri më atë kohë. Kufijtë e kësaj të fundit shtriheshin nga Deti Mesdhe dhe Egjipti deri në Indi. Në mbishkrimet kuneiforme që i përkasin asaj kohe, Armenia, “për forcë zakoni” thirrej “tokat Kutiakan”, zotëruesi i të cilave (aktualisht Tigran Jervantani) ishte krahu i djathtë i Kirit të Madh. Ai ishte një drejtues i tillë, që në vitin 538 para Krishtit, në krye të ushtrive të Lidhjes, pushtoi Babiloninë, pas së cilës, përveç që ishte mbret i Armenisë, u emërua edhe zv/mbret i gjysmës perëndimore të perandorisë Akemena.

Duke i paraqitur Hajkazunerët sipas bëmave të mëdha të tyre, Moisi Horenaci e trajton figurën e Tigran Jervantanit në historinë e Armenisë si figurën e tretë më të rëndësishme, pas Hajkut dhe Aramit. “Babai i historisë” e përkufizon kështu sundimin e Tigran Jervantanit: Ai ishte më i fuqishmi dhe më i maturi ndër mbretërit tanë dhe më trimi ndër ta. Ai u bë ndihmësi i Kirit për të përmbysur sundimin e Mediave..... dhe duke zgjeruar kufijtë e vendbanimeve tona, arriti deri në skajet kufitare të vendbanimeve tona të lashta; ai mbushi me zili të gjithë bashkëkohësit e vet, madje edhe ata që erdhën më pas, si për figurën e atij vetë, por edhe për kohën që ai jetoi”.

Sipas historianit Grek, Ksenofonit, Tigrani ishte një nxënës i filozofëve dhe ai vetë ishte i njohur për njohuritë dhe talentin e vet.

Si një nga aleatët kryesorë të Kirit, Armenia kishte një pozicion të privilegjuar brenda perandorisë. Në vitin 529 para Krishtit, Kiri i Madh II<sup>të</sup> vritet dhe vendin e tij e zë i biri, Hambusesi (Hambis). Gjatë periudhës së sundimit të tij vazhdojnë të ruhen marrëdhëniet e aleancës ndërmjet Armenisë dhe Persisë. Tigran Jervantani vdes pesë vjet pas Kirit. Sipas Horenacit, atë e pason i biri i quajtur Vahak, i cili ka të ngjarë të thirrej me emrin e zotit suprem të ushtrisë Armene, ose duke e hyjnizuar, duke pasë parasysh me këtë zot (hyjni) personifikimin e vendit, zot i së cilës ishte.

Në vitin 522 para Krishtit, brenda Persisë lindin grindjet për fronin, të cilat më së fundi përfundojnë me fitoren e Darit të I<sup>të</sup>. Kur u bë e qartë, që pozicioni i Darit në fron tashmë ishte bërë solid, disa vende ngritën krye kundër perandorisë Akemene. Armenia nuk e njohu legjitimitetin e Darit në fron.

Dari ishte i detyruar, që në vitet e para të sundimit, të hynte në luftë me një sërë kundërshtarësh, për të cilat dëshmon shënimi i lënë prej tij në Behistun në tre gjuhë.

Në pjesën e shkruar Persisht të mbishkrimit, Armenia shkruhet Armina, në pjesën e shkruar në gjuhën Elamere shkruhet Harminuja dhe në pjesën e shkruar në gjuhën Babilonase shkruhet Urartu. Armenia

vazhdon të quhet “Urartu” edhe akoma më vonë, në shekullin e IV, në mbishkrimet Babilonase të lëna nga mbreti i Akemenëve, Artakserksi i II<sup>të</sup>, të cilat edhe njëherë akoma dëshmojnë, që emri “Urartu” ishte njeri nga emrat me të cilët emërtohej Armenia.

Në vitet 522 - 521 para Krishtit, Dari ndërmori disa fushata për rinënshttrimin e disa vendeve që nuk po pranonin të njihnin sundimin e tij. Në shkrimet e para të Behistunit, Armenia nuk përmendet në grupin e vendeve kryengritëse, gjë që do të thotë, se kjo e fundit ka qenë plotësisht e pavarur.

Nëqoftëse Dari arriti t’i nënshtrohte vendet e tjera me një fushatë të vetme, për të nënshtroar Armeninë j’u deshën pesë fushata; dhe vetëm pas fushatës së pestë, Armenët u detyruan t’i nënshtrohen Darit. Është po ai dorëshkrim, që na informon se kryengritjen që ishte përhapur brenda Babilonisë kundër Darit, e udhëhiqte “armeni Araham, djali i Haldit”. Kjo nga njera anë tregon, që në vitet 520 para Krishtit, brenda Armenëve vazhdonte të nderohej kulti i Haldit, nga ana tjetër tregon për aleancën e krijuar ndërmjet Armenisë dhe Babilonit. Mund të supozohet, që kryengritja Babilonase të ketë qenë e iniciuar nga Armenia, gjë që mund të shërbejë si dëshmi e dretpërdrejtë e ndikimit të Armenisë në ato zona.

Në vitin 521 para Krishtit, Armenia u detyrua ta njohë sundimin e Akemenëve, por edhe Persianët, nga ana e tyre, u detyruan të bëjnë lëshime. Brenda Armenisë vazhdojnë të mbretërojnë Jervantët, të cilët prisnin dhe përdornin paratë e tyre dhe drejtonin plotësisht jetën e brendshme të vendit.

Në vitin 520 para Krishtit, perandoria e Akemenëve u nda në 20 zona të mëdha administrative, të quajtura “Satrape”. Armenia formonte satrapin e XIII<sup>të</sup>, dhe mbeti në po ato kushte brenda organizimit të perandorisë Akemene deri në vitin 331 para Krishtit.

Në vitin 401 para Krishtit, gjenerali dhe historiani Grek, Ksenofoni, i cili qëlloi të kalonte nëpër hapësirat Armene, dëshmon se, në atë kohë satrapi i Armenisë ishte Orontasi (Jervanti i II<sup>të</sup>), i cili ishte martuar me

vajzën e Artakserksit të II<sup>të</sup>, mbretit të Akemenëve, dhe luante një rol të rëndësishëm brenda perandorisë.

Paratë prej ari, argjendi dhe bakri të prera prej Jervantit të II<sup>të</sup>, janë me figurën e tij. Të dhënat e fundit për të, i përkasin viteve 360 para Krishtit, sipas të cilave ai kishte kryesuar kryengritjen e disa satrapëve kundër Akemenëve, pas dështimit të së cilës, kishte gjetur strehim në Greqi (ku edhe vdiq në vitin 334 para Krishtit).

Sipas Ksenofonit, pjesa e Armenisë Perëndimore kishte udhëheqësin e vet, me emrin Tiribaz, që ishte vartës i Jervantit të II<sup>të</sup>. Çdo fshat kishte udhëheqësin e vet. Ksenofoni e përshkruan Armeninë si një vend shumë të pasur, me një popull mikpritës dhe që jetonte në gjendje të mirë. Ai vë në dukje se, nuk kishte shtëpi, e cila të mos i priste miqtë me pije dhe gjellëra me mish; në atë informacion, për herë të parë shfaqet birra, “një pije e përgatitur prej elbi, mbi sipërfaqen e së cilës notonin kokrrat e elbit”.

Dihet që, udhëheqësi (sovrani) i fundit i Akemenisë, Dari i III<sup>të</sup> Kodomanosi, përpara se të zinte fronin e Akemenisë, u bë satrapi i Armenisë dhe mbi kurorën e mbretit mbante emërtimin “Artashat”. Në vitin 336 para Krishtit, ai u bë zotëruesi i gjithë shtetit Akemen, ndërsa satrapi i Armenisë i kthehet përfaqësuesit të familjes së Hajkazun – Jervantideve, Jervantit të III<sup>të</sup> (Orontes), të cilit fati i kishte rezervuar të drejtën për t’i rikthyer Armenisë pavarësinë.



PJESA E DYTË

# KOHËT E VJETRA



## KREU 7

# MBRETËRITË ARMENE NË VITET 331 - 201 PARA KRISHTIT

### **Aleksandri i Maqedonisë dhe Armenia**

Siç është vënë në dukje edhe më sipër, udhëheqësi (sovrani) i fundit i Akemenisë, Dari i III<sup>të</sup> Kodomansi, që ndërkohë kishte qenë edhe satrapi i Armenisë, në vitin 336 para Krishtit u kurorëzua mbret. Po atë vit, pas vrasjes së babait të tij, Filipit të II<sup>të</sup>, në fronin e Maqedonisë kurorëzohet djali i tij njëzetvjeçar, Aleksandri, të cilit fati i kishte rezervuar të drejtën që të hynte në historinë botërore si një nga figurat më të shquara (me emrin “Aleksandri i Madh ose Aleksandri i Maqedonisë”).

Në vitin 334 para Krishtit, filloi luftën me perandorinë Akemenase dhe pati fitoren e parë në brigjet e lumit Granikos. Në pranverën e vitit tjetër, në fushën Issos të Kilikisë u zhvillua beteja e dytë e madhe ndërmjet tyre, ku ushtria Perse pësoi një humbje akoma më të rëndë; Dari detyrohet t’ja mbathë nga fusha e betejës, duke lënë rob pranë Aleksandrit nënën, gruan, dy motrat dhe djalin e mitur. Pas fitores së Issosit, Aleksandri vazhdon fushatën drejt Egjyptit, të cilin e nënshton pa ndonjë rezistencë serioze.

Pavarësisht nga kundërshtitë që kishte brenda stafit të vet, beteja vendimtare u zhvillua në 1 Tetor të vitit 331 para Krishtit, pranë Gaugamelës.

Dihet që, Armenët kishin qenë pjesë përbërëse e ushtrive Akemenase në të dyja betejat e humbura më parë ndaj Aleksandrit, në atë të Issosit dhe të Gaugamelës. Në betejën e Gaugamelës, fuqitë Armene udhëhiqeshin nga Orontes-Jervanti i III<sup>të</sup> dhe Mitraustesi. Moisi Horenaci dëshmon, se përballë Aleksandrit të Maqedonisë luftoi dhe u vra Vahe Hajkazuni. Me shumë mundësi, Vahe Hajkazuni duhet të ketë qenë prijës i ushtrisë Armene të përbërë nga 47 000 trupa në betejën e parë, në atë të Issosit, ku edhe u vra.

Në betejën e Gaugamelës (ashtu si edhe në atë të Issosit), Armenët ishin pjesë përbërëse e trupave të Akemenëve dhe fuqia kryesore e tyre në krahun e djathtë duke e udhëhequr atë. Dari edhe në këtë betejë, ashtu si edhe në të parën, e braktis fushën e betejës. Aleksandri vihet në ndjekje të Darit; ndërkohë dështon në sulmin ndaj krahut të djathtë të ushtrisë Akemene, ku peshën kryesore e mbanin forcat Armene. Kur u informua për ikjen e Darit, ushtria Armene “ me një tërheqje të shpejtë e të rregullt” doli nga fusha e betejës dhe u kthye në Armeni.

Pas kthimit në atdhe nga beteja e Gaugamelës, ku kishin luftuar me trimëri dhe me nder, në vitin 331 para Krishtit, ata rikthyen pavarësinë e Armenisë; në krye të Armenisë së Madhe u vu Orontes-Jervanti i III<sup>të</sup>, ndërsa në Armeninë e Vogël zotëroi Mitraustesi.

Përballja ushtarake e rradhës ndërmjet Maqedonasve dhe Armenëve ndodhi pas 2-3 vjetësh, kur Aleksandri dërgoi një nga njësitë e tij ushtarake të udhëhequr nga gjenerali Menon në zonën e Armenisë së Lartë, që ishte e pasur me mineral ari. Siç dëshmon kronikani Grek, Straboni, Armenët e asgjësuan atë njësi, kurse “gjeneralin e mbytën”. Pas kësaj, Aleksandri nuk bëri përcapje të tjera për të dërguar ushtri në Armeni. Faktet e njohura bëjnë me dije, që Aleksandri i Maqedonisë ishte i detyruar ta merrte në konsideratë fuqinë ushtarake Armene dhe t'i shmangej një përballjeje të re me ta.

Pak kohë pas betejës së Gaugamelës, në rrugën e ikjes, Dari i III<sup>të</sup> vritet nga të afërmit e vet. Perandoria Akemene fillon të jetojë rënien e saj; ndërkohë Aleksandri vazhdon fushatën drejt Azisë së Mesme dhe Indisë duke krijuar kështu një perandori gjigante të paparë, kryeqytet të

së cilës emëron Babiloninë. Aleksandri vdiq në vitin 323 para Krishtit, në moshën 33 vjeçare. Nëpërmjet fushatave të tij, në Azinë Perëndimore hyn Helenizmi dhe fillon epoka e Helenizimit (Greqizimit). Në këtë epokë Armenia hyn me pavarësi të plotë.

### **Historia e Aleksandrit dhe Armenia**

Për Aleksandrin ishin krijuar legjenda që në të gjallë të tij. Por vetëm në vitin 240 para Krishtit, për herë të parë, me legjendën e Aleksandrit u morën shkrimet Greke.

Sipas legjendës, Aleksandri synonte të arrinte pavdeksinë, dhe kjo ishte arsyeja që mori rrugën “drejt Hapësirave Armene, ku ishin burimet e Tigris dhe Eufratis”. Sipas versionit Sirian, gjatë rrugës atij i dolën para vargmalet Masis. Në po këtë rrugë kishte kaluar edhe heroi i famshëm i Lindjes së Vjetër, Gilgameshi (në shekullin e XXVII para Krishtit), i cili gjithashtu kërkonte pavdeksinë dhe ishte kthyer në një hero të gojëdhënave dhe legjendave. Në fakt, shprehja “në rrugën drejt Arattës” që ndodhet brenda legjendës së Lindjes së Vjetër është shndërruar “në rrugën drejt Hapësirave Armene” që ndodhet në legjendën Helene (Greke); po kështu malet Mashu (Masu) janë shndërruar në vargmalet Masis; në të dy rastet heroi shkon drejt burimeve të Tigris dhe Eufratis.

Ndonëse nuk hyri në tokat Armene, Aleksandri, brenda gojëdhënave merr rrugën e Armenisë, pasi sipas besimit shpirtëror të popujve të Lindjes së Vjetër, parajsa dhe pavdeksia ishin të lidhura me tokat Armene. Është karakteristik fakti që, në gojëdhënat dhe legjendat Armene përmendet ardhja e Aleksandrit të Maqedonisë në Armeni dhe mbretërit që i sjellin në dorë “ujin e pavdeksisë”. (“սիւմէլէտը” – është përkthyer – sui generis, të ngjashmit me të, mbretërit??).

### **Mbretëritë Armene dhe zotërimi Seleucid**

Armenia mbeti e pavarur edhe pas vdekjes së Aleksandrit, kur perandoria Maqedonase u nda në disa pjesë, nga të cilat, më e madhja ishte zotërimi Seleucid, që arrinte deri në kufi me Armeninë.

Sipas njoftimeve të Diodor Sikiliacit (shekulli i I para Krishtit), pas rënies së perandorisë Maqedonase, mbreti i Kapadokisë, Ariaratesi rihypi në fronin atëror me ndihmën e mbretit të Armenisë së Madhe, Ardasesit, “Ariaratesi, i mundur në fushën e betejës, ra nga fronti, dhe bashkë me të ranë nën sundimin Maqedonas edhe Kapadokia dhe tokat kufitare me të. Ndërsa Ariaratesi, djali i mbretit paraardhës, shpresëhumbur atëkohë për shkak të rrethanave të momentit, me pak njerëz që i kishin mbetur u detyrua të gjejë strehim brenda Armenisë. Ariaratesi, pasi u ndihmua nga mbreti i Armenisë me një ushtri të vogël, mposhti gjeneralin Maqedonas, Amuntasin, dhe rifitoi mbretërinë e të atit”. Kjo ka ndodhur rreth viteve 322 ose 301-300 para Krishtit. Këto fakte dëshmojnë që, Armenia e ribërë e pavarur, tashmë ishte një fuqi e konsoliduar në atë zonë.

Në shekullin e II para Krishtit, për sa kohë që Armenia e Madhe dhe ajo e Vogël bashkëvepronin në mirëkuptim me njera tjetrën, përpjekjet e Seleucidëve për të zotëruar Armeninë dështuan.

Një mbishkrim i gjetur në Armeninë e Vogël, që i përket shekullit të III para Krishtit dhe i shkruar në dy gjuhë, Greke dhe Aramaike, dëshmon që brenda Armenisë së Vogël mbretëronte Ariakesi, i cili në betejën e Gaugamelës udhëhiqte ushtrinë e Kapadokisë që ishte rreshtuar përkrah ushtrisë Armene, dhe më pas, djali i tij Oromani (ndryshe Aramaniani). Ky i fundit u pasua nga i biri që kishte marrë emrin e gjyshit “babait të madh”, Ariakes. Me sa duket, Ariakesi i vjetër ka mbretëruar në Armeninë e Vogël pas Mitraustesit.

Rreth viteve 260-240 para Krishtit mbreti Armeni i asaj kohe, Samos (Sham) Jervantakani, ndërtoi në qendër të Komagenit qytetin Samosat (Shamshat) dhe preu para, të cilat janë të parat para mbretërore Armene që kanë arritur deri tek ne (përpara kësaj ishin prerë para prej Jervantit të II<sup>të</sup> dhe Tiribazit, të cilët në krahinën e Akemenëve ishin satrapë Armenë). Në vitet 240 para Krishtit, Shamin e pasoi djali i tij, Arshami (Arsames). Ai ndërtoi qytetin Arshamashat brenda Xopkut (Sophene) dhe dy qytete me emrin Arsamea brenda Komagenit. Për Arshamin

thuhet që ishte aq i fuqishëm, sa që pati mundësi t'i jepte strehim vëllait të arratisur të mbretit të Seleucidëve.

Në fund të shekullit të III para Krishtit, Armenia ishte dobësuar. Kjo kishte krijuar kushte të favorshme për Seleucidët që të vinin në jetë planet e tyre të kahershme, favorizuar edhe nga ndarja e Armenisë në dy pjesë, Armenia e Madhe dhe Armenia e Vogël. Në vitet 201 para Krishtit, ushtritë e mbretit të Seleucidëve, Antiokosit të III<sup>të</sup>, me në krye gjeneralë me kombësi Armene, Artashesin dhe Zarehun, marshuan mbi Armeni. Jervanti i IV, i fundmi (rreth viteve 220-201) u vra gjatë betejës për mbrojtjen e kryeqytetit Jervantashat. Pas kësaj ra edhe qendra shpirtërore e Armenisë së Madhe, qyteti Bagarani, ku u vra edhe kryepriifti pagan, vëllai i mbretit Jervant. Kështu, në vitin 201 para Krishtit, mori fund edhe mbretërimi i degës së Hajkazun-Jervantunëve në Armeninë e Madhe.

Artashesi u vu në krye të pjesës së Armenisë së Madhe, ndërsa Zarehu në Xopk (Sophene), duke u emëruar Strategë nga ana e Seleucidëve. Kjo gjendje vazhdoi deri në vitet 190 para Krishtit, kur në Azinë e Vogël, pranë qytetit Magnesia, u zhvillua beteja vendimtare ndërmjet Seleucidëve dhe Romakëve, e cila përfundoi me humbjen e thellë të Antiokosit. Të ndihmuar nga rrethanat e krijuara, Armenët rifituan pavarësinë.



## KREU 8

# MBRETËRITË ARMENE NË SHEKULLIN E II PARA KRISHTIT

(ARMENIA E MADHE, ARMENIA E VOGËL, XOPKU, KUMMAGENI)

Pas betejës së Magnesisë në vitin 190<sup>te</sup> para Krishtit, të ndihmuar nga rrethanet e krijuara, Artashesi në Ameninë e Madhe dhe Zarehu në Armeninë e Vogël arritën të risjellin pavarësinë në këto vende. Romakët e njohën menjëherë pavarësinë e tyre. Në vitet 180<sup>te</sup> para Krishtit, në Armeninë e Vogël të pavarur sundonte Mihrdat Jervantuni, kurse në vitin 163 para Krishtit, Ptomesi, nipi i Arsham Jervantunit, e shpall Kommagenin të pavarur. Kështu, përgjatë viteve 190-160 para Krishtit fituan pavarësinë katër krahina Armene: Armenia e Madhe, Armenia e Vogël, Xopku (Sophene) dhe Kommageni.

### **Armenia e Madhe në kohën e sundimit të Artashesit të I<sup>re</sup>**

Në mbishkrimet me germa Aramaike të lëna nga Artashesi i I<sup>re</sup> (vitet 190-160 para Krishtit) mund të lexohet emri i fisit mbretëror “Jervantani”. Rrjedhimisht, është e besueshme, që mbreti i Armenisë së Madhe, Artashes, të ishte pinjoll i familjes Hajkazun – Jervantuni.

Detyra primare e Artashesit të I<sup>re</sup> ishte të përmbliedhte dhe të bashkonte në një unitet të vetëm krahinat e copëzuara të Armenisë së Madhe. Ai, prej Marastanit, Gjeorgjisë, Pontosit, pak më vonë edhe prej Seleucidëve, mori krahinat Kasp, Basoropedanin, Pavnitidesin,

Gugarkun, Kharçkun, Derçanin, Karinin, Jekehikun, Tmorikun dhe te tjera. Artashesi i I<sup>re</sup> përmbloodhi një pjesë të madhe të hapësirave Armene brenda mbretërisë së Armenisë së Madhe.

Pas vdekjes së Zarehut, përpjekjet e Artashesit të I<sup>re</sup> për t'ja bashkangjitur Xopkun (Sopheinin) Armenisë së Madhe dështuan për shkak të ndërhyrjeve të Kapadokisë.

Artashesi i I<sup>re</sup> bëri ndryshime të rëndësishme për mirë në jetën e brendshme të mbretërisë së tij. Ai e ndau ushtrinë në katër njësi të mëdha ushtarake, që ruanin të katër anët e kufirit. Hapësira e Armenisë së Madhe u nda në 120 provinca, u përmirësua sistemi i qeverisjes administrative të vendit.

Në krye të funksioneve më të rëndësishme qeverisëse, Artashesi i I<sup>re</sup> vendosi njerëzit e tij më të afërt. Djalin e tij më të madh, Artavazdin (më pas, Artavazdi i I<sup>re</sup>) e emëroi kryekomandant dhe gjeneral të njësisë ushtarake lindore. Drejtimin e njësisë ushtarake perëndimore ja besoi djalit të dytë, Diranit, atë veriore djalit të quajtur Zareh dhe atë jugor, kujdestarit të tij, Simbat Bagratunit. Detyrën e komandantit të prapavijës ja ngarkoi princit Vrujr, të cilin Horenaci e cilëson si “burrë i ditur dhe poet”. Djalin tjetër, Mazhanin, mbreti e emëroi Kryeprift pagan.

Gjatë sundimit të Artashesit të I<sup>re</sup> ekonomia pati një zhvillim të madh. Moisi Horenaci e karakterizon kështu kohën e tij “Brenda Armenisë nuk kishte mbetur pëllëmbë tokë e papunuar”. Me reformën tokësore lidhet edhe shfaqja e piramidave në formën e gurëve kufitarë, me mbishkrime në gjuhën Aramaike mbi to.

Në jetën e brendshme, një realizim i madh ishte edhe themelimi i kryeqytetit të ri, Artashatit, i cili u realizua në vitet 180-170 para Krishtit. Sipas dëshmisë së Plutarkut, zgjedhja e vendit për kryeqytetin dhe plani i propozuar mbretit, kishte lidhje me gjeneralin e syrgjynosur të Kartagenës, Hanibalin. Me këtë spjegohet fakti që në dorëshkrimet romake, Artashati gjendet me emërtimin “Kartagjena Armene”. Brenda Artashatit u ndërtuan pallate luksoze, faltore (tempuj), teatro

dhe ndërtime të tjera; ai u shndrrua në një nga qytetet më të mëdhenj të kohës së vet.

Artashesi i I<sup>rë</sup> e konsolidoi kultin e nderimit mbretëror të paraardhësve në Armeni, i cili kishte filluar të ngrihej që në shekullin e VIII para Krishtit (Brenda tempullit Artin-Musasir, në krah të përmendores se zotit më të madh të tyre, Haltit, ishin vendosur edhe përmendoret e mbretërve Armenë, të cilët shenjtëroheshin pas vdekjes). Brenda Artashatit u ndërtua tempulli i Nënës Mbretëreshë “Anahit”, ku u vendosën edhe përmendoret e mbretërve paraardhës Armenë.

Artashesi përmirësoi llogaritjet, kalendarin, fuqizoi lundrimin në liqene dhe lumenj, si edhe bëri shumë reforma të tjera për përmirësimin e mbretërisë së tij.

Në politikën e jashtme arriti rezultate serioze. Në fillimet e lavdishme të mbretërimit, duke krijuar aleancë me Romakët, Artashesi i I<sup>rë</sup> ndoqi një politikë që synonte dobësimin e mbretërisë Seleucide. Ndërkaq vazhdoi të ruante pavarësinë e plotë dhe të qëndronte asnjahës në atë zonë, duke qëndruar vigjilent në largësi ndaj Romës dhe ushtrive Romake. Siç është thënë edhe më sipër, ai e kishte mirëpritur dhe i kishte dhënë strehim armikut numër një të Romës, gjeneralit Kartagjenas, Hanibalit.

Në vitet 183 - 179 para Krishtit, brenda Azisë së Vogël filloi një luftë ndërmjet Pontosit dhe Armenisë së Vogël nga njera anë dhe Kapadokisë, Bitanit dhe Pergamonit nga ana tjetër. Për ndërprerjen e luftës dhe nënshkrimin e kontratës së armëpushimit një ndikim të fuqishëm patën dy fuqitë me ndikim në atë zonë, nga ana perëndimore Roma dhe nga ana lindore Armenia e Madhe. Artashesi i I<sup>rë</sup> ja arriti të zgjerojë hapësirën e Armenisë së Vogël në kurriz të Pontosit, me synim që në një të ardhme të afërt të përmbliedhte të gjithë tokat Armene në një mbretëri të vetme, gjë që nuk u bë realitet.

Veprimi i fundit i Artashesit të I<sup>rë</sup>, për të cilin ka dijeni, ka të bëjë me dobësimin e mbretërisë Seleucide. Kur satrapi i Marastanit, Timarkosi, ngrii krye kundër Seleucidëve dhe e shpalli veten mbret

(vitet 162-160 para Krishtit), Artashesi i I<sup>rë</sup> i dërgoi menjëherë në ndihmë forca ushtarake.

Për veprat e mëdha që ka bërë, Artashesi i I<sup>rë</sup> është përjetësuar në këngët e popullit. Atij i përkushtohen vargjet “Jervant dhe Artashes”, Artashes dhe Satenik”, Artashes dhe Artavazd”.

Pas Artashesit të I<sup>rë</sup>, në Armeninë e Madhe zotëruan djemtë e tij, Artavazdi i I<sup>rë</sup> dhe Diran-Tigrani i I<sup>rë</sup>. Me aq sa dihet nga të dhënat, gjatë sundimit të tyre nuk pushuan grindjet. Ndërmjet viteve 120-110 para Krishtit, përfundon lufta ndërmjet Parthës dhe Armenisë së Madhe me humbjen e kësaj të fundit, e cila u detyrua të çojë si peng pranë Parthëve princin Tigran, i cili në të ardhmen do të shndërrohej në Tigranin e Madh.

### **Mbretëritë e tjera Armene në shekullin e II para Krishtit**

Për mbretëritë e vogla Armene ka shumë pak informacion. Veçanërisht është e njohur që, Zarehun, mbretin e Xopkut e pasoi Arkatiosi, i cili themeloi kryeqytetin e ri Arkatioskertin. Në vitin 165 para Krishtit, mbreti i Seleucidëve, Antiokosi i II<sup>të</sup> Epipanesi, pas fushatës së pasuksesëshme ndaj Armenisë së Madhe, pushtoi Xopk-un dhe vuri nën zotërimin e vet Arkatioskertin. Arkatioskerti u shfaros. Antiokosi i II<sup>të</sup> hipi në fronin mbretëror të Xopkut një nga funksionarët e tij me emrin Kserkses. Ndërkohë, pas vdekjes së Antiokosit të II<sup>të</sup> në vitin 164 para Krishtit, Mitrabuzanesi (Meruzhani), vëllai i Arkatiosit, rivendosi pavarësinë e mbretërisë së Xopkut.

Pas vdekjes së Meruzhanit në Xopk, nuk ka më të dhëna të sakta rreth mbretërve që sunduan më pas. Në vitin 94 para Krishtit, kur Tigrani i Madh mbretërinë e Xopkut e përfshiu në Armeninë e Madhe, atje sundonte mbreti Artanes.

Në Armeninë e Vogël, pas Mhrdatit, i vetmi informacion që na arrin është ai i rreth vitit 194 para Krishtit, kur sunduesi i atjeshëm, Antipatros Jervantuni, birësoi bashkëatdhetarin e vet, Mhrdat Jevpatorin që ishte arratisur nga mbretëria e Pontosit, duke ja dorëzuar mbretërinë

trashëgimtarëve të tij. Kjo është arsyeja, që për Mihrtadin e II<sup>të</sup>, në burimet e shkruara të Pontosit thuhet “Mbreti i Pontosit dhe Armenisë” (ose “mbreti i Pontosit dhe Armenisë së Vogël”). Duke interpretuar këtë, mund të konsiderohet i besueshem edhe supozimi se, Mihrdati Pontaci mund të kishte gjak Jervantani nga lindja.

Përsa i përket mbretërisë Kommagene, dihet vetëm që, pas Ptomeos Jervantunit (viti 163 deri afërsisht 130 para Krishtit), atje sundoi Samosi i II<sup>të</sup> (rreth viteve 130-109 para Krishtit), të cilin e pasoi Mihrdati i I<sup>rë</sup> Kalinikosi (rreth viteve 109-70 para Krishtit). Ky i fundit, në vitet 80<sup>të</sup> para Krishtit, pranoi vullnetarisht sovranitetin e Tigranit të II<sup>të</sup> të Madh, duke ruajtur plotësisht rolin dhe të drejtat e tij.



## KREU 9

# ARMENIA NË KOHËN E SUNDIMIT TË TIGRANIT TË MADH (TIGRANIT TË II<sup>TË</sup>)

Tigrani i Madh lindi në vitin 140 para Krishtit. Ndërmjet viteve 120-110 para Krishtit, pas luftës së pasuksesëshme të Armenisë së Madhe me Parthët, princi Tigran dërgohet si peng pranë Parthëve.

Pas vdekjes së mbretit Armen në vitin 95 para Krishtit, princin Tigran e kthejnë në Armeni, me kusht që në këmbim të kthimit të lëshojë disa toka Armene në favor të Parthëve.

Fillimisht, si detyrë e domosdoshme dilte bashkimi i tokave të Armenisë së Madhe, gjë të cilën Artashesi i I<sup>të</sup> nuk kishte arritur ta realizonte. Në vitin 94 para Krishtit, Tigrani i II<sup>të</sup> mundi brenda në Xopk Artanes Jervantunin dhe ribashkoi Xopk-un me Armeninë e Madhe.

Mbreti i Pontosit dhe Armenisë së Vogël, Mihrdat Jevpatosi, kishte si synim që t'i dëbonte Romakët nga Azia e Vogël dhe nga Greqia. Ndërsa synimet zotëruese të Tigranit të Madh lidheshin me Armeninë Lindore, dhe tokat që ndodheshin në jug dhe jug-perëndim të saj. Të dy këto vende duhej, gjithashtu, të siguronin edhe shpinën, pasi që të dyja rrezikonin të konfliktoheshin me Romën dhe Parthët. Në këto rrethana, Tigrani i Madh dhe Mihrdat Jevpatosi, në vitin 94 para Krishtit nënshkruajnë një marrëveshje aleance, e cila konsolidohet me martesën e Tigranit të Madh me vajzën e Mihrdat Jevpatosit. Manifestimi i parë praktik i kësaj marrëveshjeje të nënshkruar erdhi në vitin 93 dhe 91 para Krishtit me pushtimin ushtarak të Kapadokisë



“Tigran i Madh i shoqëruar nga katër mbretër”, nga piktori italian Z. Fugaro, 1885

nga ana e ushtrive Armeno-Pontosiane. Për të dytën herë hapësira e Kapadokisë i kalonte Pontosit, ndërsa pasuria e lëvizshme (tërë ushtria dhe robërit) i kalonte Armenisë së Madhe. Ngjarjet e mëpastajme na japin mundësi të gjykojmë mbi llogaritjet afatgjata të bëra nga Tigrani i Madh. Duke futur nën zotërimin e tij Kapadokinë, ai praktikisht kishte sjellë përplasjen me Romën, e cila ishte gjëja më pak e dëshirueshme për Tigranin e Madh në ato momente. E kundërta, ai po parapërgatitej për një betejë me Parthët, gjë për të cilën atij i duhej ta forconte paraprakisht mbretërinë me bazë të fuqishme ekonomike dhe njerëzore.

### Mbretëria e Tigranit të Madh

Në vitin 87 para Krishtit, vdes mbreti i Parthëve, Mihrdati i II<sup>re</sup>, të cilit Tigrani i II<sup>te</sup> i kishte dhënë për grua vajzën e tij Ariazata-Avtoma. Në vitet e fundit të jetës së Mihrdatit të II<sup>re</sup>, në Parthë kishin nisur luftëra të brendshme. Kishte ardhur momenti i duhur. Po atë vit, viti 87 para Krishtit, Tigrani i Madh ndërmerr një fushatë ndaj Parthëve.

Duke shpartalluar ushtritë Parthe, Tigrani i Madh arriti në dyert e kryeqytetit Ekpatan dhe e rrethoi atë. I frikësuar, mbreti i Parthëve i lëshoi Tigranit të Madh jo vetëm tokat e pushtuara, por edhe sovranitetin e plotë duke e quajtur “Mbret mbi mbretërit”. Marrja e sovranitetit të Tigranit të Madh mbi Parthën dhe vendosja e zotërimit mbi të tregohet qartë në informacionin që jep Pompeos Trogosi, ku në listën e mbretërve të Parthës, pas Mihrdatit të II<sup>re</sup> përmendet Tigrani “atë e thërrisnin Zot”.

Pas betejës me Parthën, sovranitetin e Tigranit të Madh e pranuan ose u bënë aleatë të tij edhe shumë fise të tjera të Azisë së Mesme, të cilët ishin të detyruar që në rast lufte t’i vinin Tigranit në dispozicion ushtritë e tyre. Në vitin 85-84 para Krishtit, mbretërisë Armene ju bashkuan edhe Kommageni, Mesopotamia Armene, Korduku, Osrojeni dhe Miktonia. Perandoria Seleucide kishte kohë që përballej me luftra të brendshme që kërkonin ta copëzonin atë. Më së fundi Këshilli i Lartë i Seleucidëve vendosi ta lerë të lirë copëzimin e tokave duke ftuar çfarëdo lloj mbreti të huaj që të bëhej pjesë e këtij procesi. Diskutuan për shumë kandidatë të mundshëm dhe më së fundi zgjedhja ra mbi Tigranin e Madh, i cili në vitin 83 para Krishtit, në Antioki, hypi mbi fronin mbretëror të Seleucidëve dhe e qeverisi mbretërinë Seleucide për 17 vjet rresht.

Në vitet 83-81 para Krishtit, zotërimeve të Tigranit ju bashkuan edhe Kilikia dhe Fenikia. Pas përfshirjes së qyteteve Fenikase brenda zotërimeve Armene, në vitin 81 para Krishtit, Tigrani u dhuroi atyre “lirinë” (u la një hapësirë të madhe vetvendosjeje). Dhe në shenjë mirënjohjeje, qytetet (ku përfshiheshin Periti, aktualisht kryeqyteti i sotëm i Libanit, Bejruti, Lavodikeni dhe të tjerë) filluan ta numërojnë kalendarin e tyre duke filluar nga ai vit dhe paratë e reja të qytetit të nxjerra në qarkullim t’i datojnë sipas atij kalendari. Zotërimi Armen, madje edhe brenda vetë tokave të nënshtruara prej saj, ishte çlirues (liberal).

Në sajë të ndihmës së Tigranit të Madh, Ptohomesi i XII<sup>te</sup>, (babai i ardhshëm i Kleopatërës) në vitin 80 para Krishtit, i dëboi nga Egjipti Romakët dhe forcoi mbretërinë e vet. Mbretëria “Napetakane”, e mundur në vitin 72 para Krishtit, u detyrua të pranojë sovranitetin e Tigranit të Madh. Sovranitetin e tij e njohu edhe Izraeli.

Ka baza për të supozuar, se në vitet 72-71 para Krishtit, Tigrani i Madh dërgoi një njësi kalorësish në Itali për të mbështetur kryengritjen e Spartakut, dhe më pas, në rrethana të caktuara të mund të luante një rol të rëndësishëm, i cili u asgjësua plotësisht në kohën e shtypjes së kryengritjes së Spartakut. Nga ana e saj, Roma, në vitin 71 para Krishtit, në kundërpërgjigje ndaj Tigranit të Madh, kishte ndërsyer ndaj tij përfaqësuesin e familjes mbretërore Seleucide, Kleopatrën Selene; Tigrani i Madh e rrethoi atë në Ptolemajis, e zuri rob dhe më pas e ndëshkoi me vdekje.

Kështu, përgjatë një çerek shekulli (95-70 para Krishtit), Tigrani i Madh krijoi një zotërim, kufijtë e të cilit dhe sfera e ndikimit politik të të cilit shtriheshin nga Egjypti dhe Deti Mesdhe deri në malet e Kaukazit, Deti Kaspik, Industan dhe luginat e Amurdarjas, Deti i Zi dhe deri në Detin Persik. Hapësira e zotërimeve Armene, krahas me sferën e ndikimit politik, shtrihej në një zonë prej afro 3 milion km<sup>2</sup>.

### **Qendrat e banuara të themeluara nga Tigrani i Madh**

Në vitet 80 para Krishtit, Tigrani i Madh themeloi një kryeqytet të ri, Tigranakertin, në një vend që ishte edhe brenda territorit të Armenisë, por që, relativisht, ishte edhe në një pozicion në qendër të zotërimeve të tij. Ky vend ishte ai në të cilin, në vitin 95 para Krishtit, kishte mbretëruar princi Tigran. Në fakt, ndonëse në atë kohë ai ishte në moshë fëminore, ai ishte edukuar me artin e të mbretëruarit dhe në përfytyrimet e tij ekzistonte projekti i mbretërimit të ardhshëm, sipas të cilit, më pas, vendosi pozicionin e kryeqytetit të mbretërisë së tij.

Qyteti ishte i rrethuar me 50 vendqëndrime (“լուսնու”), me një mur 25 metra të lartë, kishte fortesa të pathyeshme, pallate, teatro, lulishte, vreshta dhe vende gjuetie. Brenda një kohe shumë të shkurtër u ndërtua një qytet i madh dhe i bukur. Të tërheq vëmendjen një vrojtim i bërë në një shkrim Romak, ku shihet me zili fakti se sa shpejt e lulëzuan Armenët kryeqytetin e tyre dhe këtë e bënë “në emër të mbretit për të cilin ushqenin dashuri dhe respekt”.

U ndërtua në atë vend, pasi kishte rëndësi jetike edhe për Rrugën Mbretërore, e cila lidhte Tigranakertin me kryeqytetin e lashtë Armen, Artashatin. Përveç kryeqytetit, Tigranakertit, Tigrani i Madh themeloi edhe një sërë qytetesh të tjerë me emrin e tij; me emërtimin “Tigranakert” u ndërtuan disa qytete në Mesopotaminë Veriore, në veri të Asorisë (pranë Zekmanit), brenda krahinave të Arcahut dhe Utikut, si edhe dy vendbanime me emërtimin “Tigranavan” në Marasdan (Media) dhe Gokten.

### **Lufta Romako – Armene. Beteja e Artashatit**

Në vitin 71 para Krishtit, Mîhrdat i VI<sup>të</sup> Jevpatori u mund në betejën me Romakët dhe kërkoi e gjeti strehim në Armeni. Në ndjekje të tij, Lukulusi dërgoi urdhër për dorëzimin e këtij armiku të betuar të Romës. Tigrani i madh e refuzoi kërkesën e Romakëve dhe nuk e dorëzoi aleatin dhe mikun e tij. Në pranverën e vitit 69<sup>të</sup> para Krishtit, Lukulusi marshoi kundër Armenisë. Pavarësisht nga sukseset e Romakëve në fillim të fushatës, ajo përfundoi me shpartallimin e ushtrisë Romake dhe nxjerrjen jashtë kufijve të Armenisë. Me ndihmën e ushtrive Armene, Mîhrdat i VI<sup>të</sup> Jevpatori çliroi Pontosin, duke i nxjerrë jashtë tij Romakët.

Tigrani i madh dhe Mîhrdat i VI<sup>të</sup> Jevpatori, në vitin 67 para Krishtit po planifikonin të organizonin një fushatë të madhe kundër Romës, e cila nuk arriti të bëhej realitet.

Në fund të vitit 67 dhe në fillim të vitit 66 para Krishtit u krijua një aleancë ndërmjet Romakëve dhe Parthëve përballë aleancës Armeno-Pontosiane. Pati përplasje ndërmjet dy grupeve. Romakët fituan dhe morën Pontosin, ndërsa Parthët humbën brenda në Armeni dhe u detyruan të kthehen mbrapsht. Nga të dy anët, njeri vend fitoi dhe tjetri humbi.

Ndërmjet dy vendeve fituese, Romakëve me Pompeun në krye dhe Armenëve me Tigranin e Madh në krye, në vitin 66 para Krishtit, në Artashat, u nënshkrua një marrëveshje paqeje, sipas së cilës, në dobi

të Romës, Armenia detyrohej të hiqte dorë nga zonat e pushtuara në Eufratin perëndimor. Armenia e Madhe u deklarua “aleat dhe mik” i Romës, gjë që nënkuptonte ndihmë reciproke luftarake. Djali i Tigranit duhej të njihej si mbret i Xopk-ut dhe Korduk-ut, ndërsa pas vdekjes së të atit, mbret i gjithë Armenisë së Madhe, gjë kjo që nuk u bë realitet, pasi ai u arrestua dhe u syrgjynos në Romë.

Përse Tigrani i Madh u detyrua të bëjë lëshime të tilla? A nuk ishte ai, që kishte dalë fitues ndaj Romakëve në vitet 69-68 para Krishtit në betejën me Lukulusin, ai që me Pompein nuk kishte pasur përplasje serioze, ai që u kishte shkaktuar humbje rradhazi dha pastaj shpartallimin përfundimtar Parthëve në vitin 66 para Krishtit? Ky hap, në pamje të parë i pashpjegueshëm, spjegohet me përgjegjësinë atdhetare të Tigranit të Madh. Ai, vërtet kishte fituar, por ishte në shtërngesë, dhe, në fakt, kishte dalë jashtë loje aleati i Armenisë, Pontosi, ndërsa vetë Armenia kishte mbetur vetëm përballë Romës dhe Parthëve, thënë kjo me një fjalë “i vetëm përballë gjithë botës”. Tigrani mund ta vazhdonte luftën për hir të lavdisë së tij si mbretërues, por në këtë mënyrë do të dëmtonte të ardhmen e atdheut të vet. Kur në kupat e peshores viheshin nga njera anë lavdia e tij dhe nga ana tjetër e ardhmja e atdheut, Tigrani zgjodhi këtë të fundit.

Tigrani i Madh vdiq në vitin 55 para Krishtit në moshën 85 vjeçare.

Një nga figurat më të shquara të Romës, Ciceroni, në fjalimet e tij në Senat e cilësonte Tigranin e Madh “i furishmi”, gjë që përbente një vlerësim të madh në sytë e Romakëve. Një tjetër shkrimtar Romak, që ka jetuar në një kohë pak më të vonshme, Veleus Paterkulos, e ka cilësuar Tigranin e Madh “mbreti më i fuqishëm i kohës së tij” dhe “më i madhi i mbretërve”, ndërsa Pompeos Trokosi informon se atë e lartësonin duke e quajtur “Zot”..

## KREU 10

# ARMENIA NË PERIUDHËN E RËNIES SË DINASTISË ARTASHESIANE

Në vitet që pasuan mbretërimin e Tigranit të Madh, Armenia u përball me një realitet të ri të politikës botërore; ajo tashmë gjendej në qendër të përplasjes së dy fuqive të mëdha të asaj kohe, Romës dhe Parthës.

Tigranin e Madh e pasoi në fron i biri, Artavazdi i II<sup>të</sup> (vitet 55-34 para Krishtit), i cili kishte marrë një arsimim të shkëlqyer dhe ishte shumë i dhënë pas veprimtarisë intelektuale; sipas dëshmisë së historianit të shekujve I dhe II, Plutarkut, “Artavazdi i II<sup>të</sup> kishte shkruar tragjedi, ligjërata dhe shkrime historike”.

Në vitin 54 para Krishtit, me qëllim organizimin e një fushate kundër Parthës, Mark Kراسi zbriti në Asori (Siria e sotme) dhe u takua me Artavazdin e II<sup>të</sup> duke i kërkuar të jepte ndihmën e tij në këtë fushatë në bazë të marrëveshjes së Artashatit. Artavazdi i II<sup>të</sup> e këshilloi që ta fillonte fushatën nga krahinat malore jugore të Armenisë, në rrethinat e të cilave ai mund të ngrinte në këmbë një ushtri të përbërë nga 30 mijë këmbësorë dhe 16 mijë kalorës. Kراسi, ndërkohë, vendosi të marshojë në drejtim të Mesopotamisë Veriore dhe, në vitin 53 para Krishtit, me një ushtri të përbërë nga 42 000 vetë (7 legjione) filloi fushatën. Në përgjigje të fushatës, Parthët organizuan dy ushtri; njera e drejtuar nga gjenerali Suren, i cili doli përballë Kراسit, dhe tjetra e drejtuar nga mbreti Orodosi i II<sup>të</sup>, i cili ju drejtua Armenisë. Artavazdi i II<sup>të</sup> njoftoi menjëherë Kراسin për këtë situatë dhe refuzoi të shkonte në ndihmë të tij.

Më 6 Maj të vitit 53 para Krishtit, në betejën e zhvilluar në Harran, ushtria Romake pësoi një disfatë të rëndë duke lënë në fushën e betejës rreth 20 000 të vrarë (në mes tyre edhe Krasit) dhe 10 000 robër. Koka e Krasit u dërgua në Artashat, ku Artavazdi i II<sup>të</sup> dhe Orodesi i II<sup>të</sup>, pasi nënshkruan marrëveshjen e aleancës, për të përforcuar atë, po festonin martesën e princit të Parthëve, Bakuri, me motrën e Artavazdit të II<sup>të</sup>. Koka e Krasit arriti në Artashat pikërisht në atë moment, kur të dy mbretërit, brenda në teatër, po shihnin tragjedinë “Βασιλική Βακχική” (Pleqtë e Bakosit – Banorët e Bakosit) të Euripidit. Koka e Krasit u hodh përpara të dy mbretërve në shenjë fitoreje.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes ndërmjet Armenëve dhe Parthëve, ushtritë e bashkuara të të dy vendeve nën komandën e princit Bakuri, në vitet 51-50 dhe 40-38 para Krishtit, duke mundur Romakët, arritën të pushtojnë Palestinën, Fenikinë, Asorinë dhe hynë në Kilikia.

Fitoret e ushtrive të bashkuara Armeno-Parthe në Mesdheun Lindor sollën një shqetësim të madh brenda në Romë. Në lindje u dërgua gjenerali Basos, përballë të cilit, në betejën e vitit 38 para Krishtit, u



Pjesa e sapo gërmuar e kryeqytetit Artashat me pamje malet e Araratit

vra edhe Bakuri, trashëgimtari i fronit. Në vitin 37 para Krishtit, vëllai i Bakurit, ndonëse akoma shumë i ri, vrau të jatin, Orodesin e II<sup>të</sup>, hypi në fronin mbretëror dhe asgjësoi të gjithë pretendentët e mundshëm për fronin; ndërmjet të tjerëve edhe të gjithë fëmijët meshkuj të lindur nga martesat e Bakurit dhe motra e Artavazdit të II<sup>të</sup>. Aleanca Armeno-Parthe u prish.

Në vitin 37 para Krishtit, në Lindje erdhi Mark Antoni, me të njëjtin plan për të sulmuar Parthën, i cili, duke pasur parasysh humbjen e hidhur të Krasit, po planifikonte të sulmonte nga ana e hapësirave Armene. Romakët me sulme të shpejta e të befasishme hynë në Armeni. I mbetur vetëm dhe duke mos pasë asnjë ndihmë nga Parthët, Artavazdi i II<sup>të</sup> pranoi t'i kthehej marrëveshjes detyruese të Artashatit të vitit 66 para Krishtit. Artavazdi i II<sup>të</sup> pranoi t'i jepte Mark Antonit një ushtri prej 6 000 kalorësish dhe 7 000 këmbësorësh për fushatën që ky i fundit kishte planifikuar të niste ndaj Parthës, si edhe ta lejonte që këtë fushatë ta zhvillonte nga ana e hapësirave Armene.

Në vitin 37 para Krishtit, Mark Antoni me një ushtri prej 100 000 vetësh, 300 kulla të lëvizëshme të vendosura mbi rrota, gurëhedhës dhe makineri të tjera luftarake, nga fusha e Karnisë filloi fushatën drejt Atrapatakanit. Duke avancuar me makineritë ushtarake, Antoni rrethoi fillimisht qytetin Gancak të Atrapatakanit. Ushtria Parthe që po vinte përballë qarkoi rrethimin dhe asgjësoi makineritë e luftës që hasi gjatë rrugës. Ishte e qartë që Antoni do ta humbte luftën, kështu që Artavazdi i tërhoqi mbrapsht njësitë e tij ushtarake dhe nuk mori pjesë në betejë.

Antoni pësoi humbje të rënda dhe në vjeshtë u detyrua të tërhiqej në Armeni. Artavazdi i II<sup>të</sup> e ndihmoi me ilaçe dhe ushqime.

Ushtritë Romake humbën në total rreth 35 000 mijë njerëz pa arritur të pushtojnë as edhe një metër tokë. Antoni nxitoi për në Egjipt, pranë gruas së tij, Kleopatërës së VII<sup>të</sup>. Në letrat që i dërgonte Senatit të Romës, ai të gjithë fajin për humbjet ja ngarkonte “tradhëtisë” së Artavazdit. Duhej “ndëshkuar” Artavazdi, dhe për këtë u përpoq disa herë me dredhi ta arrestonte, por pa sukses.

Në vitin 37 para Krishtit, ushtritë e Antonit me sulme të shpejta e të befashme hynë në Armeni. Me qëllim që të shmangte gjakderdhjen, mbreti Armen kërkoi të hynte në bisedime. Antoni, duke e mashtruar, arriti të arrestonte Artavazdin, gruan e tij dhe të dy djemtë. Pas arrestimit të mbretit, ushtria Armene emëroi si mbret djalin e tij Artashesin e II<sup>te</sup>, veprim ky që, duke gjykuar nga faktet, kishte qenë porosi e vetë Artavazdit të II<sup>te</sup>. Artashesi i II<sup>te</sup> dështoi në përpjekjet e tij për të luftuar Romakët dhe u detyrua që së bashku me ushtrinë e tij të kërkonte strehim në Parthë. Antoni pasi la brenda Armenisë garnizone ushtarake, u kthye përsëri në Egjipt. Në Aleksandri ai organizoi një festë fitoreje, gjatë së cilës i kërkoi Artavazdit të II<sup>te</sup> dhe familjes së tij të marrë rob, që të nderonin dhe t'i përkuleshin Kleopatrës, dhe në këmbim të kësaj i premtoi lirinë. Mbreti krenar Armen dhe familja e tij refuzuan në mënyrë kategorike kërkesën e tij, aq sa fituan edhe respektin e Romakëve të pranishëm në këtë ngjarje. “As ju lutën asaj (Kleopatrës), as ju përkulën, sado që i shtrënguan dhe u dhanë shpresë se do t'i linin të lirë, dhe pasi e thirrën atë vetëm me emër, fituan simpatinë e fisnikëve” (Dion Kasius, “Historia e Romës”).

Brenda Romës, lufta për pushtet absolut ndërmjet Antonit dhe Oktavianit arriti pikën kulmore me betejën e vitit 31 para Krishtit. Antoni u mund dhe vrau veten. Fatin e tij pati edhe Kleopatra. Para kësaj ngjarje, dënimit me vdekje nuk i kishte shpëtuar as Artavazdi i II<sup>te</sup>, koka e të cilit ju dërgua aleatit të Antonit dhe Kleopatrës, mbretit të Atrapatakanit, Artavazd Metacit (Մար Արտավազդիս).

Në fund të vitit 31 para Krishtit, Artashesi i II<sup>te</sup>, me ushtrinë e vet u kthye nga Partha, çliroi Armeninë, mundi mbretin e Atrapatakanit, Artavazd Metacin dhe ja bashkoi Atrapatakanin mbretërisë së vet. Artashesi i II<sup>te</sup> mbretëroi deri në vitin 20 para Krishtit. Ai e lulëzoi vendin dhe nxori para (monedha) me mbishkrimin “Mbreti i mbretërve”.

Në vitin 27 para Krishtit, Oktaviani shpalli brenda në Romë monarkinë, duke u vetëquajtur “August” (“i shenjtë”, “i lartësuar me dëshirën e Zotave”). Në vitin 20 para Krishtit, kur ai erdhi në Asori, kishte planifikuar që të kthente në fronin mbretëror të Armenisë

Tigranin, i cili ishte njeri prej djemve të zënë rob të Artavazdit të II<sup>te</sup>. Kur ushtria Romake sapo kishte hyrë në hapësirën Armene, në rrethana krejt të panjohura u vra Artashesi i II<sup>te</sup>; kështu që ndërrimi i mbretit u bë pa luftë.

Tigrani i III<sup>te</sup> sundoi në Armeninë e Madhe në periudhën ndërmjet viteve 20-9 para Krishtit. Oktaviani e vendosi atë në fronin Armen me kusht, që edhe pasardhësit e tij të mbështesnin Romën. Por Perandoria Romake u gabua në llogaritë e saj. Pas njëfarë kohe të sundimit të Tigranit të III<sup>te</sup> në Armeni, ai u “riArmenizua” shpirtërisht dhe duke u ndërgjegjësuar për rëndësinë e trashëgimisë së sundimit mbretëror, emëroi si pasardhës trashëgimtar të fronit mbretëror djalin e tij, që kishte po emrin Tigran, i cili më pas hypi në fron duke ndarë qeverisjen së bashku me të motrën, Eratuhi.

Roma nuk mund të pajtohej me humbjen e ndikimit të saj brenda në Armeni dhe në vitin 5 para Krishtit me forcën e ushtrisë hypi në fron xhaxhain e Tigranit të IV, Artavazdin e III<sup>te</sup>. Djali i Artavazdit të II<sup>te</sup>, i marrë rob, kishte jetuar për 29 vjet në ambientet e Romës. Në vitin 2 para Krishtit, Armenët rrëzojnë nga fronti Artavazdin e III<sup>te</sup> dhe hypin përsëri në fron Tigranin e IV dhe motrën e tij, Eratuhinë.

Oktaviani ishte i detyruar ta merrte në konsideratë çështjen Armene. U parashikuan negociata me Tigranin e IV<sup>te</sup>, por në vitin 1 para Krishtit, në betejë me malësorët e veriut ai mbeti i vrarë, ndërsa e motra, Eratuhia, hoqi dorë nga fronti. Këtu mbaron edhe mbretërimi i fisit mbretëror Artashesian (por jo mbretëria Armene). Në vitet 6-11 pas Krishtit, Eratuhia ishte përsëri në fronin mbretëror, por e vetme dhe e pamartuar, gjë që nuk mund ta shpëtonte situatën e Artashesianëve.



## KREU 11

# MBRETËRIA E ARMENISË SË MADHE NË SHEKUJT I - III

Pas rënies së Dinastisë Artashesiane, në Armeninë e Madhe u ruajt mbretëria. Mbreti Armen tashmë gjendej në fushën e luftës nëpërmjet marrëveshjeve Romako-Parthe, të realizuara ndërmjet funksionarëve të këtyre vendeve. Ishte krijuar një situatë tepër e vështirë për vendin. Nga viti 1 deri në vitin 50 pati dhjetë ndërrime mbretërishe.

Në marrëveshje me pleqësinë e Armenisë, Dertati, vëllai i mbretit të Parthës, Vaharshit të I<sup>rë</sup>, hyn në Armeni dhe në bashkëveprim me princërit Armenë e dëbon funksionarin e vënë nga Roma si mbret, princin Gjeorgjian, Hradamizd. Në vitin 53, Hradamizdi me ndihmën e ushtrive Romake e rimmerr fronin e Armenisë, por në vitin 54, Dertati me ndihmën e ushtrive Parthe e dëbon nga fronti Armen, gjë kjo që shkaktoi edhe luftën 10-vjeçare Romako-Parthe. Perandori i Romës, Neroni, dërgon në lindje gjeneralin Korbulos, i cili në vitin 58 pushton Artashatin. Forcat kryesore Parthe po luftonin në Lindje, në zonën e Verkanacit, ndërsa Dertati pa ndonjë rezistencë serioze zmbrafs Atrapatakanin. Në vitin 59, Korbulo shkatërron muret rrethues të Artashatit, pastaj merr Tigranakertin, dhe me këtë rast në Romë priten monedha me mbishkrimin “Armenia e nënshtuar”.

Në vitin 60, Neroni emëron Tigranin e VI<sup>e</sup> si mbret të Armenisë (nga shtëpia mbretërore e Kapadokisë). Në vitin 61, me nxitjen e Romës, Tigrani i VI<sup>e</sup> pushton shtetin e Adiabenit, dhe fillon lufta e

rradhës ndërmjet Romës dhe Parthës. Në vitin 61 Parthët nënshkruajnë marrëveshje paqeje brenda botës lindore dhe të gjitha fuqitë e tyre ushtarake i drejtojnë kundër Romës. Po atë vit nënshkruhet marrëveshje e armëpushimit ndërmjet Romës dhe Parthës, sipas së cilës, ushtritë Romake dhe ato Parthe duhej të dilnin jashtë kufijve Armenë deri në nënshkrimin e kushteve të paqes.

Në vitin 62, me qëllim ndërmarrjen e një fushate të re, në Lindje dërgohet gjenerali Petos. Në verën e vitit 62 Petosi kalon Eufratin. Përballë tij vendosen forcat e bashkuara Armeno-Parthe. Në vendin e quajtur Hrantia, forcat e bashkuara Armeno-Parthe arrijnë që ta rrethojnë ushtrinë e Petosit, i cili çarmatoset dhe detyrohet të kalojë nën kubënë poshtëruese të formuar nga shtizat e luftëtarëve, dhe pastaj i çarmatosur tërhiqet deri në Kapadoki. Në vitin 63, për të luftuar dhe për të vendosur për marrëveshje paqeje, Neroni cakton me fuqi të plota të jashtëzakonshme gjeneralin Korbulos, i cili në vitin 64 nënshkruan paqen, pa marrë parasysh kundërshtimin e ushtarakëve. Me kërkesën e Dertatit, marrëveshja e paqes u nënshkrua po në vendin e quajtur Hrantia. Sipas marrëveshjes së paqes, Dertati njihej mbret i Armenisë së Madhe, por për të marrë kurorën do t'i duhej të shkonte në Romë, e cila do t'i jepej prej vetë Neronit. Në vitin 65, Tigrani me 3 000 truproja arrin në Romë, merr kurorën nga Neroni dhe në vitin 66 kthehet në Armeni. Në atë vit, ai emërtohet zyrtarisht Dertati i I<sup>e</sup> dhe po ai vit njihet si viti i konsolidimit të Dinastisë Arshakuniane në fronin e Armenisë.

Muret rrethues të Artashatit, të rrënuara plotësisht gjatë luftës, u rindërtuan në saje ndihmës në të holla që i dha perandori Neron, si edhe të kontributit të mjeshtërve ndërtues. Në vitin 76 u ndërtua edhe fortesa dhe tempulli në Garni. Falë marrëveshjes së Hrantit, në Armeni mbizotëroi paqja për afro 50 vjet.

Marrëveshja e Hrantit u vlerësua si tepër pozitive në ambientin Armen, ndonëse po të shihet me sy realist ajo në një farë mënyre dëmtonte interesat e saj kombëtare-politike. Sipas kushteve të përcaktuara në të ishte mbretëria Parthe ajo, që kishte të drejtën të propozonte kandidatin për fronin mbretëror të Armenisë së Madhe,



Tempulli i Areg-Mihrës në Garni

ndërsa Roma kishte të drejtën e miratimit. Vullneti i Këshillit Armen ishte plotësisht i anashkaluar. Përveç kësaj, kjo marrëveshje i jepte të drejtën të dy këtyre vendeve fqinje, që jo vetëm të ndërhyjnë në punët e brendshme të Armenisë, por edhe që problemet e fronit mbretëror Armen t'i shfrytëzonin në interes të përfitimit të vendeve të tyre, gjë që solli si pasojë prishjen e marrëveshjes pa kaluar akoma një gjysëm shekulli.

Pasardhësi i Dertatit të I<sup>ë</sup>, mbreti Sanatruk, mbretëroi deri në vitin 110. Pas vdekjes së tij, mbretëria Parthe propozoi princin Ashhadar për mbret të Armenisë, gjë që u miratua nga Roma. Në vitin 113, mbreti i ri i Parthës, Hosrovi, pa miratimin e Romës, çkurorëzoi Ashhadarin dhe emëroi mbret të Armenisë vëllain e tij, Partamasirin. Këtë veprim, Romakët e konsideruan si shkelje të marrëveshjes së Hrantit dhe duke marrë shkas nga kjo, në vitin 114, Perandori Romak, Trajani, filloi luftën dhe pushtoi territorin e Armenisë dhe e shpalli krahinë (provincë) të Romës.

Në vitin 117, pas vdekjes së Trajanit, Perandori i ri, Adriani, duke e kuptuar gabimin e paraardhësit të tij në lidhje me strategjinë luftarake, nënshkroi një marrëveshje me Parthën dhe shpalli si mbret të Armenisë djalin e Sanatrukut, Vaharshin e I<sup>rë</sup> (117-140).

Në shekujt II - III, Armenia mbeti një teatër lufte ndërmjet dy fuqive të mëdha të asaj kohe, Romës dhe Parthës, dhe ishte bërë si një mollë sherri për ta. Rrethanat ndryshuan paksa aty nga fundi i shekullit të II, kur Vaharshi i II<sup>rë</sup> ja arriti ta kthejë brenda Armenisë së Madhe mbretërinë Arshakuniane në dinasti të trashëgueshme. Në vitin 211, pas vdekjes së Vaharshit të II<sup>rë</sup> në luftë me malësorët Kaukazanë, në fron hypi i biri i tij, Hosrovi i I<sup>rë</sup>.

Për historinë Armene një rëndësi të veçantë patën rrethanat e krijuara brenda Persisë në vitet 224-226, kur Sasanidët zëvendësuan Arshakunët. Arshakunët Parthë u strehuan në Armeni, ku mbretëronin bashkëatdhetarët e tyre Armenë, Arshakunët. Filloi një varg i ri luftërash, ku beteja kryesore zhvillohej ndërmjet Arshakunëve dhe Sasanidëve për fronin e Persisë. Në fakt, po ta shohësh problemin nga pikëvështrimi i dobisë që kishin Armenët në fushën shtetërore kombëtare nga ky konflikt, mund të thuhet se pasojat që rridhnin nga marrëveshja e Hrantit vetëm se përkeqësoheshin më tepër. Dy shtëpi mbretërore jo-Armene grindeshin për fronin më të lartë të Persisë, ndërkohë që Armenia pësonte shkatërrim dhe humbje të dhjetra mijëra njerëzve...

Roma, nga ana e saj bënte çmos që në fronin e Armenisë së Madhe të mbeteshin Arshakunët; llogaria ishte e thjeshtë: për sa kohë në fronin Armen ishin Arshakunët, Armenia do të ishte vetvetiu armiku numër një i Persisë Sasanide. Duke mos arritur të shohin këtë realitet të thjeshtë e të qartë, në ambientet Armene filluan të qarkullojnë pikëpamje naive (për të mos thënë injorante) si “miqtë Romakë” ose “armiku Pers”...

Nga ana e tyre Persët bënin gjithçka për të tërhequr Armenët nga ana e tyre. Mjafton të kujtojmë, që përgjatë viteve 252-298, mbretëria Sasanide kishte hypur në fronin Armen katër sundimtarë, përfshirë këtu edhe trashëgimtarin e kurorës Perse, Vormizd-Artashirin. Ky i

fundit fillon të bëjë shumë gjëra për Armeninë, zhvillon një betejë energjike përballë helenizimit të vendit dhe ndërmerr brenda vendit një fushatë për përhapjen e Zoroastrizmit dhe kulturës Perse. Gjatë kësaj kohe, mbretëria e Armenisë së Madhe konsiderohej si mbretëria e dytë Sasanide (si në periudhën e Arshakunëve).

Për sovranitetin mbi Armeninë e Madhe, lufta ndërmjet Romës dhe Persisë mbaroi në fund të shekullit të III, në vitin 297, kur në provincën e Basenit, pranë fshatit Osia, mbreti i Persisë, Nersehu, humbi betejën përballë Romakëve. Brenda robërve ishin në një numër të madh jo vetëm oficerët e lartë, por edhe gratë e mbretit, së bashku me gratë shoqëruese të tyre. Në vitin 298 u nënshkrua marrëveshja e paqes 40-vjeçare, në bazë të së cilës një sërë krahinash i kalonin sovranitetit të Romës dhe u kthyen robërit. Duke shfrytëzuar mbështetjen e Perandorit të Romës, Diokletianosit, Dertati i III<sup>të</sup> u njoh si mbret i Armenisë (298-330). Në periudhën e sundimit të tij, Krishterimi u njoh si fe zyrtare brenda në Armeni.



## KREU 12

## BESIMI ARMEN PARAKRISTIAN

**Besimet e Hershme**

Në kohët e hershme kanë qenë të përhapura format më të hershme të adhurimit të kulteve: adhurimi i natyrës, adhurimi i shpirtit, totemizmi, magjia etj. Ato kanë lindur që në shekujt e hershëm të epokës së Gurit.

Kulti i natyrës përfaqëson adhurimin ndaj natyrës dhe shfaqjeve të fenomeneve natyrore, shfaqjet e të cilit i gjejmë duke filluar nga epoka e Gurit e deri në ditët e sotme (besimet fetare, në punët artistike, kalendarët, emrat e përveçëm, etj).

Kulti i shpirtit ka të bëjë me adhurimin e shpirtit, natyra e të cilit është e padukshme dhe udhëheq veprimtarinë e njerëzve dhe botën që rrethon atë. Sipas pikëpamjeve Armene, shpirtrat janë dy llojesh: të mirë dhe të këqinj. Totemi është një bestytни, sipas së cilës çdo grup i caktuar njerëzish, kafshësh apo bimësh lindin nga një totem i caktuar ose është në lidhje gjaku me të. Fjala "Totem" spjegohet me fjalët "shpirti i tij" të marrë nga fisi i indigjenëve lëkurëkuq "Ototeman". Brenda Armenisë, totemizmi shfaqet me një larmi të madhe emërtimesh.

Magjia është një bestytни në bazë të së cilës qëndron besimi në forcën e mbinatyrshme të njerëzve të caktuar për të ndikuar mbi sendet, fenomenet dhe mundësitë e njeriut. Këto bestytни hasen në legjendat e hershme, në romancat e Mesjetës, në besimet e njerëzve, ku vazhdojnë të qëndrojnë si mbetje rudimentare.

## Perënditë shtetërore Armene

Organizimi i parë shtetëror Armen, Aratta, ishte një formë shteti patriarkal i mbështetur në besimin. Si mbrojtës të vendit të tyre ata konsideronin Hajkun, birin e perëndisë Haja (në burimet Shumere përmendet – Domuzi, ndërsa në ato Greke – Orioni). Gjithashtu përmenden edhe nëna dhe motra e perëndisë Hajk.

Perënditë e tokës Armene përmenden në marrëveshjet Hittito-Armene, ku në dorëshkrimet origjinale të dëmtuara mund të lexohen 13 emra perëndish. Në krye të perëndive të Hajasës (Armenisë) qëndronte Zoti i Plotfuqishëm i luftës dhe shtërngatës, në vend të dytë vjen Nëna Perëndeshë.

Në mbishkrimin që ndodhet në panteonin mbretëror të Vanit përmendet Mheri Dran, nga analiza e së cilës del qartë, që ai përbëhet nga 70 zota (35 meshkuj dhe 35 femra) dhe rreth 30 shenjtorë. Përputhja në numër e Zotave dhe Perëndeshave tregon që, në realitetin Armen të asaj kohe mbizotëronte familja monogame. Për nder të perëndive bëheshin kurbane: për perënditë meshkuj viktimat ishin demi ose dashi, për perënditë femra viktimat ishin lopa ose delja; nuk kishte përjashtim nga ky rregull. Kështu, çdo perëndie duhej t'i bëhej një kurban sipas gjinisë. Me këtë kuptohet edhe fakti, që edhe sot në ritet që kanë të bëjnë me djemtë, bëhet kurban një kafshë mashkull. Ruhet akoma tradita e vjetër: në Armeninë e krishtere, trashja e Shenjtë me në krye Zotin Baba perceptohet mashkull, kështu që edhe kurban i ri duhet të jetë një kafshë mashkull.

Panteoni i Zotave i Vanit përfaqëson paraqitjen më të shkëlqyer të trashes; Haldin (babain e zotave, krijuesin e tokës dhe qiellit), Tejshebanin (zotin e luftës, trimërisë dhe shtërngatës) dhe Shivinin (zotin e Diellit, qendra kryesore e adhurimit të të cilit ishte Tushpa, kryeqyteti i Vanit). Adhuroheshin gjithashtu edhe zotat e fushave, maleve, detrave, etj. Pas panteonit të mbretërisë së Vanit u shfaqën edhe forma të tjera panteonesh dhe, në prag të pranimit të Krishterimit, panteoni Armen shfaqet me një formë të re.

Në krye të panteonit përsëri është treshja superiore: Aramazdi, Anahiti dhe Vahagu. Babai i zotave, Aramazdi, adhurohej si krijuesi i tokës dhe qiellit, i mirësisë, bollëkut, trimërisë. Qendra kryesore e adhurimit të tij ishte Kështjella Ani në provincën e Daranahut. Nënës Perëndeshë, Anahitit, së cilës i kishin mveshur titullin “Nëna e Artë”, i atribuoheshin ndriçimi i tokës dhe ushqimi, të gjithë veprat mirëbërëse si edhe vigjiluese dhe mbrojtëse e kryeqytetit. Qendra kryesore e adhurimit të saj ndodhej në vendbanimin Jeriza (Jerzinka) në provincën Akilisene (Ekeghiats) dhe në kryeqytetin Artashat. Vahagu (brenda vendit të shenjtë Nemrut: Artak) adhurohej si zoti i luftës, trimërisë dhe shtërngatës; sipas një të dhëne, ai para së gjithash nderohej si “Zoti i Diellit”. Tempulli kryesor i Vahagut është gjetur brenda Ashtishatit dhe quhet Vahe-Vanian (Vaheja i Vanit).

Ndër perënditë më kryesore dhe më të dashura ishte Astiku (սասնիկ – astik, në gjuhën Armene quhet Venusi), perëndesha e dritës qiellore, dashurisë dhe bukurisë, së cilës i kushtohet edhe festa e Vardavarit (sipas shkrimeve të hershme Kristiane, kjo festë lidhet me përmytjen e madhe, kurse Astiku paraqitet si vajza e Noes). Ajo konsiderohet si gruaja e Vahagut, ose e dashura e tij, dhe tempulli i saj i gjendur brenda në Ashtishat quhet “Dhoma e Vahagut”. Nane - paraqitet si perëndesha mbrojtëse e mëmësisë dhe e familjes, e cila fillimisht kishte qenë edhe perëndeshë e luftës. Qendra kryesore e adhurimit të Nane-së është gjendur në vendbanimin Til të provincës Daranah. Areg-Mihra ishte zoti i diellit, dritës dhe drejtësisë. Sipas besimit Armen, në zemër të diellit jetonin 365 shenjtorë, secili prej të cilëve ruante drejtësinë mbi tokë një ditë në vit. Sipas legjendave, Dielli, gjithmonë i ri (djalosh), çdo mbrëmje zhytej brenda ujrave të liqenit Van dhe çdo mëngjes herët dilte prej ujrave të tij, në thellësinë e ujrave të kaltër të të cilit gjendej edhe dhoma ku flinin rrezet e arta të tij. Qendra kryesore e adhurimit të diellit ishte vendbanimi Bagariç në Armeninë e Lartë dhe kryeqyteti i krahinës së Vanit, Tushpa. Tiri ishte perëndia e të mësuarit (arsimimit), të cilit i ishte ngarkuar detyra e sekretarit të Aramazdit, zot i plotfuqishëm i shkrim-këndimit, i mjeshtërisë (zejeve) dhe i dijes,

qendra kryesore e adhurimit të të cilit gjendej në rrugën që lidhte Vagharshapatin me Artashatin, në vendbanimin e quajtur Jerazam. Zoti i botës së përtejme, në kohët e vjetra, konsiderohej Tork Angeh (Tork Angel), i cili i korrespondon perëndisë Tark. Brenda panteonit të ri, atë e ka zëvendësuar Sandarameti (Sbandarameti).

Brenda Armenisë është bërë shumë i dashur edhe perëndia e mikpritjes; nuk është e rastit, që edhe sot, ligjet e shenjta të mikpritjes janë aktuale në jetën e përditshme. Në festimet e Vitit të Ri ndihet i pranishëm dhe i rëndësishëm kulti (adhurimi) i Vitit të Ri.

Në periudhën e helenizimit, perëndive Armene ju vendosën korrespondenca me perënditë Greke (Aramazd - Zeusi, Anahit - Artemisi, Vahag - Heraklesi, Astik - Afrodita, Arek - Heliosi, Tir - Apolloni, etj). Ndërkaq, populli Armen nuk i pranoi emrat e perëndive të huaja dhe kultin e tyre. Brenda Armenisë nuk arriti të marrë përhapje të madhe edhe Zoroastrianizmi, i cili ishte një besim, që kishte si kult Natyrën (adhurimi ndaj natyrës dhe çdo gjëje që ndodhej mbi të dhe që ishte një besim dualist) me perëndi të mira dhe të këqija të ndara në mënyrë të barabartë (ekuivalente) (i miri Aramazd-Vormizd, i keqi Ahriman-Haraman).

Për besimin Armen paraKristian një informator i rëndësishëm është kalendari Armen. Në kalendar kujtohen emrat e perëndive dhe vendet e kultit.

### **Karakteristikat kryesore të besimeve të vjetra Armene**

Duke i bërë një përmbledhje sa më sipër është paraqitur, shihet që, karakteristikat kryesore të besimeve të vjetra Armene ndjekin këto linja: Besim monoteist (dhe besim dualist në rastin e Zoroastrianizmit).

Panteoni përbëhej prej perëndive vendase (i ngjashëm me tempullin Grek të Olimpias). Në krye të panteonit qëndronte treshja më e lartë, që ishte fenomen i botës Indoeuropiane dhe që brenda realitetit Armen ndihmoi në përshtatjen me Kristianizmin; tre individët më

të lartë të botës paraKristiane u zëvendësuan me treshen e Shenjtë të Kristianizmit. Pranimi i shpirtave të mirë dhe të këqinj; Armenët nuk kanë perëndi të së keqes ose që bëjnë keq; forcat e këqia nuk u ngritën në nivelin e shpirtave. Janë të lartësuara drita, familja, dijet dhe çdo gjë e mirë. Janë bërë të dukshme një rradhë bazash ideore, prej të cilave me rëndësi të veçantë janë kulti i Atdheut të Shenjtë, ideja e të qënies të popullit Armen si një popull i zgjedhur dhe me një mision kombëtar, ideja e lidhjeve Zoti-Shteti, Zoti-Populli-individi.....



## KREU 13

# KULTURA ARMENE PARAKRISTIANE

### **Kultura e Shkrimit para krijimit të Alfabetit Mashtotcian**

Brenda Armenisë, shumë vjet përpara ekzistencës së shkrimit të vet të veçantë në formën që është sot, ka shumë të dhëna dokumentare në formë të shkruar. Këtë e dëshmon Filostrati kur flet për qaforen prej ari me germa Armene dhuruar mbretit Arshak (vitet 34-35), Hipolitosi në “Kronologjia”, (shkruar në vitin 235) në shënimin e shkurtër për Armenët ku vë në dukje se në rradhët e popullit ka njerëz të shkolluar, njoftimet e Agatangelosit në lidhje me simbolet Armene dhe nderimin e kultit të Zotit të dijes në Armeninë paraKristiane, njoftimi i Moisi Horenacit për ekzistencën e një dhome sekretarie historike tempullore (dhomë kronikanësh) brenda fortesës në Ani të Daranahut (Daranaghut) në shekujt II - III.

Nga Armenia paraKristiane janë zbuluar monumente të kulturës shkrimore, të cilat sipas kohës së krijimit dhe përmbajtjes që transmetojnë, mund të ndahen në katër grupe:

Sisteme shkrimi të krijuara brenda Armenisë dhe të përdorura nëpër tempujt nga paraardhësit e lashtë. Këtij grupi, pjesërisht të dëshifruar i përket vetëm shkrimi tempullor i mbretërisë së Vanit, i cili është i përbërë nga rreth 300 simbole (shenja), të shkruara nga e djathta në të majtë dhe nga lart-poshtë. Gjuha e përdorur në këtë lloj shkrimi konsiderohet Armenishtja më e vjetër.

Grupin e dytë e përbëjnë sisteme shkrimi që nuk kanë Armeninë si

vendlindje, por që janë përdorur në sistemet shkrimore të paraardhësve të lashtë Armenë. Në të futen sistemet shkrimore si: Hieroglifet Hittito-Luviakane, shkrimet kuneiforme (në formë pyke) Asuro-Babilonase dhe ato vendase (të quajtura Biajniliiane ose Urartiane), alfabetet Greke, Aramaike, Asore dhe Pahlavi ose të Persishtes së mesme.

Grupin e tretë e përbëjnë sende të ndryshme të shkruara, të gjetura në vendbanime të lashta Armene, autorët e të cilave nuk janë Armenë.

Grupin e katërt e përbëjnë monumentet me mbishkrime me simbole misterioze, të cilat nuk njihen jashtë Armenisë.

Kultura shkrimore, e krijuar brenda në Armeni përgjatë mijëvjeçarëve, nuk ka humbur pa lënë gjurmë, dhe realizimi i kulturës shkrimore Mashtotciane ka qenë i kushtëzuar edhe nga marrja në konsideratë e kulturës shkrimore të epokave paraardhëse. Sipas gjuhëtarëve, kur gjuha nuk është e përpunuar edhe në mënyrë shkrimore (për ato gjuhë që nuk kanë arritur të kenë shkrimin e tyre, kulturën e tyre shkrimore - shënim i imi) bagazhi (depozita) i fjalëve është i kufizuar (në rastin më të mirë nuk kalon 7 000 – 8 000 fjalë), ndërkohë që në gjuhën e kultivuar shkrimore bagazhi (depozita) i fjalëve, ai që jo detyrimisht është i njohur nga të gjithë, shkon në mbi 60 000 fjalë.

## Historia

Nga të dhëna të burimeve të ndryshme mësohet, që në organizimet e para shtetërore Armene (Aratta, Mittani, Hajasa) ka pasur shkrime mbretërore, si rrjedhojë, duhet të ketë pasur edhe sekretari mbretërore (grup shkrueshish). Ata, madje edhe sot, mbeten anonimë. Mbishkrimet e para monumentale me vlerë historike, të arritura deri në ditët e sotme tek ne, janë ato kuneiforme të mbretërisë së Vanit.

Moisi Horenaci dëshmon për ekzistencën e një dhome sekretarie historike tempullore (dhomë kronikanësh) në shekujt II - III, në qendrën më të madhe të kultit ku adhurohej Aramazdi, brenda fortesës në Ani të Daranahut. Histori kulti janë paraqitur në Mar Abas Katina, prifti pagan i Olimp, si edhe në shkrime te tjera. Kurse, vetë Babai

i historisë (Horenaci) e kujton në shkrimet e tij djalin e Artashesit, Vrujrin, si “burrë i ditur dhe poet”.

Për Tigranin e Madh kanë bërë shkrime Metrodoros Skepsaci dhe Amfikatres Athinasi, të cilat për fat të keq nuk kanë arritur deri tek ne. Artavazdi i II<sup>të</sup>, kujtohet si autor i shkrimeve të llojit të tragjediave, ligjëratave dhe historike, të cilat kanë qenë të njohura madje edhe brenda në Romë. Është e ditur që në Artashat ka qenë i ftuar shkrimtari i shekullit të II Jamfikos Babilonasi, i cili shkroi atje veprën me 35 pjesë “Babilonia”. Moisi Horenaci na njofton për rimën e mrekullueshme të veprës së përbërë prej katër pjesësh «Հիւսուխն Պիսոսից», e cila ju dhurua Hajkazunerëve, në veçanti Tigranit të I<sup>të</sup> Jervantuni. Informacione të rëndësishme historike jepen edhe nga mbishkrimet monumentale me germa Greke apo Arameike, të lëna nga mbretërit Armenë, të cilat fillojnë nga shekulli i III para Krishtit deri në vitin 301. Burime fillestare me rëndësi historike përbëjnë, gjithashtu, edhe paratë e prera nga mbretërit Armenë, të cilat kanë mbërritur deri në ditët e sotme në mijëra lloje.

## Arkitektura

Me ecjen përpara të shoqërisë njerëzore, lindi nevoja e domosdoshme e strehimit nga banesat fillestare primitive në banesa që i përshtateshin më mirë nevojave të jetës së njeriut. Kjo shënoi fillimin e lindjes së një shkence të re, arkitekturës. Kalimi në fazën e krijimit të strehave për veten e tij dhe ekonominë prodhuese të tij (në ndryshim nga kafshët, të cilat vetëm asgjësojnë) shfaqet për herë të parë në mijëvjeçarin e X<sup>të</sup> para Krishtit në jug të Malësive Armene, në hapësirat e botës Kordvac (brenda vendbanimit Shanidar). Në mijëvjeçarin e X<sup>të</sup> para Krishtit, në jug-perëndim të Malësive Armene (vendbanimet në Koepekli dhe Nevali Çori, në hapësirat veriore të Mesopotamisë Armene), kanë qenë ndërtuar tempujt më të vjetër të zbuluar deri në ditët e sotme.

Në mijëvjeçarët III - II para Krishtit, me zhvillimin e organizimeve qeverisëse shtetërore, brenda gjithë territorit të Malësive Armene filluan

të ndërtoheshin kështjella (fortesa) të madhësive gjigante (Cikloplane). Përhapje të madhe gjejnë ndërtimet me forma rrethore të kombinuara me mure drejtkëndore, në qendër të të cilave vendosej vatra (oxhaku), ndërsa tavani përfundonte me kulm. Mauzoletë rrethoheshin me mure guri të rrumbullkuar, kurse mbi pllakat që mbulonin hirin e të vdekurve vendosej një çfarëdo obelisk në shenjë pavdeksie ose rilindjeje.

Nga epoka e mbretërisë së Vanit kanë arritur deri në ditët e sotme në numër të madh qytete, fortesa, pallate, tempuj, mauzole dhe ndërtime të tjera. Me interes të veçantë është stili i ndërtimit të tempullit kryesor të gjetur brenda Ardini-Musasirit (me çati me dy pjerrësi, me balle trekëndore, me kollona të zbukuruara), i cili më vonë nëpërmjet Azisë së Vogël kaloi në botën Greko-Romake, dhe më pas u përhap në të gjithë botën (sipas këtij stili është ndërtuar edhe tempulli Garni).

Në shekullin e III para Krishtit, në Armeni fillon epoka Helenike, e cila zgjat deri në periudhën kur Kristianizmi bëhet fe shtetërore në Armeni. Në këtë periudhë u ndërtuan një numër i madh qytetesh (Samosat, Arshamashat, dy Arsame, Jervantashat, Jervantakert, Bagaran, Artashat, Tigranakert, Vaharshapat dhe të tjerë), fortesa, pallate, tempuj, mauzole, ndërtesa publike dhe ndërtime të tjera. Nga ndërtimet e kultit të ruajtura të bie në sy veçanërisht vendi i shenjtë në malin Nemrud të Kommagenit, tempulli Garni, ndërtimet e Artashatit të Vjetër, etj.

## Astronomia

Për botën yjore, njohuritë më të hershme brenda hapësirave Armene, dokumentohen që në shekujt e fundit të epokës së Gurit në figurat e gdhendura mbi shkëmb. Brenda këtyre figurave të gdhendura në shkëmb, si edhe në ato mbi copa bronzi apo enë prej qeramike që i përkasin mijëvjeçarëve III - II para Krishtit, hasen shenja yjore, të cilat tregojnë, që në kohët e lashta, brenda hapësirave Armene, ishin praktikuar kalendarët hënorë, dielloro-hënorë ose diellore.

Historianët dhe astronomët Europianë, që në fund të shekullit të XIX dhe në fillim të shekullit të XX deklarorin, që emërtimi i konstelacioneve

Është krijuar brenda hapësirës së Malësive Armene rreth vitit 2800 para Krishtit. Këtë e përforcon observatori i Mexamorit (Metsamor), ku qielli yjor (yllësia) rezulton të jetë vrojtuar që gjatë viteve 2800-2600 para Krishtit.

Mbi obelisqet me data mbi to, të mijëvjeçarëve X-VII para Krishtit, të gjetura në Koepekli - Tepei (Portablur), janë të dukshme figurat e kafshëve të shenjta (demi, derri i egër, ariu, huta, gjarpëri, dhelpra, akrepi, etj), të cilët, sipas disa studjuesve, mund të jenë figura konstelacionesh yjore. Nëqoftëse kjo arrin të vërtetohet, njohuritë tona mbi historinë e lindjes së shkencës së astronomisë do të ndryshojnë plotësisht.

Një zhvillim të madh duket të kenë pasur dijenitë kalendarike brenda mbretërisë së Vanit.

Kalendari Armen diellor përbëhet nga 365 ditë, 12 muaj me nga 30 ditë dhe një 5-ditor festiv (Shtesë). Të gjithë muajt, ditët si edhe të 24 orët e ditës, mbajnë emra të veçantë. Sipas llogaritjeve të dijetarit të shquar Armen, Baba Kevond Alishan, fillimi i Kalendarit Armen original daton në vitin 2492 para Krishtit, më 11 Gusht (dita e parë e vitit 1 është Navasarti 1). Sipas legjendës, kjo është ajo ditë, kur prijësi Hajk mundi tiranin Bel.

## Folklori

Populli Armen, në periudhën paraKristiane ka krijuar legjenda dhe të ngjashme me to, të cilat i kushtoheshin perëndive të tyre, prijësve të lashtë të tyre, mbretërve të dashur prej tyre, si edhe heronjve të tyre. Një pjesë e madhe e tyre, në formë të shkruar dhe të arritura deri në ditët e sotme, gjenden në faqet e “Historia e Armenisë” të Moisi Horenacit. Nga folklori popullor, ndër pjesët më të bukura që kanë arritur deri në ditët tona, janë: himni i lindjes së Zotit Vahag, “Hajku dhe Beli”, “Aramid dhe Barshami”, “Arami dhe Nikar Madesi”, “Arami dhe Pajapis Kadea”, “Bukuroshja Ara dhe Shamiram”, “Tigrani dhe Ashdahaku”, “Jervanti dhe Artashesi”, “Artashesi dhe Sateniku”, “Artashesi dhe Artavazdi”, si edhe shumë të tjera si këto.

## Teatri

Është vështirë të thuhet se kur ka lindur teatri brenda territoreve Armene. Është e qartë që teatri popullor në gjuhën Armene e ka fillimin që në kohë të lashta. Moisi Horenaci dëshmon që veprat (սուրերը) më të vjetra Armene (Këngët e Gohtes - Կոնթաւն երգերը) paraqiteshin në publik (shfaqeshin) nëpërmjet lojës pa zë dhe me valle, të shoqëruara me tingujt e lirës (harpës) (vegla më e vjetër muzikore me tela).

Në periudhën Helenike në Armeni u ndërtuan teatro, në të cilat luheshin shfaqje për aristokracinë e lartë. Është i njohur fakti, që të tilla teatro kanë funksionuar edhe në Artashat dhe Tigranakert. Brenda tyre luheshin pjesë të autorëve Grekë, si edhe të autorëve Armenë. Sipas dëshmisë së Plutarkut (shekulli I - II), tragjeditë e shkruara prej Artavazdit të II<sup>te</sup>, edhe një shekull e gjysëm pas vdekjes së tij, ishin të njohura nga lexuesit e apasionuar Romakë të letërsisë.

Për jetën teatrale të periudhës së vonë Helenike, një dëshmi e veçantë është ajo e çajnikut prej argjendi me mbishkrime në gjuhën Greke e mbretit Bakur (në vitet 160), i cili është i pasur me figura teatrale.

PJESA E TRETË

# PERIUDHA E MESJETËS



## KREU 14

# SHFAQJA E KRISHTERIMIT NË ARMENI

Ngjarja, ndoshta më e madhja, që solli një kthesë rrënjësore në historinë Armene, ishte shpallja e Kristianizmit si fe zyrtare shtetërore, me të cilën fillon ndarja e historisë së Armenisë në dy periudha: ajo e para Kristianizmit dhe ajo Kristiane.

Brenda Armenisë, shenjat fillestare të idesë së monoteizmit i gjejmë në mbishkrimet monumentale që në shekullin X. Jeznik Kohbaci shkruan për pranimin e idesë së një zoti të vetëm nga ana e paganëve. “Neve – thonë ata – përderisa jemi të pafuqishëm t’i afrohemi të gjitha shkaqeve (arsyeve) të Ekzistencës, Qënies, Përjetësisë dhe të Pamundurës, atëherë për këtë arsye, Atij ja tregojmë adhurimin nëpërmjet mjeteve të tjera shumë më të thjeshta; prandaj është e domosdoshme, që me anë të therrorëve dhe dhuratave të fitojmë dashurinë e tyre, nëpërmjet të cilëve respektojmë Atë”.

Kulti i Arariçit, Zotit të vetëm dhe më të lartë, shfaqet edhe tek legjenda e lindur brenda Armenisë, “Hajku dhe Beli”, e cila ka arritur deri në ditët e sotme me forma të ndryshme në variantet Armene dhe Gjeorgjiane. Atje, në mënyrë të qartë, gjykohet kulti i “Adhurimit të Zjarrit”, kurse Hajku i lashtë Armeni i porositi të tijtë “askujt tjetër mos i shërbeni, përveç Zotit Arariç”....

Kështu, ideja e një Zoti të vetëm ka qenë e pranishme në Armeni shumë kohë përpara Kristianizmit, madje ajo u ngrit në fe zyrtare shtetërore vetëm në kohën e mbretërimit të Tigranit të III<sup>te</sup>.

## Hyrja e Krishterimit në Armeni në shekujt I - III

Raportet e para të Kristianizmit me realitetin Armen i përkasin periudhës së jetës tokësore të Jezus Krishtit. Sipas gojëdhënave Armene, mbreti Armen, Abgar, që sundonte në Jedis, vuante nga një sëmundje e pashërueshme, dhe i vënë në dijeni për mrekullitë që ishte në gjendje të bënte Krishti, e fton atë pranë tij. Krishti e refuzon me mirësjellje, duke e njoftuar, që mrekullitë e tij mund të kishin efekt vetëm brenda Palestinës. Ai i jep fjalën Abgarit, që do t'i dërgojë njërin prej nxënësve të tij.

Sipas po kësaj gojëdhëne, Anani, sekretari i mbretit Abgar, solli në Jedis pikturën me portretin e Krishtit, i cili pasi mbeti atje për disa kohë në ruajtje për disa shekuj, më vonë u transferua në Kostantinopojë, nga ku në shekullin e XIII u transferua në Gjenovë, ku vazhdon të ruhet akoma edhe sot në kishën e Shën Bartolomeut.

Sipas gojëdhënës Armene, Abgari ishte djali i Arsham Manu-së, vëllait të Tigranit të Madh, i cili pas ndërtimit të Jedisit (Edessa), e transferoi atje mbretërinë e tij. Sipas fjalës së dhënë, në vitin 43, Jezus Krishti dërgoi në Armeni apostullin (dishepull, nxënës) e tij, Tadeusin, i cili predikoi atje deri në vitin 66, ndërsa në vitet 60-68 në Armeni erdhi dhe predikoi edhe apostulli Bartolome. Kjo është arsyeja që Kisha Armene zyrtarisht mban emrin “Kisha e Shenjtë Apostolike Armene”.

Sipas dorëshkrimeve Armene, të dy apostujt u vranë me urdhër të mbretit Sanatruk. Vitet e veprimtarisë së Apostujve janë paraqitur sipas kronologjisë zyrtare të Kishës Armene, gjë që nuk përputhet me të dhënat e reja historike. Sipas Kishës, apostujt janë vranë në periudhën e viteve 66-68, ndërsa sipas të dhënave të reja historike del që në atë kohë brenda në Armeni sundonte Tigrani i I<sup>e</sup>, ndërsa Sanatruku nuk mund të hypte në fron para vitit 77.

Apostulli Tadeus themeloi Fronin Episkopal brenda krahinës Artaz të Vaspurakanit, i cili pati jetë deri në vitet 180. Pas kësaj, për komunitetet Kristiane dëgjohet të flitet në hapësirat e Armenisë së Vogël. Në vitet 240-270 përmendet Episkopi Meruzhan në Armeninë e Madhe.

## Shpallja e Krishterimit si fe zyrtare dhe organizimi i pavarur i Kishës Armene

Përgjatë shekujve I - III, Krishterimi ishte një fe e ndaluar, që persekutohej në tokat e Azisë Perëndimore dhe brenda territorit të Perandorisë Romake. Të krishterët përndiqeshin edhe në Armeni. Në fund të shekullit të III kemi të bëjmë me torturimin e virgjërshave të Hripsimesë si edhe me burgosjen në Khor Virap për afro 13 vjet të Grigor Partevit.

Grigor Partevi u shndërrua në predikuesin kryesor të Krishterimit brenda Armenisë, dhe arriti të bindë mbretin Tigran i III<sup>të</sup> të pranojë Krishterimin si fe zyrtare.

Sipas gojëdhënës, kjo ka ndodhur në vitin 301 (brenda historiografisë ka edhe zëra ndryshe lidhur me këtë datë).

Përhapja e Krishterimit në Armeni u shoqërua me asgjësimin e fesë së mëparshme dhe qendrave të tyre të kultit. Filloi një luftë e brendshme civile ndërmjet Krishterimit të mbështetur nga ushtritë shtetërore, dhe paganizmit, me mbështetësit e tij nga ana tjetër. Në këto grindje mbeti i vrarë edhe kryepriifti i fundit pagan, Arcani.

Vetëm shpallja e Krishterimit si fe zyrtare shtetërore nuk ishte kusht i mjaftueshëm për organizimin e Kishës Armene si një strukturë vetëqeverisëse. Për këtë ishin të domosdoshme disa parakushte, të cilat ishin siguruar përgjatë tre shekujve paraardhës.

Për t'u kuptuar më lehtë nga njerëzit, Kisha adaptoi një sërë formash dhe zakonesh paraKristiane (për shembull: festën e rinisë, festën e Vardavarit, etj). Vendet e shenjta të fesë së re u përshtatën me format ekzistuese të fesë së vjetër (p.sh. vendet e shenjta të Nënës së Shenjtë Anahit si edhe festat për nder të saj u kthyen në ato të Virgjërshës së Bekuar, (Virgjërsha Mari ose Nëna e Krishtit), vendet e shenjta dhe festat e Vahagut u kthyen në ato të Jezu Krishtit, etj). Në interpretim të këtyre fakteve mund të bëjmë një supozim: libri i shenjtë i Krishterimit "Bibla" u përkthye në të gjitha gjuhët e botës si "Libri" ose "Libri i Shenjtë"; vetëm brenda në Armeni ai u shkruajt "Udhëzues i Shpirtit

të Shenjtë”, gjë, e cila lë shteg të hamendësohet, që po kështu ka pasë qenë quajtur edhe libri kryesor i shenjtë i periudhës paraKristiane.

Pas shpalljes së Krishterimit si fe zyrtare shtetërore, Katolikosët (Peshkopët) Armene, duke filluar me Grigor Iluminatorin dhe deri tek Nersesi i Madh, përfshirë edhe këtë të fundit, kurorëzoheshin në Cesarea (Kesarea). Kjo nga këndvështrimi i sigurisë shtetërore ishte e rrezikshme. Këtij rregulli i dha fund Mbreti Pap në vitin 373, kur pas vdekjes së Nersesit të Madh e organizoi që zgjedhja dhe kurorëzimi i Katolikosit të ri të bëhej brenda Armenisë. Që prej atij viti, zgjedhja dhe kurorëzimi i Katolikosit ishin çështje e brendshme Armene.

Në organizimin e punëve të brendshme të Kishës Armene, një rol të madh kishte mësimi i Krishterimit nëpërmjet gjuhës Armene, krijuesit e së cilës u bënë Mesrop Mashtotci dhe Sahak Partevi në vitin 405. Çështja e orientimit të besimit ishte me shumë rëndësi. Në vitin 451, për herë të parë, Kisha e Krishterë u nda në Mbledhjen (Konsilin) e Kahkedonisë (Chalcedonia), shkak për të cilën u bë diskutimi mbi çështjen nëse Krishti kishte natyrë vetëm hyjnore apo hyjnore dhe njerëzore njëkohësisht (kisha u nda në dy grupe: në ata që besonin vetëm në natyrën hyjnore të Krishtit dhe në ata që pranonin se në figurën e Krishtit bashkoheshin natyra hyjnore dhe njerëzore në një të vetme). Armenët nuk morën pjesë në këtë mbledhje, ndërsa pikëpamjen e tyre e shprehën në mbledhjet e zhvilluara në vitet 506 dhe 554 në Dvin. Në këtë të fundit u miratua dokumenti i quajtur “zotim i botës së bashkuar Armene”, brenda së cilës, në mënyrë të qartë theksohet besnikëria ndaj tezave origjinale fillestare të njënatyrshmërisë së Krishtit.

Në mënyrë të përmbledhur mund të thuhet që: Krishterimi hyri në Armeni në shekujt I - III, në fillim të shekullit të IV u shpall fe zyrtare shtetërore, ndërsa Kisha Armene, si Kishë me organizim të pavarur kombëtar, mori trajtën e saj përfundimtare përgjatë shekujve IV - VI.

## KREU 15

# MBRETËRIA ARSHAKUNIANE E SHEKUJVE IV - V

Në fund të shekullit III, përfundoi lufta ndërmjet Romës dhe Persisë, e cila u kurorëzua me nënshkrimin në vitin 298 në Mtsbin (Մծքիմի) të marrëveshjes së paqes 40 vjeçare, në sajë të së cilës, gjatë periudhës së sundimit të mbretit Dertat i III<sup>të</sup> (298-330) në Armeni mbretëroi paqja. Kjo ishte edhe periudha gjatë së cilës Krishterimi u shpall fe zyrtare shtetërore në Armeni.

Dertatin e pasoi i biri, Hosrovi i II<sup>të</sup> Kotak (330-338), gjatë periudhës fillestare të mbretërimit të të cilit, duke shfrytëzuar paqen, u bënë ndërtime të shumta. U ndërtua Dvini, u pyllëzua “Hosrovagerti” dhe “Tempulli i Nënës”, nga të cilët, i pari, ai që mban emrin e mbretit, sot është shndërruar në rezervat. Gjatë periudhës së tij, me shtytjen e mbretit të Persisë, Shapuh i II<sup>të</sup> Jerkarakjaci (309-379), mbreti Sanesan i Maskutit (Maskut - provincë në Albania të Kaukazit – shënim i imi) ndërmori një fushatë ndaj Armenisë, e cila përfundoi me humbjen dhe vdekjen e tij.

Në vitin 337 vdes perandori i Romës, Kostantini i Madh. Duke përfituar nga kjo situatë, Shapuh i II<sup>të</sup> fillon luftën kundër Romës, në të cilën u përfshi edhe Armenia. Në vitin 338, Roma ndërmori masa serioze në Lindje, dhe në fronin e Armenisë hypi Dirani (338-350), djali i mbretit të vdekur, Hosrovit të II<sup>të</sup> Kotak.

Gjatë sundimit të tij acarohen marrëdhëniet ndërmjet mbretërisë dhe kishës; me urdhër të mbretit u dënua me vdekje Katolikosi Husik (nipi i Grigor Iluminatorit) dhe në vend të tij u vendos kandidati i propozuar prej Asorëve, episkopi Daniel.

Dirani u përpoq të miqësohej me mbretin Shapuh i II<sup>te</sup>, por pa sukses.

Krijimi i një situatë të paqëndrueshme brenda Romës në vitin 350, u shfrytëzua nga Shapuhu i II<sup>te</sup> që të rifillonte një fushatë kundër Armenisë, e cila tashmë kishte mbetur vetëm. Mbreti Diran u arrestua, u dërgua në Tizbon dhe atje u verbua. Shapuhu emëroi mbret të Armenisë së Madhe djalin e tij, Nersehun. Ndërkaq, në Armeninë e Madhe, mbarë bota Armene ju kundërvu këtij veprimi, dhe me qëllim mbrojtjen e atdheut të tyre, i kërkuan ndihmë Romës. Po atë vit, duke qenë vetë në krye të forcave Romake, në Lindje erdhi perandori Kostantin, i cili, në betejën e Basenit i shkaktoi një humbje të rëndë Shapuhut të II<sup>te</sup> duke i zënë rob edhe të gjithë haremin. Në vitin 350 u nënshkrua marrëveshja e paqes. Dirani u la i lirë, por duke qenë i verbër, nuk ishte në gjendje të qeveriste, dhe për pasojë në vendin e tij u emërua mbret i biri, Arshaku i II<sup>te</sup> (350-368).

Në vitet e para të mbretërimit të Arshakut të II<sup>te</sup> u vendosën marrëdhënie shumë të mira me Romën, të cilat u forcuan akoma më shumë me martesën e Arshakut me të venë e vëllait të vdekur të perandorit të Romës, Olimbinë. Kryekomandant u emërua Vasak Mamikoniani, kurse Katolikos u pranua kryekëshilltari i mbretit, Nerses Partevi (Nersesi i Madh) nga fisi i Grigor Iluminatorit.

Me iniciativën e Nersesit të Madh, në vitin 354, u thirr mbledhja e Ashtishatit, e cila është ndër të parat në historinë e Kishës Armene. Mbledhja vendosi të ripërtërijë disa zakone të periudhës paraKristiane, të ndërtojë spitale, shkolla, jetimore, etj.

Me qëllim forcimin e qeverisjes qendrore u vendos të ndërtohet qyteti Arshakavan. Mbreti u bëri thirrje të gjithëve, madje edhe vasalëve dezertorë dhe banorëve të larguar, që të vinin dhe të banonin brenda Arshakavanit, duke u falur kështu nga fajet dhe detyrimet e mëparshme.



Eçmiaxin (Etchmiadzine)

Kjo solli shumë pakënaqësi në rradhët e ministrave (princave) Armenë, të cilët pas njëfarë kohe u turrën mbi Arshakavan dhe e rrënuan atë.

Legjimiteti i Arshakut u lëkund akoma më tepër kur ai urdhëroi asgjësimin e dy djemve të vëllait të tij, Gnelit dhe Tiritit, dhe më pas u martua me të venë e Gnelit, Parranceminë.

Në vitin 359, Shapuhu i II<sup>të</sup> filloi një luftë të re kundër Romës dhe Armenisë. Lufta vazhdoi deri në vitin 363, kur u vra perandori Julian, dhe perandori Hovianos nënshkroi me Persët “Marrëveshjen e Turpit”, me anë të të cilës ai u lëshonte Persianëve hapësirat e pushtuara si dhe hiqte dorë nga aleanca e ndihmës me Armenët.

Në vitin 364, Shapuhu i II<sup>të</sup>, duke pasur nga ana e tij princat e fuqishëm të Arshakut të II<sup>të</sup> (në krye të të cilëve qëndronin Meruzhan Arxruni dhe Vahan Mamikoniani), hyri në Armeni. Beteja ndërmjet Armenëve dhe Persëve vazhdoi 4 vjet, në fund të së cilës, Arshaku i II<sup>të</sup> u detyrua të shkojë në Tizbon për të negociuar me Shapuhun e II<sup>të</sup>. Ky i fundit, me tradhëti e burgosi Arshakun e II<sup>të</sup> në kështjellën e Anhushit, ku edhe u

vetëvra.

Shapuhu i II<sup>te</sup> ndërmori një fushatë të re. Drejtimin e vendit e mori përsipër mbretëresha Parrancemi. Ajo me 11,000 trupa u fortifikua brenda fortesës Artagers dhe rezistoi për 13 muaj. Mbretëresha ju drejtua perandorit të Romës për ndihmë dhe me lutjen për të njohur si mbret, Papin, birin e mbretit.

Në vitin 369, Shapuhu i II<sup>te</sup> ndërmori një fushatë të re kundër Armenisë, pushtoi fortesën Artagers, ndëshkoi me vdekje mbretëreshën Parrancemi dhe pastaj zhvendosi me forcë banorët nga qytetet Armene dhe i mori robër.

Në vitin 369, Armenia e mbetur pa ushtri, dërgoi Papin pranë Musheh Mamikonianit (djali i kryekomandantit Vasak Mamikonian) me qëllim që të mblidhte ushtri. Perandori i Romës, Vahesi, në vitin 370 erdhi vetë në Lindje, shpalli Papin si mbret dhe filloi përgatitjet luftarake. Në vitin 371 u zhvillua beteja vendimtare në Cirav (Xirav), ku forcat e bashkuara Romako-Armene i shkaktuan një disfatë të rëndë Persëve. U nënshkrua armëpushimi dhe Papi u njoh si mbret i Armenisë.

Detyra e parë e mbretit Pap (370-374) ishte ribashkimi i hapësirave të përçara Armene, pas së cilës filloi realizimi i një sërë rindërtimesh. Ai hoqi taksën mbi të ardhurat prej 10% (e cila i shkante kishës), shkuroi zotërimet dhe kufizoi pavarësinë e Kishës, posaçërisht me qëllim për t'i shërbyer nevojave të ushtrisë. Në sajë të këtyre masave, në një kohë fare të shkurtër, ushtria Armene arriti të kishte rreth 90,000 trupa. Ai urdhëroi gjithashtu, që manastiret e grave të mbylleshin në një masë të madhe. Të gjitha këto bënë që marrëdhëniet ndërmjet qeverisë dhe kishës të acaroheshin. Priftërinjtë filluan ta sulmonin mbretin e ri me metoda dinake dhe ishin vetë ata që ja parashkruan vdekjen Nersesit të Madh, pasojë e së cilës ishte helmimi i tij.

Papi bëri një reformë shumë të rëndësishme që kishte lidhje me kishën. Pas vdekjes së Nersesit të Madh, zgjedhja dhe kurorëzimi i Katolikosit u bënë brenda Armenisë (deri në atë kohë ky veprim

kryhej në Cezaria), veprim ky që e bëri Kishën Armene, de facto, të pavarur.

Papi bëri përpjekje për ta bërë të pavarur edhe politikën e jashtme, duke filluar bisedime të fshehta me Shapuhun e II<sup>të</sup>, që u kthye në shkak për vdekjen e tij. Me porosi të perandorit të Romës u bënë dy tentativa për ta vrarë Papin; e para brenda Taronit dhe pa sukses; e dyta, brenda garnizonit Romak, që ndodhej në Armeni. Kjo e dyta ja arriti qëllimit, duke i dhënë kështu fund jetës së këtij mbreti të ri e të talentuar.

Në vitin 374, në Armeni, në fronin mbretëror u vendos Varazdat Arshakuni, i cili e dënoi me vdekje Musheh Mamikonianin, duke e fajësuar si pjesëmarrës për vdekjen e Papit. Kryetari i fisit Mamikonian, Manuel Mamikoniani, së bashku me përkrahësit e tij, e dëboi Varazdatin nga tokat e tij dhe shpalli mbretër djemtë akoma të vegjël të Papit, Arshakun dhe Vaharshakun, duke u kthyer ai vetë në tutor (kujdestar).

Në vitin 383, Romakët ndërmorën një fushatë të re ndaj Persianëve, e cila përfundoi në vitin 387 me marrëveshjen e paqes dhe ndarjen e Armenisë së Madhe. Nën sovranitetin e Persisë kaloi pjesa më e madhe e Armenisë Lindore, ku sundonte Khosrov i III<sup>të</sup> Arshakuni. Nën sovranitetin e Romës kaloi një pjesë e vogël e Armenisë Perëndimore, ku vazhdoi të sundonte djali i Papit, Arshaku i III<sup>të</sup>. Ky i fundit, pas ndarjes, sundoi vetëm dy vjet. Pas vdekjes së tij, në pjesën ku sundonin Romakët, u ringrit mbretëria Armene.

Në pjesën ku sundonin Persët, pas vdekjes së Arshakut të III<sup>të</sup>, Khosrovi i III<sup>të</sup> Arshakuni tentoi të ribashkonte Armeninë e Madhe. Për këtë tentativë, oborri mbretëror Pers e rrëzoi nga fronti dhe në vend të tij emëroi vëllanë e tij, Vramshapuh (389-415).

Vitet e mbretërimit të Vramshapuhut kaluan në qetësi; në atë kohë Mesrop Mashtotci kishte krijuar Alfabetin dhe së bashku me Sahag Partevin hodhën bazat e mësimin të Krishterimit në gjuhën Armene.

Pas vdekjes së Vramshapuhut, përsëri erdhi në fron Khosrovi i III<sup>të</sup>,

i cili vdiq pas disa muajsh. Pas kësaj, si mbret i Armenisë u emërua djali i mbretit të Persisë, Hasegertit të I<sup>rë</sup>, Shapuhu (416-420), pas të cilit për njëfarë kohe Armenia mbeti pa mbret.

Në vitin 422, mbret i Armenisë u emërua djali i Vramshapuhut, Artashir ose Artashes i III<sup>të</sup> (423-428). Mbretërimi i tij zgjati deri në vitin 428, kur duke marrë shkas ndoshta nga ndonjë pakënaqësi e princërve ndaj mbretit, oborri mbretëror Pers e rrëzoi nga fronti Artashesin e III<sup>të</sup>, me të cilin përfundon edhe mbretërimi i dinastisë Arshakuni brenda Armenisë.

## KREU 16

# LUFTËRAT PËR ÇLIRIM TË ARMENISË NË SHEKULLIN E V

### **Beteja për liri e Armenisë e vitit 450 - 451**

Me fundin e dinastisë Arshakuni brenda Armenisë, në vitin 428 u krijua Marzpani (provincë) i Armenisë, i cili kishte vetëqeverisje të brendshme, duke u lënë princave Armenë të drejtat e tyre si edhe të drejtat e besimit shpirtëror dhe si garanci kryesore për këtë ishte ushtria Armene. Kjo situatë nuk ishte aspak e përshtatshme për sundimtarët Persë, të cilët duhet të provonin t'i jepnin fund kësaj situatë sa më parë që të krijoheshin rrethanat e përshtatshme.

Mbreti i Persisë, Hazkerti i II<sup>të</sup> (439-457), pasi zgjidhi problemet e jashtme, ju drejtua problemeve të brendshme; në rradhë të parë qëndronte asgjësimi i Krishterimit brenda Armenisë. Në vitin 447, në Armeni u dërgua një nënpunës i quajtur Denshapuh, i cili bëri rregjistrimin e popullsisë dhe pronave të tyre si edhe i rriti detyrimet (taksat), masa këto të cilave u shpëtonin vetëm ata që pranonin Zoroastrianizmin si besim të tyre. Përballë tyre, Denshapuhu nxorri princat Armenë që e kishin pranuar Zoroastrianizmin si besim të tyre.

Në vitin 449, Hazkerti i II<sup>të</sup> doli me një dekret që pretendonte ndërrimin e fronit. Më të mëdhenjtë ndër Armenët thirrën një takim në Artashat dhe e refuzuan pretendimin e Mbretit Pers. Ky i fundit, i zemëruar, thirri në Tisbon princërit Armenë, Gjeorgjianë dhe Albanë (*Shënim i imi: bëhet fjalë për shtetin e Albanëve të Kaukazit; Armenët*

*e quanin këtë shtet – Aghvank – Ahvank – Aluank*), për t'i detyruar me anë të kërcënimeve për asgjësim në rast mospranimi. Nën presionin e kushteve të krijuara, princërit u detyruan ta pranojnë dekretin. Si garanci, Hazkert i II<sup>të</sup>, mbajti peng djalin e konsullit Ashush të Kukarit dhe djalin e sundimtarit Vasak të Sjunikut. Gjatë kthimit për në Armeni, bashkë me princat u dërguan edhe 700 magjistarë, të cilët kishin për detyrë të shndërronin Armenët në Zoroastrianë.

Brenda Armenisë, besimtarët kishin filluar një lëvizje kundërshtuese. Në lagjet Ang të Zarevanit, popullsia me në krye Kevond Jerecin u sulën mbi magjistarët duke i detyruar ata t'ja mbathin. Fisnikët Armenë i treguan popullit realitetin, pastaj filluan përgatitjet për kryengritje, objektivi i së cilës ishte pavarësia e Armenisë. Në krye të kryengritësve u vu Vasak Sjuni.

U vendos të dërgohej një delegacion në Bizant, me në krye komandantin Vahan Amatuni, me kërkesë për ndihmë. Ushtria u nda në tre pjesë; një pjesë, nën komandën e Nershapuh Arxrunit, u drejtua për në jug me qëllim mbrojtjen e kufirit jugor me Persinë; pjesa e dytë nën komandën e gjeneral Vartan Mamikonianit lëvizi drejt Albanisë (Aghvankut) për t'i ardhur në ndihmë aleatit të tij, dhe prej andej të kalonte në Çor Pahak, për të sjellë ndihma; kurse grupi i tretë me në krye Vasak Sjunin qëndroi brenda në Ajrrat.

Ndërkaq, Vahan Amatuni u kthye duarbosh; Bizanti jo vetëm e hëngri fjalën e dhënë paraprakisht për ndihmë, por edhe nuk i lejoi princërit Armenë të pjesës Bizantine të ndihmonin vëllezërit e tyre me njësitë e vogla ushtarake që ishin në varësi të tyre; dhe për më tepër akoma, në fshehtësi, njoftuan Persianët për marrëveshjen e kryengritjes.

Deri më atëherë, Vartan Mamikoniani, që kishte shkuar në ndihmë të Albanisë (Aghvankut), në verën e vitit 450 e kishte shpartalluar ushtrinë Perse në betejën e Haghahit (tashmë Gazakh) dhe me të hyrë në Çor Pahak po nënshkruante marrëveshjen e aleancës me të atjeshmit.

Pas marrjes së lajmit për refuzimin e Bizantit për të dhënë ndihmë, Vasak Sjunit ju duk çmenduri të dilej vetëm përballë Persianëve,

kështu që e tërhoqi vazhdimin e pjesëmarrjes së tij të mëtejshme në kryengritje. Pavarësisht kësaj, Vartan Mamikoniani vendosi ta vazhdojë kryengritjen. Për fat të keq, këshilli i pleqve nuk gjeti forcë brenda vetes për të dalë me një deklaratë të përbashkët, kështu që kryengritja mbeti në dorë vetëm të Vasakjanëve dhe Vartanianit.....

Tovma Arxruni shkruan, se pas përçarjes së kryengritjes, kryengritësit morën në shqyrtim kandidaturën për mbret të Armenisë, duke pasë në konsideratë Vahan Amatunin dhe Vartan Mamikonianin. Zgjedhja ra mbi këtë të fundit.

Për të parandaluar përhapjen e mëtejshme të kryengritjes, oborri mbretëror Pers, në verën e vitit 451, dërgoi në Armeni një ushtri të madhe me Mushkan Nusalavurtin në krye. Po atë vit më 26 Maj, në lagjen Artaz të Vaspurakanit, në fushën e Avarajrit, u zhvillua beteja vendimtare. Ushtria Armene, që nga mëngjesi herët e deri në perëndim, me moton “Vdekja për një qëllim, është pavdeksi”, luftoi me tërbim kundër një kundërshtari të pajisur me gurë hedhës dhe elefantë luftarakë.

Beteja e Avarajrit përfundoi me humbjen e Armenëve; në fushën e betejës ngeli i vrarë Vartan Mamikoniani dhe një sërë princash të tjerë Armenë. Ushtria Armene u tërhoq në thellësi të vendit, duke e vazhduar luftën në Tajk, Hahtik, Arcah (Artsach), Moksi, Tmorik, Parhar dhe në zona të tjera malore si këto. Ndërkaq oborri mbretëror Pers ishte i detyruar t'i kthehej politikës së lëshimeve duke e tërhequr detyrimin për ndryshimin e fronit. Me këtë shpjegohet edhe fakti që, në historinë e shkruar Armene, beteja e Avarajrit është komentuar si një fitore morale.

### **Beteja për liri e Armenisë e vitit 481 - 484**

Në vitet 470 mbretëria Perse filloi presione të reja nëpërmjet kërkesave për taksa dhe të drejtën e ndryshimit të fronit. Me akuzën për bashkëpunim me Bizantin, në vitin 478, u hoq nga froni Katolikosi Armen, Kyd Arahezaci.

Për shkak të masave shtërnguese të ndërmarra nga Persët, në vitin 481, brenda Armenisë shpërtheu një kryengritje tjetër, si sinjal i të cilit shërbeu mosbindja e mbretit Gjeorgjian, Vahtank. Armenët dëbuan guvernatorin e vendosur nga Persët, Atervashnaspin dhe formuan një qeveri të tyre. Sahak Bagratuni (protektori i Moisi Horenacit) u zgjodh guvernator, Vahan Mamikoniani kryekomandant.

Në kundërshtim me fjalën e dhënë më parë, Bizanti përsëri nuk i ndihmoi.

Suksesi i parë i Armenëve erdhi në vitin 481 në betejën e Akorrit, gjatë së cilës u vra edhe vetë guvernatori Pers. Suksesi i dytë ushtarak u arrit në vitin pasardhës në betejën e zhvilluar në Nersehat (brenda lagjes Artaz). Në vitin 483, mbreti i Gjeorgjisë i kërkoi ndihmë Armenëve. Po në verën e atij viti, në brigjet e lumit Kur, u zhvillua beteja e Xharmanit, ku ushtria Armeno-Gjeorgjiane pësoi një humbje të thellë; në fushëbetejë mbeti i vrarë edhe guvernatori Sahak Bagratuni.

Vahan Mamikoniani, rrugës së kthimit për në Armeni, vazhdoi luftimet e vështira me forma partizane. Në vitin 484, Persët pësuan humbje nga fiset tribale të Azisë së Mesme, madje u vra edhe mbreti i tyre, Perozi. Mbreti i ri i hypur në fron, Balashi (Vaharç) vendosi të nënshkruajë paqe me Armeninë dhe dërgoi në Armeni Nihor Vashnaspdatin.

Bisedimet e paqes u zhvilluan në krahinën e Herit, brenda fshatit Nvarsak. Persët i pranuan kërkesat e Armenëve. U nënshkrua një marrëveshje, me anë të së cilës Persët hiqnin dorë nga e drejta e emërim-shkarkimit të mbretit Armen, nga ofiqet shtetërore të hiqeshin të paaftët dhe në krye të tyre të vendoseshin ata që e meritonin, oborri mbretëror Pers nuk duhej të përzihej në punët e brendshme të princërve Armenë. Vahan Mamikoniani u njoh si kryekomandant, dhe pas një viti u emërua guvernator.

Nuk është e qartë, se kur vdiq Vahan Mamikoniani. Në listën e pjesëmarrësve të mbledhjes së vitit 506 në Dvin nuk figuron emri i tij, mbi bazën e të cilit dilet në përfundimin, që ai në atë kohë duhet të

kishte qenë i vdekur, kurse në postin e guvernatorit, në vend të tij, ishte i vëllai, Vart Mamikoniani. Ndërkaq, historianë Armenë, që kanë jetuar në shekujt pasardhës, dëshmojnë se Vahan Mamikoniani ka qeverisur si guvernator për 30 ose 31 vjet, që i bie, që Vahan Mamikoniani ka qenë guvernator deri në vitin 516 ose 517, gjë që përputhet me informacionin e dhënë nga Hovhanes Tras'hanakerci, i cili thotë që Vahan Mamikoniani, i pasuar në pozicionin e guvernatorit nga i vëllai, Varti, në kohën e Katolikosatit ka qenë shndrruar në Samueli i I<sup>rë</sup> Arckeci (516-526). Këtu mbetet pa përgjigje vetëm pyetja, se përse Vahan Mamikoniani nuk përmendet në mbledhjen e Dvinit të vitit 506.



## KREU 17

# ARMENIA NË SHEKUJT VI - IX

### Armenia Lindore në shekullin e IV

Pas Vahan Mamikonianit, si guvernatorë u emëruan Vart Mamikoniani dhe Musheh Gnuni, gjatë periudhës së qeverisjes të të cilëve Armenia gëzoi një pavarësi të brendshme. Por në kohën kur mbretëria Perse nën mbretin Pers, Hosrovi i I<sup>të</sup> Anushirvani (531-578), u forcua, rifilloi rëndimi me taksa dhe marrja nëpër këmbë e të drejtave të Armenëve.

Dhuna e ushtruar nga guvernatori Pers, që erdhi në Armeni në vitin 564, krijoi kushtet për një kryengritje të re. Në vitin 571, u ngritën përsëri në këmbë duke pasur në krye nipin e Vartit, vëllait të Vahan Mamikonianit, djaloshin Vartan Mamikoniani, si edhe Katolikosi Hovhanes i II<sup>të</sup> Gabehenaci. Kryengritjes ju bashkuan edhe Gjeorgjianët dhe Albanët (Aghvanët - Alvanët). Vitin në vazhdim, Armenët u shkaktuan humbje forcave Perse në fushën e Dvinit; u vra gjithashtu edhe guvernatori. Duke parë fillimin e suksesshëm të kryengritjes, Bizanti ndërhyri dhe kështu filloi lufta Perso-Bizantine 20-vjeçare, e cila përfundoi në vitin 591 me nënshkrimin e marrëveshjes. Kjo marrëveshje e ndante Armeninë për të tretën herë; pjesa më e madhe e vendit i kalonte Bizantit, ndërsa pjesa më e vogël i mbetej Persisë. Vija e kufirit të ndarjes kalonte nëpër lumin Azat, nëpër provincën e Kogovit, qytetin Maku dhe liqenin Van.

## Armenia Perëndimore në shekullin e VI

Siç është përmendur edhe më parë, në vitin 451, në qytetin Kahketonia (Kaledonia) të Azisë së Vogël u organizua mbledhja botërore e Krishterimit, nga ku Kisha doli e ndarë në dy pjesë (shkak i grindjes dhe ndarjes u bë natyra e Krishtit): njënatyrë (grupi që pretendonte së Krishti kishte vetëm natyrë hyjnore), dhe dynatyrëshe (grupi që pretendonte se Krishti kishte natyrë hyjnore dhe njerëzore). Në kundërshtim me Kishën Bizantine, Armenët i mbetën besnik pranimit fillestar të natyrës së Krishtit, pra Krishti për ta kishte vetëm natyrë hyjnore, gjë që mori formën përfundimtare në vendimet e mbledhjeve të vitit 506 dhe 554 të zhvilluara në Dvin. Si pasojë e kësaj filloi edhe diskriminimi fetar ndaj Armenëve.

Me qëllim asgjësimin e të drejtave të Armenëve që banonin në pjesën e Armenisë Bizantine, perandori Justiniani i I<sup>rë</sup> (527-565) dërgoi dekrete të veçanta. Njëpërmjet tyre, princërit Armenë privoheshin nga e drejta trashëgimore për të pasur ushtri të tyre, tokat Armene u bashkuan në një zonë të vetme strategjike ushtarake, e cila duhet të ndiqte strategjinë ushtarake të Bizantit. Në vitin 536, tokat Armene u ndanë në 4 pjesë: Armenia e parë, Armenia e dytë, Armenia e tretë dhe Armenia e katërt. Po atë vit doli një ligj, i cili kishte për qëllim të copëzonte të drejtat zotëruese të princërve, të asgjësonte fuqinë e tyre; nëqoftëse deri më atëherë e drejta e zotërimit (e drejta e trashëgimisë princërore) kalonte pa pengesë nga i ati tek i biri më i madh, Justiniani njëpërmjet ligjit të ri vendosi kufizim. Sipas ligjit të ri, e drejta e trashëgimisë së babait duhet të ndahej në mënyrë të barabartë jo vetëm ndërmjet fëmijëve meshkuj, por edhe atyre të gjinisë femërore.

Këto ndryshime sollën rebelimin e popullsisë Armene, nga të cilat më të bujshme qenë kryengritja e Armenisë së parë në vitin 539 me në krye Hovhanes Arshakunin dhe djalin e tij, Artavanin, dhe tentativa e dështuar e Arshak Arshakunit për vrasjen e Justinianit në vitin 548.

Gjendja u përkeqësua akoma më tepër gjatë sundimit të perandorit Morik (Mauricious) (582-602), i cili filloi që t'i nxjerrë trupat ushtarake

Armene jashtë kufijve të Armenisë duke ndjekur politikën e asgjësimit të tyre në vende të tjera. Sipas dëshmisë së Sepeosit (shekulli i VII), Sepeosi i kishte dërguar një letër mbretit të Persisë, Khosrovit të II<sup>ë</sup>, ku e këshillonte të bënte të njëjtën gjë me forcat ushtarake Armene që ndodheshin në pjesën e zotërimit Pers.

Kundër kësaj politike Bizantine u ngritën disa prej princërve Armenë, ku më i shquari ndërmjet tyre ishte Simbat Bagratuni. Një tjetër kryengritje Armene zuri fill në vitin 595, kur një grup princash Armenë kishin parashikuar që me një aleancë me banorët e zonave veriore të mund të rifitonin pavarësinë e shtetit Armen, si nga mbretëria Perse, ashtu edhe nga perandoria Bizantine. Për fat të keq, kryengritja u shtyp.

### **Fushatat Arabe dhe pushtimi i Armenisë**

Në vitet 630, Arabët të bashkuar nën flamurin e një feje të re, Islamit, filluan fushatat pushtuese ndaj Persisë dhe Bizantit. Si pasojë e këtyre fushatave, mbretëria Sasanide Perse pushoi së ekzistuari, kurse Bizanti humbi disa nga hapësirat e saj lindore.

Në vitin 640, filloi mësymja e parë e Arabëve në Armeni, gjatë së cilës ata hapën shtegun në rrethinat e Tavrosit Armen, duke arritur në veri të liqenit Van nëpërmjet fushës së Araratit, nga ku pas një dite rrethimi pushtuan Dvinin duke vrrarë 12 000 Armenë dhe duke marrë robër 35 000 të tjerë. Gjatë viteve 640 ndodhën një sërë inkursonesh të tjera.

Në vitin 652, ndërmjet princit Armen, Teodor Ashtuni, dhe udhëheqësit Arab të Asorëve, Muavjanit, u nënshkrua një marrëveshje, me anë të së cilës Armenët njihnin sovranitetin e Arabëve me kushtin, që nuk do të paguanin taksa për 3 vjet; pas kësaj kohe ata do ta vendosnin vetë madhësinë e taksave. Armenët duhet të strehonin në çdo kohë një kalorësi prej 15 000 vetësh, për shpenzimet e të cilëve do kujdeseshin vetë Arabët, në këmbim të së cilës, ushtritë Arabe nuk do të shfaqeshin brenda territorit Armen, ndërsa në rastin e hyrjes së forcave të huaja, të dyja palët ishin të detyruara të ndihmonin njëra tjetrën.

Në gjysmën e dytë të shekullit të VII, Armenia kishte një pavarësi të brendshme. Për më tepër, erdhën vite, kur duke shkundur sundimin Arab, Armenët nuk i paguanin haraç askujt. Çuditërisht, pleqësia Armene nuk arriti të shfrytëzojë mundësinë e përshtatshme për të rivendosur mbretërinë e pavarur.

Në vitin 701, Arabët e pushtuan përfundimisht Armeninë. Armenia, Gjeorgjia dhe Albania (Aghvanku - Alvania) u bashkuan duke formuar një mbretëri të re të quajtur "Arminia", të cilën e qeveriste një polic (nuunhluu) Arab. Në thelb, në të vërtetë, Armeninë e udhëhiqte princi Armen.

### **Kryengritjet Armene të shekujve VIII - IX kundër sundimit Arab**

Kalifati, në rradhë të parë, vuri në shënjestër heqjen e të drejtave trashëgimore të princërve Armenë, gjë që u bë shkak për kryengritjen e vitit 703 brenda Armenisë me në krye kryekomandantin Simbat Bagratuni. Armenët fituan disa beteja, pastaj, nën presionin e forcave të mëdha të armikut u detyruan të tërhiqen, duke kaluar në territorin e kontrolluar nga Bizanti.

Për t'i prerë kokën aristokracisë Armene, polici Arab, në vitin 705, ju drejtua mashtrim; i ftoi ata në Nahxhavan duke u premtuar që do t'u paguhej pension nga ana e Kalifatit. Brenda kishave të Nahvaxhanit dhe Hramit u arrestuan me tradhëti rreth 1200 aristokratë Armenë dhe u dogjën. Pas kësaj ngjarje të rëndë filluan presione të reja. Në vitin 725 u bë një rregjistrim i ri i popullsisë dhe taksat u shtuan.

Në vitet 748-750 u zhvillua një tjetër kryengritje brenda Armenisë. Për fat të keq, ndërmyet udhëheqësve të kryengritjes, princërve Mamikonianëve dhe atyre Bagratuni, lindën mosmarrëveshje, gjë që nuk i dha mundësi kryengritjes të kishte sukses. Arabët arritën përsëri me anë të tradhtisë ta mposhtin kryengritjen.

Në vitin 762, nën kryesinë e Arxruninëve, brenda Vaspurakanit lindi një kryengritje e fuqishme, gjatë së cilës u rregjistruan akte të një heroizmi të veçantë.

Kryengritja më e madhe dhe më e fuqishme kundër sundimit Arab ishte ajo e vitit 774-775, që kishte në krye Musheh Mamikonianin dhe Simbat Bagratunin. Ishte shtruar çështja për pavarësinë e vendit. Arabët dërguan forca të shumta shtesë në Armeni dhe ja arritën ta shtypin kryengritjen. Pas kësaj, Mamikonianët dhe disa shtëpi të tjera princërore ju nënshtruan masakrave, si pasojë e të cilave, ata zgjodhën si zgjidhje përfundimtare daljen jashtë kufijve, mërgimin.

Në shekullin e IX, brenda Armenisë ishin fuqizuar veçanërisht Bagratunët, Arxruninët dhe Sjuninët. Për të asgjësuar fuqizimin e Bagratunëve në Armeni, kalifi Al-Mutavakil bëri një tentativë në vitin 849. Në përgjigje të kësaj, në vitin 850-855, në Armeni shpërtheu një kryengritje e madhe kundër sundimit Arab. Në ato vite, dekretet e ushtrisë Arabe, arrestimet, marrjet rob dhe sjelljet shtazarake nga më të ndryshmet, nuk ja arritën të thyenin shpirtin lirisht Armen. Më së fundi, Kalifi u detyrua të tërheqë mbrapsht nga Armenia trupat e tij ushtarake dhe të njohë pavarësinë e plotë të brendshme të Botës Armene.

Në vitin 885, Kalifati emëroi si sundimtar të Armenisë 35-vjeçarin Ashot Bagratuni, një personalitet me talent të spikatur, të cilit fati i dha mundësinë të ringrinte në këmbë Mbretërinë Armene pas afro 450 vjetësh ndërprerjeje.



## KREU 18

# KULTURA ARMENE NË SHEKUJT IV - VIII

Në vitin 301, krahas me besimin pararendës u frenua edhe leteratura pagane Armene. Priftërinjtë për predikimet e tyre përdornin gjuhën Greke ose Asore, të cilat jo vetëm që nuk i përgjigjeshin nevojave të popullit, por pas ndarjes së Armenisë në vitin 387, ishin shndërruar në një rrezik serioz për identitetin kombëtar të popullit Armen.

Kësaj shtate, zgjidhjen më të mirë ja gjeti mendjendrituri Mesrop Mashtotc (361-440), i cili duke krijuar shkrimin e ri për gjuhën Armene, bashkoi edhe politikisht popullin e ndarë Armen. Këtë ndryshim epokal ai e realizoi me mbështetjen e fuqishme të mbretit Vramshapuh dhe katolikosit Sahak Partev. Pas kësaj Mashtotci mori përsipër mësimin e shkrimit për brezat e rinj të kishtarëve Armenë.

Me shpikjen e mrekullueshme të alfabetit Mashtotcian në vitin 405 u bë i mundur mësimi i Krishterimit në gjuhën Armene. U hapën shkolla për mësimin e gjuhës Armene në të gjithë vendin. Për të marrë leje për hapjen e shkollave për mësimin e gjuhës Armene në pjesën Armene që ishte nën sovranitetin e Bizantit, Mesrop Mashtotci shkoi vetë personalisht në Kostantinopojë dhe e mori atë nga dora e vetë Perandorit.

Katolikosi Sahak Partev dhe Mesrop Mashtotci vunë bazat e lëvizjes për përkthimin në gjuhën Armene; ata së bashku me nxënësit e tyre më të vjetër i hynë punës për përkthimin e Biblës dhe një sërë veprave të tjera me vlerë në gjuhën Greke dhe Asore. Në sajë të kësaj lëvizjeje



Mesrob Mashtotc



Alfabeti Armen



Moisi Korenaci

janë shpëtuar dhe ruajtur disa dhjetëra punë të veçanta, origjinalet e të cilave, të shkruara në gjuhën Greke apo Asore, sot rezultojnë të humbura, dhe i kanë arritur njerëzimit deri në ditët e sotme vetëm në sajë të përkthimeve të ruajtura në gjuhën Armene.

Gjatë shekullit të IV u përkthyen veprat e shkruara në gjuhën Greke dhe me vlerë historike, nga të cilat padyshim më të rëndësishmet ishin veprat e Agatangelosit dhe Paustos Bizantit. Brenda faqeve të librit “Historia e Armenisë” të Agatangelosit është treguar historia e shpalljes së Kristianizmit si fe zyrtare shtetërore në Armeni, jeta dhe vepra e Dertatit të III<sup>të</sup> dhe Grigor Iluminatorit; me një gjuhë të kuptueshme edhe për popullin e thjeshtë është paraqitur përhapja e Krishterimit.

“Historia e Armenisë” e Paustos Bizantit është vazhdim i asaj të Agatangelosit, që fillon me djalin e Dertatit të III<sup>të</sup>, Khosrov Kotakit, deri në periudhën e ndarjes së parë të Armenisë (330-387) ndërmjet Romës dhe Persisë.

Në vazhdim të traditës së krijuar në shekullin e IV me shkrimin e historisë së Armenisë, me qëllim vazhdimin e punës së paraardhësve të tyre historianë, në shekullin e V u ngarkua Kazar Parpeci (Ghazar Parpetsi), i cili me urdhër të Vahan Mamikonianit dhe me sugjerimet e tij shkroi “Historia e Armenisë”. Kjo e fundit përfshin një periudhë

afro njëqindvjeçare, periudhën nga viti 387 deri në rënien heroike të Vahan Mamikonianit në fushë të betejës (viti 451).

Kazar Parpecin e ndoqi historiani i shekullit të VII, Sebiosi, i cili pasqyroi historinë e Armenisë deri në momentin e vdekjes së tij. Sebiosin e pasoi Kevonti (shekulli VIII), vepra e të cilit është një burim i paçmuar për historitë e luftimeve për liri të zhvilluara brenda në Armeni gjatë shekullit të VIII kundër sundimit Arab.

Pati edhe vepra që i kushtoheshin ngjarjeve ose vendeve të veçantë. Veçanërisht, vepra e Jegishes “Për luftën e Vartanit dhe të popullit Armen”, i cili tregon për luftën e Vartanit si dëshmitar okular. Historiani i shekullit të VII, Hovhan Mamikoniani paraqet “Historia e Taronit”, duke përmbledhur materiale interesante, ndër të tjera edhe letrat me vlerë shumë të madhe të shkrimtarit Asor të shekullit të IV, Zenop Glaki, lidhur me ngjarjet e shpalljes së Krishterimit si fe zyrtare shtetërore brenda Armenisë. Po kështu edhe historiani i shekullit të VII, Moisi Kaghankatvatsi, paraqiti historinë e Botës Aghvanke (Albania e Kaukazit), e cila në shekullin e X u vazhdua nga Moisi Daskhurantsi (*Datat e sakta të jetës së tyre nuk dihen – Shënim i imi*).

Maja më e lartë, e paarritshme, e shkrimit të historisë Armene është, pa dyshim, Moisi Horenaci (410-490), i cili me të drejtë meriton titullin “Babai i historisë Armene”. Ai shkroi një histori të plotë të vendit dhe popullit Armen, nga Prijësi Hajk deri në vdekjen e Mesrop Mashtotcit (viti 440). “Historia e Armenisë” e shkruar prej tij (rreth vitit 474) përfundon me një “Vajtim” për vitet që pasuan rënien e mbretërisë Armene, e cila përbën një formë origjinale të shmangies nga teprimet që kishin gjetur vend brenda realitetit Armen.

Në shekullin e V u krijuan edhe vepra që kishin të bënin me etikën e sjelljes. Kësaj gjinie (zhanri) i përket edhe kryevepra e nxënësit të vjetër të Mesrop Mashtotcit, Korunit (380-450), “Edukata e Mashtotcit”.

Duke studjuar vendimet e mbledhjeve të Kishës të shekujve IV - V, si edhe rregullat (ligjet) e shkruara nga individë të shquar (Grigor Iluminatori, Nersesi i Madh, Sahak Partevi, Hovhan Mandakuni dhe

të tjerë) dhe duke i përmbledhur në një, në shekullin e VIII, Hovhan Oxneci krijoi përmbledhjen “Libri i ligjeve Armene” me një vlerë shumë të madhe, përmbledhje kjo, që në të ardhmen do të shërbente si bazë për mendimin juridik Armen.

U krijuan këngë kishtare, të cilat kishin për autorë figurat më të njohura të asaj kohe (Grigor Iluminatori, Sahak Partevi, Mesrop Mashtotci, Moisi Horenaci dhe të tjerë). Si bazë për to, ka të ngjarë, të kenë shërbyer meloditë fetare paraKristiane.

Populli këndonte me dashuri këngët për heronjtë e vet, gjithashtu edhe ato që i kushtoheshin perëndive të vjetra të tyre. Paustos Bizanti (Faustos Bizanti) informon, se në kohën e sundimit të Tiran (Diran) Arshakunit (338-350) brenda popullsisë ishin akoma shumë të gjalla besimi dhe zakonet paraKristiane. “Ata i donin këngët e tyre, përrallat, legjendat, ishin shumë të etur pas tyre, u besonin atyre, ishin të mbërthyer fort pas tyre”. Babai i historisë tregon për një numër këngësh që këndoheshin në shekullin e IV në Gotni (Գոռթնի) si: “Himni i lindjes së perëndisë Vahak”, “Hajku dhe Peli”, “Arami dhe Barshami”, “Bukuroshja Ara dhe Shamirami”, “Tigrani dhe Azhdahaku”, etj.

Armenët kishin rënë në sy edhe në vende të tjera. Në shekullin e I para Krishtit, Tiran (Diran) Armeni (Tiranioni), i marrë peng si rob luftime prej Tigranakertit, u dërgua në Akademinë e Letërsisë dhe Oratorisë të themeluar brenda në Romë nga Ciceroni. Në shekullin e IV, një famë të madhe gëzonte filozofi dhe oratori Parujr Armeni (Proeresiosi – Պրոէրէսիօսը), nxënës i të cilit ishte edhe perandori Julian Uraci. Në nder të djalit Armen, brenda Romës ka qenë ngritur edhe një përmendore me mbishkrimin “Prej mbretëreshës së botës, Romës, mbretit të oratorëve”.

Në shekullin e V, në shekullin e artë të shkrimit Armen, ishte i njohur filozofi Jeznik Kohbaci, një nga nxënësit më të vjetër të Mesrop Mashtotcit, në veprën e të cilit “Kundër Sekteve” (Էդծ Աղաւնդոց), parë nga botkuptimi i Krishterë, kritikoheshin fetë e tjera që njiheshin në botën e atëhershme.

Përfaqësuesi më i shkëlqyer i mendimit filozofik Armen i periudhës së Mesjetës (shekujt V - VI), padyshim, ka qenë Davit Anhahti (David the Invincible – Davidi i Pamposhtur), i cili është i njohur për analizën që i bën veprave të filozofëve Grekë (Platonit, Aristotelit, Porfirrit, etj). Kryevepra e tij është “Në kufijtë e Filozofisë” (Մասնաշարժի խնամքը) (Uuhúwup Իմաստասիրույթան).

Në fillim të shekullit të VIII, Stepanos Sjuneci, me përkthimet e tij, e pasuroi letërsinë filozofike Armene.

Në sferën e shkencave natyrore një kontribut të madh pati edhe studjuesi (matematicieni), astronomi dhe natyralisti Anania Shirakaci (shekulli VII). Shumë prej ideve të tij lidhur me kozmosin (astronominë) gjetën njohje në mbarë botën vetëm disa shekuj pas vdekjes së tij.

Kryevepra e hartografisë Armene të Mesjetës së hershme është “Gjeografia”, e cila u hartua në shekullin e V nga Moisi Horenaci, dhe që u plotësua në shekujt që pasuan (ndërmjet të tjerëve, ka gjasa të ketë qenë edhe Anania Shirakaci).

Në shekujt IV - V janë ndërtuar si ndërtesa banimi, ashtu edhe ndërtesa me karakter shpirtëror (fetar). Ndërtesat kishtarë vazhduan të ndërtoheshin duke ruajtur traditën arkitekturore paraKristiane. (Հիմնական մեծ միասնա կամ եռասնա պաղիլիքներ կը կառուցուին – Brenda objektit qendror ndërtoheshin bazilika një ose trekëndore). Nga fundi i shekullit të V në ndryshim prej tyre do të shfaqen kishat me kube. Sukseset e rëndësishme të arkitekturës Armene në shekujt VI - VII i pajisin kishat me kube qendrore në formë kryqi (si shembull mund të përmendet Tempulli i Hripsimesë i vitit 618 i ndërtuar nga Katolikosi Komitas). Sipas të njëjtit stil është ndërtuar edhe Tempulli me tre kate i Zvartnocit (i cili është ndërtuar nga katolikosi Nersesi i III<sup>të</sup> Tajeci në vitet 641-661).

Vazhdon të zhvillohet mjeshhtëria e mozaikëve; në këtë periudhë, mozaikët më të famshëm me mbishkrime Armene janë gjetur në kishat Armene që ndodhen brenda Jeruzalemit.

Në Mesjetën e hershme zhvillohet mjeshtëria e zbukurimit të librave, pikturat në miniaturë, prej të cilave vetëm një numër shumë i pakët ka arritur të ruhet deri në ditët e sotme.

Në periudhat e hershme, brenda Armenisë kishte teatro në gjuhën Greke (për aristokracinë - shtresën e lartë të shoqërisë) dhe në gjuhën Armene (për shtresat popullore). Në Mesjetën e hershme, ekzistencën e tyre e ruajtën vetëm teatrot popullore në gjuhën Armene.

## KREU 19

# ARMENIA NË PERIUdhËN E MBRETËRISË BAGRATUNI

Në vitet 850-855, pas kryengritjeve, u krijuan të gjitha kushtet për ringritjen e mbretërisë së pavarur Armene. Në vitin 855, pas njohjes së Ashot Bagratunit si princ i Armenisë, Kalifati, i detyruar, ju drejtua lëshimeve të reja. Ai u detyrua ta njohë Ashot Bagratunin si princ i principatave të Armenisë, Gjeorgjisë dhe Aghvankut (Albanisë).

Numri i njerëzve nën armë, që përbënin ushtrinë Armene, i kalonte të 40 000 vetët, numër ky mjaft serioz për të rifituar mbretërinë. Detyrën e kryekomandantit të ushtrisë, Ashot Bagratuni ja kaloi të vëllait, Abasit.

Në vitin 867, në fronin e Bizantit hypi Barsehu i I<sup>rë</sup> (Vasili) me origjinë Armene, duke synuar pasurinë e Armenisë ose të Maqedonisë. Qëndrimi i tij proArmen u shndërrua në një premisë të jashtme mjaft të favorshme për ringjalljen e pavarësisë së Armenisë.

Nën kryesinë e Katolikosit Zakaria Xageci, në vitin 869 u thirr kongresi i të vjetërve (Këshilli i Pleqve) të Armenisë, i cili vendosi të shpallë Ashot Bagratunin mbret të Armenisë. Kongresi ju drejtua Kalifatit, me qëllim që ky i fundit të njihte legjitimitetin e vendimit të marrë. I shqetësuar nga ideja se në perspektivë Armenia mund të kalonte në anën e Bizantit, Kalifi u detyrua t'ja jepte kurorën mbretërore Ashot Bagratunit në vitin 885. Mbret u bë gjithashtu edhe Barsehu i I<sup>rë</sup>. Në 26 Gusht të vitit 885, Ashot Bagratuni u kurorëzua mbret brenda në qytetin e Bagaras, i cili u shndërrua në kryeqytetin e parë të mbretërisë.

Ashotin e I<sup>rë</sup> (885-890) e pasoi Ambati i I<sup>rë</sup> (890-914), i cili bëri për kryeqytet Jerazkavorsin (Shirakavanin). Ai, në vitin 897, në krye të princërve Gjeorgjiane vendosi Atorneseh Bagratunin për mbret dhe kështu vuri bazat e mbretëritit Bagratunian në Gjeorgji. Në vitin 904, Simbati i I<sup>rë</sup> ndërmoi një fushatë të madhe kundër malësive Kaukaziane duke i imponuar mbretit Jegerac Konstantin sovranitetin e tij. Ai e meritoi titullin “Sundues i Plotfuqishëm”.

Duke e kuptuar që Armenët ishin të pathyeshëm kur ishin të bashkuar, Arabët filluan të kërkojnë mënyrën për t'i përçarë ata. Një rast i tillë u paraqit kur lindi grindja ndërmjet Arxrunitëve dhe Sjuninëve për Nahxhavanin. Simbati i I<sup>rë</sup> e zgjidhi grindjen në favor të Sjuninëve, nga ku, Gagik Arxrunit, të mbetur i pakënaqur, Arabët i prematuan ta bënin mbret posa që të kishin rrëzuar nga fronin Simbatin e I<sup>rë</sup>.

Princi i Vaspurakanit, Gagik Arxruni, në vitin 908 mori kurorën mbretërore prej Arabëve dhe shpalli mbretërinë e Pavarur (e cila ekzistoi deri në vitin 1021). Në vitin 909, emiri Jusuf dhe Gagik Arxruni ndërmorën një fushatë kundër Simbatit të I<sup>rë</sup>, i cili mundet dhe mbyllet brenda Kështjellës Blu (Kapujt Pert). Simbati i I<sup>rë</sup> kërkon bisedime, ndërkohë arrestohet dhe në vitin 914 i pritët koka. Luftën e vazhdoi princi Ashot, i cili më pas u shpall mbret me emërtimin Ashoti i II<sup>të</sup> Jerkat (919-928). Si pasojë e kësaj lufte këmbëngulëse, Kalifati u detyrua, që në vitin 922, ta njohë Ashot Jerkatin “Shanshah (mbret i mbretërve) të Armenisë dhe Gjeorgjisë”. (Shënim i imi: Pas këtij viti nuk shohim të shfaqet më emri Aghvank – Alvank - Albania)

Pas Ashotit të II<sup>të</sup> Jerkat, në fron hypi i vëllai, Abasi (928-953), i cili për kryeqytet bëri Karsin. Në vitin 947, ai e çvendosi vendqëndrimin e Katolikosit prej Aghtamarit në Kars, gjë që kishte si qëllim përqëndrimin dhe përforcimin e qeverisjes.

Mbretin Abas e pasoi Ashoti i III<sup>të</sup> Vohormax (953-977), në periudhën e të cilit, ushtria Armene numëronte 80 000 vetë. Në vitin 961 kryeqytet u shpall qyteti Ani, përforcimi i parë me mure rrethues i të cilit përfundoi në vitet 963-964. Periudhë e një qetësie të



Katedralja e Ani-it

qëndrueshme, e cila ndihmoi në mënyrën më të mirë për rregullimin e qytetit dhe mbarëvajtjen e tij. U themeluan qendra të reja shkencore dhe kulturore. Prej tyre mund të përmendim komplekset kishtare të Hahpatit dhe Sanahinit, të cilat u ndërtuan me përkujdesjen e mbretëreshës Khosrovanujsh. Mbarëvajtja e qytetit vijoi edhe në periudhën e pasardhësit të Ashotit të III<sup>të</sup> Vohormax, Simbat të II<sup>të</sup> (977-990). Në vitin 989, ai përfundoi rrethimin e ri më të zgjeruar të qytetit Ani (“muret rrethues të Simbatëve”).

Ndërkaq, gjatë periudhës së Ashotit të III<sup>të</sup> dhe Simbatit të II<sup>të</sup> kishte pasur zhvillime, të cilat si pasojë të fundit do të kishin copëtimin e mbretërisë. Fjala ishte për përparësinë mbretëruese. Vëllai i Ashotit të III<sup>të</sup>, Mushehu, që ishte kryekomandant i vendit, në vitin 963 shpallet mbret i Karsit ose Vanit, duke njohur sovranitetin e të vëllait që sundonte brenda Anit (kjo mbretëri zgjati nga viti 963 deri në vitin 1065). Në udhëheqjen e Gurgen Bagratunit, një i ri në moshë nga shtëpia e Bagratunëve, në vitin 978 themelohet një mbretëri e re brenda Tashir-Çoragetit (njihet gjithashtu edhe me emrin “mbretëria e Lorit dhe Kurit (dy qytete këto që ishin afër njëri tjetrit)”); kjo mbretëri pati jetëgjatësi deri në vitin 1113).

Sjuninerët vendosën të mos “ngelen prapa” Bagratunëve dhe Arxruninëve; në vitin 987, pas marrjes së titullit mbret nga emiri Horasan, princi i Sjunikëve, Simbati i I<sup>re</sup> Sjunik shpall mbretërinë e pavarur. Kjo mbretëri pati jetëgjatësi deri në vitin 1170. Brenda territorit Armen vazhdonin të ruheshin emirate Arabe, të cilat synonin të përçanin Armenët.

Një tentativë për të krijuar një mbretëri të fuqishme, që të përmbliedhte edhe pikat më të largëta të mbretërisë, të cilat çfaqnin tendenca shkëputëse, u bë në kohën e Gagikut të I<sup>re</sup> (990-1020), të cilën e vazhdoi i vëllai, Simbati i II<sup>te</sup>. Duke nënshtuar princërit dhe mbretërit gjysëm të pavarur, Gagiku i I<sup>re</sup> krijoi një mbretëri në formën e një lidhjeje (aleance). Në dorëshkrimet Armene ajo figuron si “shtëpia e të gjithë Armenëve”, koka e së cilës ndodhej në Ani ku sundonte “mbreti i mbretërve” (“Shanshahu”); ushtria e saj numëronte 100 000 vetë. Ky sistem qeverisës do të mund të ishte produktiv, nëqoftëse do të kishte vazhdimësi fuqia sunduese e mbretërimit të përqëndruar në Ani, gjë që nuk u bë e mundur.

Në periudhën e sundimit të Gagikut të Irë vendi arriti një rritje të madhe ekonomike. Një shtysë e fuqishme ju dha arsimit, shkencave dhe kulturës. U ndërtuan tempuj të rinj, nga të cilët më i njohuri është Tempulli i Nënës së Shenjtë në Ani, e cila u ndërtua nga arkitekti i famshëm, Dertati, me përkrahjen e mbretëreshës Katranite.

Pas Gagikut të Irë, në fron hypi djali i tij më i madh, Hovhanes Simbati (1020-1041). Ndaj tij filloi një luftë për fron nga i vëllai i tij më i vogël, Ashoti, të cilin e mbështeste Bizanti. Konflikti i armatosur përfundoi me marrëveshje; Hovhanes Simbati do të qeveriste në Anii dhe ushtrinë mbretërore (սարգստական զորքերը), ndërsa Ashoti i IV – krahinat e tjera. Pas vdekjes së Hovhanes Simbatit, Anii-a do t’i kalonte Ashotit të IV.

Veçimi i zotërimit të Aniiit detyrimisht solli si rezultat disa pasoja negative; mbreti i Vaspurakanit, Senekerim Arxruni, duke u shqetësuar nga këto grindje (սասանական լուսնային) në Lindje, në vitin 1021 ja dorëzoi mbretërinë Bizantit, në këmbim të së cilës mori krahinën e Sebastisë dhe u transferua atje.

Pas shtypjes së kryengritjes që kishte filluar brenda Tajkut, perandori i Bizantit, Vasil (Barsehu) i II<sup>të</sup>, në bisedimet e Trapizonit (Trabizonit) (viti 1022) kërkoi që Hovhanes Simbati t'ja dorëzojë Bizantit mbretërinë e Aniit. Duke ju nënshtruar kërcënimeve të perandorit dhe këshillave të Katolikosit Bizantin, Petros Getadarci, Hovhanes Simbati ja dorëzoji Bizantit mbretërinë e Aniit. Kjo e shkelte marrëveshjen testamentare që kishte bërë me të vëllanë, por Ashoti i IV nuk ndërmori asnjë hap, pasi aktualisht edhe ai vetë ndodhej nën tutelën e Bizantit.

Në vitin 1041, vdiqën me rradhë, në fillim Ashoti i IV, dhe pas tij Hovhanes Simbati. Perandori vazhdoi ta ruajë të drejtën mbi mbretërinë. Çështja e fatit të vendit e ndau pleqësinë Armene në dy kampe: në ata që përkrahnin idenë e vazhdimësisë nën tutelën Bizantine, me në krye Katolikosin Petros Getadarci dhe Vest Sarkis Sjuni, të cilëve u shërbente si argument në favor të tyre marrëveshja testamentare, dhe, në ata që konsideroheshin si forcat patriotike liridashëse Armene, me në krye kryekomandantin Vahram Pahlavuni, që vendosën t'i drejtohen luftës së armatosur. Nga e gjithë kjo grindje, fitues doli një palë e tretë; brenda Armenisë, mbret u shpall djali i Ashotit të IV, tetëmbëdhjetëvjeçari Gagiku i II<sup>të</sup> (1042-1045).

Armenët arritën të shtyjnë me shumë sukses sulmet e Bizantit. Pasuesi i Vasilit të II<sup>të</sup>, perandori Kostantin Monomahu e ftoi Gagikun e II<sup>të</sup> në Konstantinopojë, duke i parashtruar idenë e bisedimeve dhe për të nënshkruar një marrëveshje të re. Mbreti i ri e pranon ftesën duke shpresuar që të gjejë një rrugëdalje nga situata e krijuar. Ndërkaq, Perandori, në pabesi e arreston Gagikun e II<sup>të</sup>, ndërsa forcat proBizantine i dorëzojnë Perandorit çelësat e Aniit. Viti 1045 shënon rënien e mbretërisë së Vanit.

Pas njëfarë kohe nga shuarja e mbretërisë, mbreti i burgosur u lirua dhe ju dha për qeverisje qyteti Pizu, që ndodhej në veri të Kilikisë, së bashku me rrethinat e tij. Interesant është fakti, që ai i vazhdoi përpjekjet për rimëkëmbjen e mbretërisë Ani deri në vitin 1080. Por, planet e tij nuk u realizuan.



## KREU 20

# FUSHATAT E TURQVE - SELXHUKË NË ARMENI

### **Principata e Zakarianëve**

Duke lëvizur prej Altajeve dhe Azisë së Mesme drejt perëndimit, hordhitë e Turqve-Selxhukë, në shekullin e XI, fillimisht pushtuan Persinë, dhe formuan një zotërim të madh Selxhuk. Duke lënë prapa gërmadha e shkatërrime, ata ju afruan kufijve të Armenisë. Pas humbjes së pavarësisë, Armeninë e Bagratunëve po e priste një fatkeqësi e re.

Që në vitet 1016-1020 çeta të vetmuara Turqish-Selxhukë kishin ndërmarrë inkursione në krahinat e Vaspurakanit. Në vitet 1047-1048, Selxhukët ndërmarrin fushatën e tyre të parë të madhe ndaj Armenisë, kurse në vitin 1054, sulmin e ri ndaj Armenisë e udhëheq vetë Sulltani Selxhuk, Tukril beg. Këto sulme kishin një qëllim të pastër për të plaçkitur dhe grabitur.

Në ndryshim nga të mëparshmet, fushata e vitit 1064 e Alp Aslanit, pasuesit të Tukril begut, kishte për qëllim pushtimin dhe forcimin e ngulimeve në tokat e pushtuara. Ai pushtoi tokat e Aghvankut (Alvankut – Albanisë), Gjeorgjinë lindore dhe Armeninë veriore. Të tre mbretëritë Armene (Karsi, Lori dhe Sjuniku) treguan krenarinë e tyre. Në vitin 1065, nën presionin e dominimit barbar turk, mbreti i fundit i Karsit, Gagik Abasjan Bagratuni, ja dorëzoi zotërimet e tij Bizantit, me qëllim që ky i fundit të ndryshonte kufijtë e vet lindorë.

Bizanti, nga ana e tij, pasi mori mbretëritë Armene dhe shpërbëu forcat ushtarake Armene, ndërroi plotësisht politikën dhe e shndërroi veprimin e Bagratunit në një bumerang për Armenët. U prish lidhja e shpresuar e Lindjes së Krishterë dhe Bizanti filloi t'i nënshtrohej invazionit të Turqve-Selxhukë. Më qëllim ndryshimin e situatës, perandori Bizantin, Romanos Diogjeni i IV erdhi vetë në Lindje, madje në vitin 1071, në betejën e Manazkertit, pësoi një humbje të turpshme, duke rënë edhe vetë rob. Për lirin e tij, ai u detyrua t'i lëshojë një pjesë të konsiderueshme të zotërimeve Bizantine të lindjes. Selxhukët e pushtuan tërë Armeninë.

Sundimi i Turqve-Selxhukë u bë katastrofik për Armeninë. Në atë periudhë, qendrat e lulëzuara të civilizimit, ju nënshtroan zjarrit dhe shkatërrimit. Selxhukët, të mësuar me mënyrën nomade të jetesës së tyre, kujdeseshin më tepër për lëndinat e kafshëve të tyre dhe jo për vlerat e larta të kulturës, shkrimit dhe letërsisë.

Në shekullin e XII, mbretëritë e fundit të hapësirave Armene, Lori (në vitin 1113) dhe Sjuniku (në vitin 1170), jetuan fundin e tyre.

Pas rënies së mbretërisë Bagratuniane dhe pushtimit Selxhuk, pjesa dërrmuese e princërve Armenë u larguan për në Bizant ose Gjeorgji. Ky i fundit mori një rëndësi të veçantë për Armenët veçanërisht pas humbjes së pozitave të Bizantit në lindje, kurse Gjeorgjia jo vetëm që ishte fqinj dhe i besueshëm, por atje sundonin Bagratuninët Gjeorgjianë, të cilët ishin një degë më e re e familjes Bagratune Armene (këtu duhet kujtuar se, mbretërinë e Bagratunëve Gjeorgjianë e shpalli Simbati i I<sup>ri</sup> Bagratuni në vitin 897, kur njohu për mbret kushëririn e tij Atorneseh Bagratunin).

Ngritja e mbretërisë Gjeorgjiane filloi në periudhën e Davitit të III<sup>ti</sup> Shinarar (vitet 1089-1125). Banorët e Aniit ngritën krye dhe me ndihmën e mbretërisë Gjeorgjiane, në vitin 1124, kërkuan të shpëtonin nga pushtimi Selxhuk, por pas dy vjetësh Selxhukët ja arritën ta nënshtrojnë përsëri Aniin.

Një nga degët e Arxruninëve, në mesin e shekullit të XI, kishte

kaluar në zonën e Armenisë veriore, dhe kishte zënë vend atje. Sipas emrit të përfaqësuesit të kësaj dege, Zakarias, edhe kjo degë kishte marrë emërtimin Zakarianët. Djali i Zakarias, Sarkisi i Madh, luajti një rol të rëndësishëm në shtypjen e kryengritjes së vitit 1177-1178 kundër mbretit Gjeorgjian, Gjergji i III<sup>te</sup>. Në mirënjohje të këtij akti, Zakarian-Arxruninët, u bënë një nga gjashtë fiset më të fuqishme vendase Gjeorgjiane.

Zakarian-Arxruninët luajtën një rol akoma më të rëndësishëm në periudhën e mbretëreshës Tamara (1184-1213). Në vitin 1185, Tamara emëroi Sarkisin e Madh në postin e kryekomandantit (սարխուսասարխ) të ushtrive të bashkuara Gjeorgjiano-Armene. Pas vdekjes së Sarkisit të Madh, në postin e tij u emërua djali i madh i tij, Zakare, ndërsa djali tjetër, Ivani u emërua Vezir i Madh dhe Atabeg (մեծ վեզիր և ատապէլ) i mbretërisë Gjeorgjiane.

Zakarea dhe Ivani, me ushtritë e bashkuara Gjeorgjiano-Armene, fillojnë çlirimin e pjesës veri-lindore të Armenisë prej Selxhukëve. Në vitin 1196 u çlirua fortesa Ambert së bashku me rrethinat e saj, në vitin 1199 u çlirua përfundimisht Anii (deri më atëherë tre herë e pushtuar dhe riçliruar), në vitet 1202-1204 u çlirua fusha e Dvinit dhe Araratit. Në vitet 1196-1211, falë fushatave të suksesshme, Zakarianët çliruan plotësisht hapësira që i përkisnin Armenisë së Madhe si: Ararati, Gugarku, Artsaku dhe Sjuniku, Turuberanin verior, Utikun perëndimor dhe krahinat veri-lindore të Vaspurakanit.

Zakarianët, që në regjistrat origjinale të familjes figuronin si përfaqësues të Arxruninëve, në Armeninë veri-lindore, veçanërisht, pas çlirimit të Aniit, e quajtën veten trashëgimtarë direktë të Bagratunëve Armenë dhe filluan të përdorin titujt e tyre si “mbret” dhe “Shahnshah- mbret mbi mbretërit”, që ishte thjesht një simbol.

Në krahinat veriore dhe lindore të Armenisë popullsia filloi të marrë frymë lirisht pas ndrydhjes që kishte pasur nën sundimin e Turqve Selxhukë, rifilloi jeta krijuese e shoqërisë, filluan të shfaqen vlerat e shkencës dhe kulturës.

Në vitin 1220 fillojnë sulmet Mongole. Po atë vit, ushtritë e bashkuara të mbretit Gjeorgjian, Gjergj Lasha, dhe të Ivan Zakarianit, pësuan një humbje të rëndë përballë ushtrisë Mongole, të cilët pasi plaçkitën, u larguan. Përgjatë viteve 1236-1244, Mongolët përfundimisht pushtuan fillimisht Armeninë veriore dhe lindore dhe më pas krahinat perëndimore dhe jugore të saj.

Zakarianët luajnë një rol të rëndësishëm në mbretërinë Gjeorgjiane deri në fund të shekullit të XIV. Në burimet Gjeorgjiane ata përmenden si “Մխարզրձեղի” (përkthyer nga Gjeorgjishtja do ishte – երկայնաթիկունք ose լայնաթիկունք – kurrizgjere ose mbase shpatullgjere), i cili ishte edhe epiteti që i kishin vënë Sarkisit të Madh Zakarian-Arxruni. Gjatë periudhës së pushtimit Mongol, ky epitete u përkthye dhe u shndërrua në “Արղութեան” (Արղութ - në gjuhën mongole do të thotë – երկայնաբազուկ – Dorëmadhi). Në fund të shekullit të XVIII dhe në fillim të shekullit të XIX, në rrethin e familjeve mbretërore Gjeorgjiane, perandori Rus njohu edhe Արղութեան-Zakarianët. Një prej degëve të tyre, si përfaqësues me prejardhje Ruse, u bë e njohur me nofkën “Արկուրիսոփի-Долгорук” (Nga Rusishtja, fjala “Dollgoruki” përkthehet – “Dorëgjati”- në shqip).

Mauzoletë që u përkasin përfaqësuesve të fisit Zakarian-Aրղութեան-Արկուրիսոփի, që kanë origjinën prej Arxruninëve, në pjesën më të madhe gjenden në Halpati dhe Sanahin...

## KREU 21

# MBRETËRIA ARMENE E KILIKISË (CILICISË)

Armenët kanë qenë vendosur në Kiliki që në kohë të vjetra. Gjatë periudhës së Tigranit të Madh, Kilikia përfshihej brenda territoreve të mbretërisë së tij. Kronikani i shekullit të IV, Amianos Markelianos, dëshmon se gjiri i Isosit në atë kohë thirrej “Gjiri Armen”. Në shekullin e X numri i Armenëve në Kiliki ishte rritur aq shumë, sa që u krijuan episkopata të reja. Në shekullin e XI numri i Armenëve në Kiliki dhe në rrethinat e saj u rrit shumë. U themeluan principata të ndryshme Armene dhe një numër i madh vendbanime.

Pas betejës së Manazkertit (Manzikert) të vitit 1071, brenda Azisë së Vogël u krijua një situatë e re. Bizanti i humbi zotërimet e veta lindore, ndërsa sundimi Selxhukian nuk ishte konsoliduar akoma. Në këto rrethana, në Kiliki dhe krahinat përreth saj, principatat Armene (Apalharik Arxruni, Pilartos Varazhnuni, Goh Vasili, etj) nuk arritën të shndërrohen në zotërimi aktive. Vetëm princi Ruben arriti të krijojë një zotërim të qëndrueshëm; duke pasur në zotërim vetëm 3 kështjella, në vitin 1080 brenda Kilikisë Malore ai vuri bazat e një principate të pavarur, e cila u quajt sipas emrit të tij, Rubinian.

### **Principata Armene e Kilikisë**

Princin Ruben i I<sup>rë</sup> (1080-1095) e pasoi i biri, Konstantini i I<sup>rë</sup> (1095-1100), i cili principatës së vet i bashkoi një sërë zonash që ndodheshin rreth saj, ndërmjet tyre edhe kështjellën e Vahkut, dhe e shndërroi atë



Statuja e Leonit të VI-të (i njohur si Mbreti Leon i Vtë) në bazilikën e Saint-Denis pranë Parisit.

në qendrën e principatës së tij. Ai vendosi marrëdhënie të mira me kryqtarët. Atë e pasuan Toros i Irë dhe Levoni i I<sup>rë</sup> (1129-1137), të cilët bashkuan nën principatën e tyre pjesën më të madhe të Kilikisë. Madje, Levoni i I<sup>rë</sup> përfshiu në të edhe bregdetin, duke e shndërruar Kilikinë në një principatë Mesdhetare, për parandalimin e së cilës, perandori Bizantin, Hovhanes Komneni, organizoi një fushatë ndaj Kilikisë, duke qenë vetë personalisht në krye të saj, dhe në vitin 1137 e zuri rob Levonin e I<sup>rë</sup> dhe djemtë e tij. Robërisë i shpëtoi vetëm djali i tij, Torosi, i cili duke u arratisur nga Konstantinopoja, u rikthye në Kilikia. Atij ju bashkuan dy vëllezërit që nuk ishin marrë robër, Mlehu dhe Stepani. Duke bashkuar forcat Armene, vëllezërit jo vetëm që i rikthyen kufijtë e zotërimit të Levonit të I<sup>rë</sup>, por u bënë zotër të tërë Kilikisë. Në Kiliki, Princi i Madh, Torosi i II<sup>të</sup> (1145-1169), krijoi një ushtri të përhershme me 30 000 vetë dhe një flotë detare efikase.

Torosin e II<sup>të</sup> e pasoi Mlehu (1169-1175), në politikën e të cilit u shfaq një risi, bashkëpunimi me principatat fqinje Islamike kundër zotërimeve të Krishtera. Përfundimisht ai ra viktimë e tradhtisë. Ai e shndëroi Sisin në kryeqytet të principatës së vet. Mlehun e pasoi djali i Stepanit, Rubeni (1175-1187), i cili emëroi vëllain e tij 40-vjeçar, Levonin (1187-1219), në krye të principatës së Kilikisë me titullin Princ i Madh, ndërsa vetë u tërhoq dhe ju kushtua jetës shpirtërore.

## Shpallja e Mbretërisë. Levoni i II<sup>të</sup>

Sulltani i Egjyptit, Salahedini, në vitin 1187 pushtoi Jeruzalemin, ngjarje kjo që u shndrrua në shkak për organizimin e Fushatës së Tretë të Kryqtarëve (1189-1192). Levoni i II<sup>të</sup> nënshkroi një aleancë me kryqtarët, sipas së cilës ai duhet të ndihmonte ata, në këmbim të së cilës, do të mbretëronte në Perandorinë e Shenjtë Romake (Gjermanike) në krah të perandorit Fridrihu i I<sup>të</sup> Shikamorusi.

Në vitin 1190, për shkak të vdekjes së Fridrihut të I<sup>të</sup> Shikamorusi, mbretëria e Levonit të II<sup>të</sup>, për një farë kohe u la pas dore. Djali i Fridrihut të I<sup>të</sup> dhe pasuesi Hajnrih i VI<sup>të</sup> mori përsipër të bënte realitet fjalën e dhënë të të jatit. Në vitin 1196 ai porositi të bëhej realitet mbretëria e Levonit të II<sup>të</sup>. Duke qenë në dijeni të kësaj, perandori i Bizantit, Aleksis i III<sup>të</sup> Angelos, në vitin 1196 nxitoi t'i dërgonte Levonit kurorën, një flamur me figurën e luanit dhe veshje mbretërore. Në fund të vitit 1197 arriti edhe kurora e dërguar nga Hajnrih i VI<sup>të</sup>. Levoni i II<sup>të</sup> kishte planifikuar ta shndrronte Armeninë Kilikiane në një mbretëri të fuqishme të krishtere të Lindjes, dhe për këtë qëllim e zgjodhi si festë zyrtare Krishtlindjen. Mbretëria u shpall më 6 Janar të vitit 1198 brenda Katedrales së Nënës së Shenjtë Sofia, në qytetin e Taronit. Ishin të pranishëm të ftuarit nga Bizanti, Perandoria e Shenjtë Romake, Kalifati Abbasian i Bagdatit, dhe të ftuar të tjerë nga vendet fqinje, si edhe drejtues të lartë të kishave Greke dhe Asore.

Duke u kurorëzuar, Levoni i II<sup>të</sup> mori titullin “Mbret i Gjithë Armenëve, dhe i krahinave të Kilikisë dhe Isavriosit”, me të cilën kuptohej emërtimi si “Mbret i mbarë Armenëve”; ai fillimisht ishte mbret i “gjithë Armenisë”, më pas u shtua edhe “e krahinave përreth Kilikisë”. Bashkëkohësit e Levonit të II<sup>të</sup> (si mbret i takonte të ishte - Levoni i I<sup>të</sup>) me të drejtë vlerësojnë mbretërimin e tij si ringritja e mbretërisë mbarë Armene të Anit.

Levoni i II<sup>të</sup> i solli një lulëzim të paparë Kilikisë Armene. Një nga treguesit e veçantë të rritjes ekonomike ishte qarkullimi i parasë së shtypur me figurat historike të shekullit të artë. Paraja Armene e Kilikisë “Tagur”-i (shkurtim i emrit “Tagavorakan – mbretëror”), u shndrrua në

një valutë të fuqishme në Mesopotami. Sipër parave, shtypeshin figurat e mbretërve të Kilikisë, me titullin “Mbret i Armenëve”.

Levoni i II<sup>të</sup> nënshkroi marrëveshje të privileguara me Venedikun, Gjenovën. Pizën, dhe me qytete e vende të tjera. Ai krijoi marrëdhënie të ngrohta (madje bëri edhe krushqi) me shtëpitë mbretërore qeverisëse të krishtera.

Princi Levon i II<sup>të</sup>, i cili u shndrrua në mbretin Levon i I<sup>rë</sup>, në historinë Armene mbeti me emrat dhe titujt që vijojnë: “Fitimtari i Madh”, “Fitimtari Universal”, “Besimtari”, etj.

### **Mbretëria Armene e Kilikisë në vitet 1219-1375**

Pas vdekjes së Levonit të II<sup>të</sup>, filluan përsëri problemet me fronin mbretëror, për faktin se ai nuk kishte pasur djalë. Përfundimisht, në vitin 1226 me martesën e vajzës së tij, Zabelit, në fron hypi Hetumi i I<sup>rë</sup> (1226-1269), me të cilin hidhen themelet e shtëpisë mbretërore Hetumiane.

Gjatë periudhës së qeverisjes së Hetumit të I<sup>rë</sup>, në lindje fillojnë të shfaqen Mongolët, me Hanin e Madh të të cilëve, të quajtur Mangu, Hetumi nënshkroi një aleancë miqësie në vitin 1254. Kjo u realizua nëpërmjet një vizite që ai i bëri Hanit të Madh në kryeqytetin e tij, Karakurum, i cili ndodhej disa mijëra kilometra larg Kilikisë. Sipas marrëveshjes, në fushatat që zhvilloheshin në afërsitë e Kilikisë, Armenët duhej të mbështesnin Mongolët dhe anasjelltas. Përveç kësaj, u miratua e drejta e tregtarëve Armenë për të tregtuar lirshëm në të gjithë territorin që konsiderohej zotërim Mongol, kurse Kishës ju lejua statusi zyrtar.

Në vitet 1260 për Armeninë Kilikiane krijohen situata të reja në Mesopotami. Fushatat kryqtare tashmë kishin filluar ta humbisnin fuqinë e tyre, kurse në jug, Sulltanati Mamlukian i Egjiptit kishte filluar të forcohej dhe të ndërmernte një sërë fushatash kundër zotërimeve të krishtera në zonat e Mesdheut Lindor. Armenia Kilikiane, gjithashtu, pëson disfata gjatë fushatave Egjiptiane.

Gjatë sundimit të Levonit të III<sup>të</sup>, dhe më pas, erdhën duke u bërë gjithnjë e më të shpeshta sulmet e zotërimeve islamike fqinje ndaj territoreve të Armenisë Kilikiane. Kërkesat e Armenëve, dërguar vendeve të krishtera Europiane dhe sidomos Papës në Romë, ktheheshin gjithnjë me të njëjtën përgjigje të kushtëzuar; ndihma do të vijë vetëm nëqoftëse Kisha Armene pranon unifikimin (bashkimin) me Kishën e Romës, që do të thoshte, të pranonte Katolicizmin. Diskutimet rreth kësaj kërkesë të ekzagjeruar i ndanë njerëzit në dy grupe të kundërta; në ata që ishin pro dhe ata që ishin kundër saj; kjo e bëri situatën akoma më të tensionuar.

Nga viti 1307 deri në vitin 1316 u zhvilluan një sërë mbledhjesh të karakterit kishtar lidhur me këtë çështje, pas të cilave Armenët pranuan bashkimin me Kishën e Romës. Kjo solli ashpërsimin e qëndrimit të fqinjëve Islamikë. Ndërkohë, nga Perëndimi European nuk erdhi asnjë lloj ndihme, pavarësisht premtimeve. Të zhgënjyer nga Perëndimi, në vitin 1361, Armenët organizuan një mbledhje të re kishtarë dhe e shpallën të pavlefshëm bashkimin me Kishën e Romës.

Në vitin 1373, në fron hypi mbreti i fundit i Kilikisë, Levoni i VI<sup>të</sup> (ndoshta i V<sup>të</sup>) Lusinjani. Në fund të vitit 1374, fuqitë Egjiptiane e sulmuan përsëri Kilikinë dhe më 3 Janar 1375 sulmuan kryeqytetin Sis. Në Shkurt atyre ju bashkuan forcat e Sulltanit të Alepos. U zhvillua një betejë e përgjakshme heroike, në të cilën mbeti i vrarë edhe kryekomandanti Liparit, kurse më 22 Prill, Levoni i VI<sup>të</sup> u dorëzua. Viti 1375, mund të konsiderohet si viti i rënies së mbretërisë Armene të Kilikisë.

Pas kësaj, për rreth 50 vjet, princërit Armenë u përpoqën të ringrenë mbretërinë Armene, por më kot. Me ndërmjetësinë e mbretërive Europiane, në vitin 1382, Levoni i VI<sup>të</sup> Lusinjani u la i lirë dhe largohet për në Europë, ku, deri në fund të jetës së tij (viti 1396) u përpoq të organizonte një fushatë të re me qëllim rifitimin e mbretërisë Armene të Kilikisë. Varri i tij ndodhet në Paris, brenda Mauzoleut Mbretëror në Tempullin Sen Deni.



## KULTURA ARMENE NË SHEKUJT IX - XIV

Mbretëritë Armene të periudhës Bagratuniane, principata e Zakarianëve dhe zotërimet 300 vjeçare Armene të Kilikisë krijuan kushtet më të mira për zhvillimin e arsimit, shkencës dhe kulturës.

Në shekujt IX - XIV, brenda Armenisë vepronte një sistem i shkallëzuar arsimor: shkolla elementare (e cila zgjaste 3-4 vjet) dhe institucione të formimit më të lartë arsimor (që zgjasnin 7-8 vjet). Nga këto të fundit më të dëgjura ishin ato të qyteteve Anii, Argina, Karsi, Halpat, Sanahin, Goshavank ose Getik, Kecaris, Ajrivank, Narjevaj Vank, Sis, Tarso, Glacur, Tatev, etj.

Një zhvillim të madh njohu letërsia historike. Duke ndjekur gjurmët e Moisi Horenacit, Hovhanes Dras'hanagerti e fillon përmbledhjen e tij "Historia e Armenisë" me Prijësin Hajk dhe e vazhdon atë deri në kohën që vdiq (viti 924 apo 925 para Krishtit). Kurse Kirakos Gancageci (shekulli XIII) përmbledh historinë e Armenisë së krishterë duke arritur deri në vitin 1240. Në këtë periudhë, brenda historiografisë Armene shfaqen edhe rryma të tjera, si: historitë fisnore, kronikat dhe historitë botërore (bëhet fjalë për botën që njihej deri më atëherë). Përfaqësues të historisë botërore ishin Stepanos Taroneci Asohiku (shekulli XI) dhe Vardan Arelveli (shekulli XIII).

Përfaqësuesit më të shquar të historiografisë fisnore ishin Tovma Arxruni me ("Historia e shtëpisë së Arxrunitëve") dhe Stepanos Orbeliani me ("Historia e Krahinës Sis").

Në zhanrin e kronikave dhe kalendarëve shquhen Aristakes Lastivervci, Mateos Urrhajeci, Samuel Aneci, Mhitar Aneci dhe në Armeninë Kilikiane është Kryekomandanti Simbat (Gundstabl).

Në fushën e mendimit shkencor vazhdon të mbetet mbizotërues Neoplatonizmi (Platonizmi i ri) (përfaqësuesi më në zë i së cilës ishte Davit Anhahti), një nga idetë origjinale të të cilit ishte mundësia e njeriut për t'i ngjarë Zotit, për t'ju afruar atij dhe për t'u shkrirë me të, mundësi këto që njeriu mund t'i bënte realitet nëpërmjet veprimtarisë mendore dhe shpirtërore. Kjo ide përshkon si një fill i kuq të gjithë faqet e veprës brilante të Grigor Narekacit (951-1003) "Libri i Tragjedisë".

Mbështetës i ideve të Neoplatonizmit ishte Grigor Magistros Pahlavuni (shekujt X - XI), i cili u bë i njohur nëpërmjet një sërë përkthimesh të veprave filozofike si edhe të shkrimeve të emërtuara "Letra".

Brenda realitetit Armen, themelues i rrymës së filozofisë natyrore u bë filozofi i shquar, natyralisti, matematicieni dhe poeti Hovhanes Sarkavag Dijetari (shekujt XI - XII).

Në shekujt XIII - XV, ndër filozofët me origjinë Armene ishin: brenda Armenisë Kilikiane mund të përmendet Vahram Rabuni (shekulli XIII), brenda Armenisë – Hovhanes Jerzankaci (shekulli XIII), Hovhan Vorotneci (shekulli XIV) dhe Grigor Tatevacit (shekulli XIV - XV). Brenda veprave të tyre shkencore parashtrajnë ide filozofike interesante edhe mjekët e shquar Mhitar Heraci (shekulli XII), Grigoris (shekulli XIII - XIV), etj.

Në fillimet e shekullit XIII, me përpjekjet e Hovhan Ocnecit, u krijua përmbledhja e parë e të drejtës zakonore të kishës Armene "E drejta zakonore Armene" (ose "Statuti Armen", "Legislacioni Armen", "Kushtetuta Armene"). Traditën e të drejtës zakonore e vazhdoi Davit Alavkavorti (fondi i shekullit XI - fillimi i shekullit XII).

Mendimin juridik Armen e ngriti në një shkallë më të lartë Mhitar Goshi me veprën "Libri i Gjykimit", nëpërmjet të cilit pretendohet të rregulloheshin marrëdhëniet në të gjitha fushat e veprimtarisë jetësore. Gjatë Mesjetës, ky libër u përkthye në disa gjuhë.

Në Armeninë Kilikiane, ku përveç Armenëve, jetonin edhe Grekë, Asorë dhe kombësi të tjera, dhe ku përgjatë shekujve kishin vepruar ligje jo-Armene, dilte e domosdoshme krijimi i një trajtimi të ri ligjor të problemeve që shfaqeshin në terren. Për të mbushur këtë boshllëk, në shekulli XII, Nerses Lambronaci përktheu një sërë ligjesh Greke, Asore dhe të Kryqtarëve. Kësaj pune i dha formën përfundimtare Simbat Aparaspeti, i cili fillimisht përktheu “Asirianët e Antiokisë” (Ասորացիք Ասորացիք), pastaj shkroi librin e tij “Libri i Ligjeve”, i cili bazohej po në librin “Libri i Ligjeve”, shkruar nga Mhitar Goshi, duke ja përshtatur atë kushteve specifike të Armenisë Kilikiane.

Në periudhën kohore që po merret në shqyrtim, mori zhvillim edhe shkrimi i veprave të artit. U krijuan vepra të reja të sferës shpirtërore, përmbledhje me këngë fetare, përmbledhje me vepra me karakter laik dhe fetar, të cilat bëhen të njohura me emrat “Գաւաւարաւ – Thesari” dhe “Տաղարաւ – Vjersha”.

Përveç madhësisë së paarritshme të Grigor Narekacit, kultura Armene pasurohet me veprat e Nerses Shnorhalit, Grigor Tghajit, Frikit, Hovhanes Jerzankacit, Konstantin Jerzankacit, Hovhanes Tilkurancit, etj, të cilët e ngritën lirikën Armene në një shkallë akoma më të lartë.

Tradita popullore vazhdonte të ishte fuqishmisht e pranishme brenda këtyre veprave që i thurrnin lavde heronjve të mëdhenj të kohëve të shkuara. Në shekulli XI, Grigor Magistros Pahlavuni shkroi në vargje disa pjesë interesante mbi Artashesin (Artashesi Sunduesi i Botës - Արտաշէս Աշխարհաւարաւի). E zbukuron dhe e pasuron me elementë të rinj legjendën popullore “Viganët e Sasunit ose Shtëpia e Viganëve” (Մասնայ Ծոէր կաւ Ջոշաւց Տնւ)

Pjesën më të rëndësishme të folklorit popullore e formojnë përrallat, rekordin e të cilave në këtë gjini e paraprin zhvillimi i fabulave. Në këtë fushë bien në sy veçanërisht Mhitar Goshi dhe Vartan Ajgekci me përmbledhjet e fabulave “Libri i fabulave” dhe “Libri i dhelprës”, të cilët kishin një përdorim të madh në tekstet mësimore.

Qeverisja kombëtare u shndrrua në një nxitje të fuqishme për

zhvillimin e arkitekturës. Në shekujt IX - XIV u krijuan përmendore në krijimin e të cilave përsëriten figura të spikatura të qeverisjes Armene të shekujve të kaluar, duke vënë në dukje ose theksuar traditën e trashëgimisë kulturore Armene. Kjo bie në sy veçanërisht në strukturat e realizimeve arkitekturore në Anii (mauzoleu kryesor i Dertatit) dhe Aghtamar (Manui).

Ndërtohen një numër i madh manastiresh (Tatev, Sevan, Hackunk, Horromos, Gendevank, etj). Një kujdes i madh i kushtohet ndërtimit të fortesave.

Zhvillimi i artit të arkitekturës dhe ndërtimit i dha një shtysë të veçantë edhe zhvillimit të artit të skulpturës. U krijuan skulptura të veçanta me temë fetare dhe laike (në Aghtamar, Anii, etj). Një nga degët e kulturës natyrore Armene u shndrrua në një degë të veçantë të artit të skulpturës – arti i gurrkryqëve, i cili arriti një lulëzim të veçantë, duke dhënë kryevepra të nivelit botëror.

Në krah të skulpturës, në të njëjtën lartësi zhvillimi me të qëndron edhe arti i afreskeve murale. Të veçanta janë ato të vizatuara në muret e Aghtamarit, Aniit, Tatevit, etj.

Pikturat në miniaturë, një tjetër degë e spikatur e kulturës Armene, patën shekujt e tyre të artë. U themeluan disa shkolla të artit të pikturës në miniaturë brenda Armenisë dhe në Kiliki. Krijimet e Toros Roslinit dhe Sargis Picakit në Kiliki u kthyen në kryevepra të artit në miniaturë.

## KREU 23

# ARMENIA NGA SHEKULLI I XV DERI NË MESIN E SHEKULLIT TË XVII

Në vitin 1375, jetoi rënien e saj mbretëria e fundit Armene, ajo që ndodhej brenda Kilikisë. Pas rënies së mbretërisë Zakariane, në hapësirat e Malësive Armene erdhën duke u forcuar, fillimisht, zotërimet Mongole, pastaj ato Turke dhe Perse.

Fillimisht në vitin 1555 dhe pastaj për herë të dytë në vitin 1639, Armenia u nda ndërmjet Perandorisë Osmane dhe Persëve Safavidë. U krijua një situatë, kur jo vetëm që u pengua zhvillimi i kulturës Armene, por nga ana e qeverisjes Islame u nëpërkëmbën shpesh edhe të drejtat më elementare të popullsisë së krishterë.

Armenia ishte shndërruar në një skenë lufte ndërmjet Turqve dhe Persianëve, e cila gradualisht po e shkretonte vendin. Këto luftra u shoqëruan me çvendosje të dhunshme, nga të cilat më e madhja ishte ajo e vitit 1604, e organizuar nga Shah Abassi, gjatë së cilës nga Armenia Lindore u shpërngulën me dhunë (nga Karsi – në krahinën e Xhughës) rreth 300 000 Armenë dhe u dërguan në Persi; gjatë rrugës së përshkuar dhe veçanërisht brenda ujrave të lumit Araks humbën jetën me mijëra vetë. Sunduesit armiq përgjatë shekujve e dobësonin dhe e asgjësonin mësimin e gjuhës amtare, gjë që në fakt përbënte edhe synimin kryesor të tyre për të mbajtur sundimin. Asgjësimi gradual i familjeve princërore Armene i dha pasojat e veta; brenda Armenisë tashmë kishin mbetur si ishuj të veçuar vetëm disa principata gjysëm të pavarura.

## Përpjekjet për çlirimin e Armenisë nga jashtë saj

Siç është përmendur edhe më sipër, pas rënies së mbretërive Armene, për rreth 50 vjet princërit Armenë u përpoqën për ta rimëkëmbur atë brenda Kilikisë, por pa sukses.

Në vitin 1464, brenda Kishës së Kryqit të Shenjtë në Aghtamar, Simbat Arxruni-Sefetiniani u kurorëzua “Mbret i Armenëve”. Ndërkaq kjo mbretëri, e cila shtrihej në ishullin e Aghtamarit dhe në disa fshatra të hapësirës Arabe, nuk pati qëndrueshmëri dhe pas vitit 1471 nuk përmendet më. Në fakt, kjo ishte tentativa e fundit për të rimëkëmbur mbretërinë Armene, që gjithashtu dështoi.

Në kushtet e mungesës së një formacioni të organizuar shtetëror, flamurin e lëvizjes për çlirim kombëtar e ngriti Kisha. Ka dëshmi të shumta që vërtetojnë mbledhjet (Councils) e thirrura nga paria kishtarë dhe veprimtarinë e zhvilluar prej tyre, qëllimi i të cilave ka qenë të arrihej çlirimi i Armenisë me pjesëmarrjen e fuqive të mëdha të krishtera.

Në vitin 1547, Katolikosi Stepanos i V<sup>të</sup> Salmasteci thërret një mbledhje të fshehtë në Eçmiaxin, kushtuar çështjes së çlirimit të Armenisë. Delegacioni i kryesuar prej tij niset për në Europë në vitin 1548 dhe pas bisedimeve të gjata dhe të pasukseseshme, në vitin 1551, kthehet në Armeni.

Në vitin 1562, Katolikosi Mikaeli i I<sup>të</sup> Sebastaci thërret një mbledhje të fshehtë në Sebastia (Sivas). Vendoset të dërgohet një tjetër delegacion në Europë nën kryesinë e Abgar Jevtogiagit (Tohateci), bisedimet e të cilit me Republikën e Venedikut dhe Papën e Romës, përfundimisht nuk patën ndonjë rezultat pozitiv.

Në vitin 1575, mbërrin në Europë Katolikosi (աթոռաւիղց կաթողիկոսը) Armen, Tateosi, dhe bisedon me Papën e Romës, Dukatin e Venedikut dhe Mbretin e Polonisë. Po atë vit Katolikosi i Sisit, Khaçaturi i II<sup>të</sup> Zejtunci i drejtohet me një kërkesë për ndihmë Papës së Romës dhe pretendon t'i jepet ndihmë prej tyre. Në vitin 1584, Katolikosi pasardhës i Sisit, Azaria i I<sup>të</sup> Çuhajeci, i drejtohet



Librat e botuar nga Agop Mehaparti në Venecia (1512-1513)

përsëri Papës së Romës me kërkesë për ndihmë. Është interesant fakti, që në këtë periudhë bisedimesh, udhëheqësit Armenë kurrë nuk kanë pranuar kërkesën e Romës për unifikimin e kishës (kthimin e kishës Armene në katolike), e cila, sidoqoftë, nuk i dha asgjë çështjes së çlirimit të Armenisë.

Lëvizjet e pasuksesëshme në pjesën perëndimore përkohësisht e dobësuan lëvizjen Armene për çlirim. Ajo u gjallërua përsëri në mesin e shekullit XVII, që shpjegohet me luftën e filluar ndërmjet Republikës së Venedikut dhe Perandorisë Osmane (1645-1669), e cila i dha shtysë një lufte mbarë Europiane ndaj Turqve.

## Gjendja e Kulturës

Sundimi i huaj brutal që kishte zgjatur me shekuj krijoi një gjendje të padurueshme brenda Armenisë. Pati një rënie të përgjithshme të jetës kulturore. Në shekullin XV pushoi së vepruari edhe universiteti

i fundit Armen në Tatev. Kolosët e pakët të kulturës Armene tashmë gjendeshin jashtë saj. Së bashku me ta, në periudhën për të cilën bëhet fjalë, u krijuan edhe vlera të tjera kulturore të qëndrueshme.

Në vitin 1512, Agop Mehaparti, me mundime të mëdha arriti të vërë në punë një shtypshkronjë Armene brenda në Venedik. Libri i parë Armen i shtypur titullohej “Libri i së Premtes”. Pas vdekjes së Agop Mehapartit në vitin 1567, punën e shtypshkrimit Armen e vazhdoi Abgar Jevdokiaci (Tohateci) duke e çvendosur shtypshkronjën në Konstantinopojë. Në shekullin e XVII, u hapën shtypshkronja Armene edhe në Lvov, Livorno dhe në Xhughën e Re, ndërsa brenda tokës Armene (në Shën Eçmiadzin) u themelua e para shtypshkronjë vetëm në vitin 1771 me përpjekjet e Katolikosit të të Gjithë Armenëve, Simoni i Irë Jerevanci.

Në fushën e historisë, një rëndësi të madhe pati puna e Tovma Mexupecit (shekuli XV), ku përshkruhen shkatërrimet e fushatave të Timurlengut. Arakel Davrizheci (shekuli XVI - XVII) në faqet e librit të tij “Historia” tregon historinë e Armenisë të viteve 1602-1662). Në mesin e parë të shekullit të XVII shkrimi i historisë përfaqësohet me Grigor Daranacin (Kamaheci) me “Kronika”, dhe Zakaria Kanakerci me “Historia”.

Një nga dijetarët universalë të kohës së vet ishte Armeni me origjinë nga Konstantinopoja, Jeremia Kemirxhjan (shekulli XVII), punimet e të cilit përfshinin fushën e historisë, gramatikës, letërsisë, publicistikës, etj. Brenda Xhugës ishte bërë i njohur Simeon Çuhajeci (shekulli XVI - XVII), me veprat “Llogjika” dhe “Gramatika”.

Në fushën e letërsisë vazhdonte të botoheshin përmbledhjet e emërtuara “Vjersha” dhe “Libri i dhelprës”, të cilët përmbledhnin veprat më të mira të botës letrare. Në poezitë me tema mbi natyrën, dashurinë dhe bukurinë, realitetin dhe mërgimin, i njohur ishte Mëgërdic Nahashi (shekulli XV) dhe Grigor Aghtamarci (shekulli XVI). Poeti më i madh i dashurisë i të gjitha kohrave ka qenë poeti Nahapet Kucak (shekulli XVI).

Në shekujt XV - XVII shkruhen një sërë librash që përmbajnë

shënime rrugëtimi të udhëtarëve të ndryshëm, në sajë të të cilave në letërsinë Armene hyn zhanri i ri i quajtur “Libri i rrugëtimeve”.

Në mjekësi ishte i famshëm Amirtovlav Amasiaci (shekulli XV), i cili kishte arritur të bëhej mjeku personal i Sulltanit. Punimet e tij mjekësore janë shkruar në një gjuhë të thjeshtë, lehtësisht të kuptueshme nga populli i gjerë. Në fushën e veterinarisë një punë të rëndësishme ka kryer Abraham Kostantnupolseci (shekulli XVII).

Arritje të caktuara pati në fushën e pikturës në miniaturë dhe atë të qilimave. Mjeshtëria e gurëvekryq vazhdonte të zhvillohej pa ndërprerje. Ndërtoheshin monumente të reja arkitekturale, ndërmjet të cilave numrin më të madh e zinin kishat dhe urat. Shumë prej kishave rrethoheshin me mur mbrojtës rrethues. Arkitektët Armenë ndërtuan kryevepra edhe në vende të huaja...



PJESA E KATËRT

# KOHA E RE



## KREU 24

# LËVIZJA ÇLIRIMTARE ARMENE NGA MESI I SHEKULLIT XVII DERI NË FUNDIN E SHEKULLIT XVIII. KRIJIMI I ARMENISË LINDORE NË PJESËN RUSE

**Lëvizja çlirimtare Armene në gjysmën e dytë të shekullit XVII.**

Lufta e viteve 1645-1669 ndërmjet Republikës së Venedikut dhe Perandorisë Osmane zgjoi shpresat e Armenëve, Grekëve dhe Asorëve për çlirim. U hartuan programe, takime zyrtare ndërmjet veprimtarëve Armenë (Khaçatur Gahatiaci, Mahtesi Murat Bahisheci, Hoxha Arakel, Hovhanes Tutunxhi) dhe një sërë udhëheqësve të njohur të botës së krishterë. Ndërkohë Venediku u mund dhe këto programe nuk arritën të bëhen realitet.

Shpresat e Armenëve u ringjallën në vitet 1670 me krijimin e aleancës antiTurke, në të cilën bënin pjesë Austria, Polonia, Venediku dhe Rusia. Katolikosi i mbarë Armenëve, Agopi i IV Xhuhajeci, Katolikosi i Gandzasarit-Petros Hanckeci (emri i lindjes Hasan-Xhalalian) dhe tregtarët Armenë të Xhughës së Re ju drejtuan me një kërkesë për ndihmë Papës së Romës, perandorit të Austrisë dhe carit Rus Aleksej.

Agopi i IV Xhuhajeci në vitin 1677 thirri një mbledhje të fshehtë në Eçmiadzin, ku u mor vendimi, sipas të cilit delegacioni i kryesuar nga Katolikosi fillimisht shkoi në Gjeorgji në vitin 1679, pastaj në Konstantinopol ku vendosi lidhje me Papën e Romës dhe mbretin e

Polonisë, Jan Sobejskin. Ndërkaq, në Gusht të vitit 1680 Agopi i IV Xhuhajeci vdes, kurse anëtarët e tjerë të delegacionit kthehen në Armeni.

### Aktiviteti i Israel Oriit

Në fund të shekullit të XVII dhe në fillim të shekullit të XVIII, veprimtari më i shquar në çështjen për çlirimin e Armenisë ishte bërë Israel Orii (1658-1711), i cili programet e tij për çlirimin e Armenisë u përpoq t'i vinte në jetë me ndihmën princit të Westfalise, Johan Vilhelmit. Fillimisht u vendos që me fuqitë e princit të Westfalisë, Perandorisë Austriake dhe Dukatit të Toskanës, të ndërmerrej një fushatë drejt Armenisë. Pas dështimit të këtyre planeve, Oriin u nis për në Rusi dhe në vitin 1701 pati takim me Pjetrin e Iër të Madh. Me këtë, brenda lëvizjes për çlirimin e Armenisë, filloi orientimi proRus, i cili vazhdoi të thellohej në të ardhmen.

Israel Orii, i premtuan që, porsa të kishin përfunduar luftën në veri me Suedinë, Pjetri i Iër do të merrej me çështjen e çlirimit të Armenisë. Pas kësaj u vendos që ndërkohë një delegacion me në krye Oriin të nisej për në Iran, me qëllim, që t'i sqaronte për situatën që mbizotëronte në Armeni. Në vitet 1708-1711, Orii zhvilloi një aktivitet të dendur në Iran dhe krijoi lidhje të forta me veprimtarë Armenë të njohur të asaj kohe. Ndërkohë, në vitin 1711, ai vdes papritur brenda Astrakanit. Punën e tij e vazhdoi ndihmësi dhe bashkërrugëtar i tij, Minas Vardapet Tigraniani.



Israel Orii



Hovsep Arkhutian



Shahamir Shahamirjan

### Beteja çlirimtare e viteve 1722-1730 në Arcah dhe Sjunik

Në vitin 1722, Afganët ngritën krye kundër sundimit Iranian dhe pushtuan kryeqytetin e tyre Isfahanin dhe i prenë kokën Shahut Husein. I ndihmuar nga këto rrethana, Pjetri i I<sup>rë</sup> po atë vit filloi një fushatë kundër Iranit. Me perspektivë për t'ju bashkuar ushtrisë ruse, mbreti Gjeorgjian Vahtangu i VI<sup>të</sup> me 30 000 trupa dhe Katolikosi i Gandzasarit, Jesai – Hasan Xhalalian, me 12 000 trupa u bashkuan pranë Gandzasarit në vendin e quajtur Çolak. Ndërkaq, në Nëntor (dy muaj më pas) erdhi lajmi, që Pjetri i I<sup>rë</sup> e kishte pushuar fushatën e Kaspikut dhe ishte kthyer në Astrakan. Ushtria Gjeorgjiane u kthye në Gjeorgji ndërsa ushtria Armene në Arcah.

Ushtria Armene, e kthyer në Arcah, e shpalli atë principatë të pavarur. Koka dhe shpirti i lëvizjes çlirimtare ishte Katolikosi Jesai – Hasan Xhalalian, kurse kryekomandant i përgjithshëm i ushtrisë ishte Avan Harjurapeti.

Në vitin 1722 ngritën krye edhe Armenët e Sjunikut, luftën e të cilëve e organizoi dhe e udhëhoqi gjenerali Armen i ushtrisë Gjeorgjiane, Davit Bek. Me Davit Bekun në krye, brenda Sjunikut u krijua principata e pavarur Armene, qendra e të cilës ishte fortesa e Halicorit. Në vitin 1728, pas vdekjes së Davit Bekut, udhëheqës i principatës u bë Mhitar Sparapeti. Pas vrasjes së tij në vitin 1730, principata jetoj rënien e saj.

Si në Arcah, ashtu edhe në Sjunik, kishin varur shpresa të mëdha tek Rusia, duke pritur përgjatë gjithë kohës së luftës dhe duke besuar në fjalën e dhënë për ndihmë. Ndërkaq, në realitet, qeveria Ruse kishte nënshkruar një traktat të fshehtë armëpushimi me Turqinë në vitin 1724, nëpërmjet të cilës krahinat përfaqësojnë Kaspikut do t'i kalonin Rusisë, kurse krahinat që ndodheshin në perëndim të tyre i kalonin Perandorisë Osmane, përfshirë Arcahun dhe Sjunikun.

Të çudit fakti që, duke vendosur shpresën në premtimet Ruse për ndihmë dhe duke ndenjur 9 vjet në pritje të kotë për këtë ndihmë, Arcahu dhe Sjuniku, që deri atëkohë ishin plotësisht të pavarur, nuk shpallën mbretërinë e pavarur Armene...

## Beteja çlirimtare Armene në gjysmën e dytë të shekullit të XVIII

Në gjysmën e dytë të shekullit të XVIII, një nga qendrat e mendimit liridashës Armen ishte kolonia Armeno-Indiane, një nga përfaqësuesit më të shquar të së cilës ishte Hovsep Jemini. Ai, në vitin 1751, duke u rrënjosur në Britaninë e Madhe, arriti të krijojë lidhje me rrethet drejtuese të Kristianizmit. Çështjen e çlirimit të Armenisë ai ja parashtrroi fillimisht kryeministrit të Britanisë së Madhe, William Pitti, dhe më pas kryeministrit Rus, Voroncovit, gjatë takimeve që pati me ta.

Hovsep Jemini fillimisht parashtrroi idenë e krijimit të një shteti të bashkuar Armeno-Gjeorgjian nën protektoratin e Rusisë, të cilin duhej ta udhëhiqte mbreti Gjeorgjian Herakliu i II<sup>të</sup>. Jemini i forcoi lidhjet me një sërë veprimtarësh Armenë, nga të cilët më i gatshmi për bashkëpunim u ndodh Episkopi Hovnan, paraardhësi i kryemurgut të manastirit të Shën Mushit. Ndërkaq, Katolikosi i mbarë Armenëve nuk e dha pëlqimin e tij për veprimtarinë e Jeminit, duke e konsideruar këtë si një aventurë.

Pas dështimit të planeve të tij, Hovsep Jemini kthehet në Indi, ku, në fillim të viteve 1770, fillon bashkëpunimin me grupin e lëvizjes çlirimtare të krijuar nga Shahamir Shahamirjan, brenda në Madras.

Në vitin 1771, bërthama e grupit politik të krijuar brenda në Madras përbëhej nga pasaniku i madh, Shahamir Shahamirjan, djemtë e tij, Agopi dhe Jegiazari, Armenologu Moisi Bagramiani, pasaniku tjetër i madh Grigor Hoxhaxhaniani dhe të tjerë. Shahamir Shahamirjani kishte krijuar lidhje të forta me princërit e Arcahut, me katolikosët e Eçmiadzinit dhe Gandzasarit, me mbretërit Gjeorgjianë, Herakliu i III<sup>të</sup> dhe Kevorku i XII<sup>të</sup>.

Në vitin 1772 në Madras u krijua shtypshkronja Armene, ku u shtypën një sërë veprash që predikonin idetë çlirimtare. Libri i Moisi Bagramianit, “Revistë e re, shprehje e zërit të ri”, fillimisht në mënyrë të përmbledhur paraqiste historinë e Armenisë, pastaj shtronte përpara lexuesve programin për çlirimin e Armenisë. Një tjetër botim i rëndësishëm i grupit ishte libri “Kurthi i lëvdatave”, ku paraqitej skica e

kontureve kufitare të Armenisë së ardhme. Ajo parashikonte që shteti i pavarur Armen duhej të ishte një Republikë Parlamentare.

Në të njëjtën periudhë kohore, programe për çlirimin e Armenisë parashtronin edhe veprimtarët Armeno-Rusë (Moisi Sarafian, Hovsep Arkipeshkopi Arkhutian, Hovhanes Lazarian, etj.), të cilët ishin të frymëzuar veçanërisht nga programi i perandoreshës Ekaterina e II<sup>të</sup> për të çliruar Armeninë dhe për të ringritur mbretërinë Armene nën protektoratin Rus, program ky që në fakt nuk u bë realitet.

### **Pushtimi i Armenisë Lindore nga ana e Rosisë**

Pushtimi i Armenisë Lindore nga ana e Rosisë ndodhi brenda 30 vjeçarit të parë të shekullit të XIX.

Në vitin 1801, krahas me Gjeorgjinë Lindore, nën Rusinë kaluan edhe Khazahu, Lori-Pambaku dhe Shamshadini. Kurse në vitin 1804-1813 dhe 1826-1828 në vijim të luftërave Ruso-Persiane, të gjitha krahinat Armene që shtriheshin në veri të lumit Araks, nga Persia i kaluan Rosisë. Në vitin 1828, prej ish zotërimeve khanatore të Jerevanit dhe Nahicëvanit si edhe hapësirave të Ordubadit (Ortupatit) u krijua Marzi Armen i Perandorisë Ruse, jetëgjatësia e të cilit ishte vetëm 12 vjet (1828-1840).

Në vitet 1828-1829, si pasojë e luftës Ruso-Turke, Rosisë i kaluan nga hapësirat Armene vetëm krahinat e Akhalchajit dhe Akhalkalakit (ndonëse Rusët kishin pushtuar një pjesë të konsiderueshme të Armenisë Perëndimore).

Në vitet 1826-1828 dhe 1828-1829, pas luftërave Ruso-Persiane, ndërmjet krahinave Armene që ndodheshin në Persi dhe atyre të Armenisë Perëndimore që ishin nën zotërimin Rus ndodhi një zhvendosje e madhe Armenësh prej afro 120 000-125 000 vetësh, e cila e ndryshoi në një masë të madhe panoramën e shpërndarjes së popullsisë. Brenda Armenisë Lindore u krijua një zonë me popullsi shumë të dendur, ku në të ardhmen do të ringrihej shteti Armen.

Në vitet 1877-1878, pas luftës Ruso-Turke dhe Kongresit të Berlinit, Ruisë i kaluan Karsi, Ardahani (Artahani), dhe Batumi. Me dy qytetet e parë dhe krahinat përreth u krijua Marzi i Karsit, të cilin më vonë e rimorën Turqit.

## ÇËSHËTJA ARMENE DHE LUFTA ÇLIRIMTARE ARMENE NË VITET 1878-1914

### **Lufta Ruso-Turke e viteve 1877-1878. Ndërkombëtarizimi i çështjes Armene**

Duke marrë shkas nga shpërthimi i lëvizjeve çlirimtare në gadishullin Ballkanik kundër Turqisë në vitet 1875-1876, Rusia i shpalli luftë Perandorisë Osmane në 12 Prill 1877.

Lufta zgjati më pak se një vit; Turqia u mund. Më 19 Shkurt të vitit 1878, në Manastirin e Shën Stefanit (pranë Kostantinopolit) u nënshkrua marrëveshja e paqes, sipas së cilës, në pjesën Kaukaziane, Ruisë i bashkëngjiteshin krahinat e Karsit, Ardahanit, Batumit, Alashkertit dhe Bajaziti. Pjesa Armene e mbetur nën Turqinë do të trajtohej sipas pikave 16, 21, 25 dhe 27 të traktatit të Shën Stefanit, sipas të cilave parashikohej që brenda Armenisë Perëndimore “të kryheshin reforma dhe të garantohej mirëtrajtimi dhe siguria e popullsisë Armene nga Kurdët dhe Çerkezët”.

Parashikohej që ushtria Ruse të dilte nga Armenia Perëndimore pas 6 muajsh, me kusht që Turqit të respektonin kryerjen e reformave sipas marrëveshjes.

Me traktatin e Shën Stefanit u forcuan pozitat Ruse në Lindjen e Afërme, gjë e cila nuk përkonte me interesat e fuqive të mëdha perëndimore, kështu që këto të fundit (veçanërisht Britania e madhe dhe Austro-Hungaria) duke kërcënuar me luftë, kërkuan thirrjen e një



Serob Ahpjur



Hrajr Tzhkohk



Kevork Shavush

kongresi të fuqive të mëdha dhe të rishikonin kushtet e marrëveshjes. Kongresi u mbledh më 1 Qershor deri më 1 korrik 1878 në Berlin.

Duke u informuar për kongresin, Armenët e perëndimit krijuan një delegacion me në krye Babain (Arkipeshkopin) Hrimjan (Mëgërdiç Hrimjan - Մկրտիչ Արքեպսոպ. Խրիմեան - Mkrtych Khrimian), i cili shkoi në Romë, Paris, Londër dhe Petërburg, megjithatë nuk ju dha e drejta për të marrë pjesë në Kongresin e Berlinit.

Në Berlin, Traktatit të Shën Stefanit ju bënë ndryshime: pika 16 që kishte lidhje me çështjen Armene u zëvendësua me pikën 61, ku emri “Armeni” u zëvendësua me shprehjen “provinca të banuara nga Armenët”; rusët duhej t’u kthenin Turqisë krahinat e Alashkertit dhe Bajazitit (pika 60); Kongresi vendosi gjithashtu që reformat të realizoheshin jo nën mbikqyrjen dhe me praninë e forcave ushtarake Ruse, por e atyre të Fuqive të Mëdha. Realisht, e drejta e zgjidhjes së çështjes Armene i kaloi Fuqive të Mëdha, brenda të cilave interesat për përfitime ishin dukshëm mjaft kontradiktore. Duke përfituar prej kësaj, qeveria e Sulltanit mundi që, në të ardhmen jo vetëm të mos i zbatonte reformat, por edhe në mënyrë të herëpashërëshme të realizonte masakra ndaj Armenëve.

I zhgënjyer nga vendimet e Kongresit të Berlinit, në predikimin e mbajtur pas kthimit në Konstantinopol, Babai Hrimjan (Խրիմեան

Հայրիկը) i këshilloi Armenët që të mbanin “Qepshe të Hekurt”, që do të thoshte, që u bënte thirrje Armenëve t’i drejtoheshin luftës së armatosur, duke u mbështetur vetëm në forcat e veta (sipas shembullit të Zejtunëve dhe Sasuncëve trima).

### **Krijimi i grupeve për çlirim kombëtar dhe i partive politike Armene**

Për të vendosur luftën çlirimtare brenda një kornize të organizuar, në dhjetëvjeçarët e fundit të shekullit të XIX, brenda realitetit Armen filluan të krijoheshin në fshehtësi grupe, organizata dhe parti.

Të njohur ishin: “Shoqëria e Dashamirëve” (Aleksandropol, 1869, - sot Gymri), “Bashkim dhe Shpëtim” (Van, 1872), “Dhoma e dashamirëve të Atdheut” (Harakiri, 1874 – sot Vanadzor), “Kryqi i Zi” (Van, 1878), “Mbrojtësi i Atdheut” (Karin, 1878), “Bashkimi i Atdhetarëve” (Moskë, 1881), etj. Veprimtaria e këtyre grupeve politike, në mesin e viteve 1880, kaloi në bashkime më të mëdha organizative, në formën e partive kombëtare politike.

Në vitin 1885, brenda Vanit, nën kryesinë e Mëgërdis Avedisjanit (Terlemezjan) u krijua Partia Armene, e cila e mori këtë emër nga revista “Arminia” që shtypej në Marsejë të Francës nga Mëgërdis Portugaljan.

Në vitin 1887, Avetis Nazarbekjani, Maro Vardaniani, Ruben Hanazati dhe të tjerë, themeluan brenda Gjenevës Partinë e Këmbanave, emër që e kishte bazën në emrin e revistës së shtypur prej tyre, “Këmbana”.

Në vitin 1890, brenda Tiflisit (Tbilisi i sotëm), nën kryesinë e Kristofor Mikaeljanit, Simon Zavarjanit, Rrostomit (Stepan Zorjani) dhe të tjerë, u krijua Partia e Bashkimit Revolucionar Armen. Revista e këtij bashkimi titullohej “Flamuri”

Të tre partitë, që në ditët e para të krijimit të tyre, u futën në betejën për çlirimin e Armenisë Perëndimore, me forma propagandistike dhe organizative, me qëllim që të armatosnin banorët e Armenisë Perëndimore me një program të qartë veprimi.

## Lëvizja Fedaiste (guerile)

Në kundërpërgjigje të rregjimit shtypës Osman në vitet 1880 filloi një lëvizje guerile (e quajtur Fedaiste) e cila vazhdoi deri në vitin 1908 me Revolucionin e Turqve të Rinj. Historia e lëvizjes është e rëndësishme të ndahet në dy etapa: etapa e parë ishte ajo e lëvizjes spontane, kur veprimtaria e grupeve ishte e paorganizuar dhe e veçuar, pra nuk kishte një natyrë të organizuar. Kjo ishte një lëvizje për vetëmbrojtje, pa një program politik. Udhëheqësit më të shquar të këyre grupeve të kesaj faze ishin: Arabo (Արաբոն), Tersimi Kerrin (Տերսիմի Բերին), Miho Shahen (Միսո Շահէն) (Սասուն Սուշ), Agop Sarkavaz (Հակոբ Սարկավազ) (Խնու-Կարին), Minas Ohlin (Մինաս Օղլին) (Երզնկա-Մերասդիս).

Faza e dytë ka të bëjë me zhvillimin e partive politike Armene, të cilat (Hënçagerët-Këmbanorët dhe veçanërisht Dashnakët – Revolucionarët) morën drejtimin politik të luftës. Emrat më të shquar të kesaj faze të luftës guerile ishin: Serob Ahpjur (Սերոբ Աղբիւր), Hrajr Tzhkoghk (Հրայր Դժոխք), Kevork Çavush (Գևորգ Չավուշ), Sebastaci Murat (Սեբաստացի Սուրաստր), Andranik Ozanian (Անդրանիկ Օզանեան), etj.

Çetat guerilase luajtën një rol të rëndësishëm në vetëmbrojtjen e popullsisë Armeno-perëndimore, veçanërisht në periudhën e masakrave të vitit 1894-1896.

Pas revolucionit të Turqve të Rinj në vitin 1908 veprimtaria e çetave guerile pushoi, pasi qeveritarët e rinj prematuan të bëjnë transformime të thella me karakter popullor si edhe do të ndërmerrnin reforma që do të përmirësonin kushtet e jetesës së popullit. Duke i besuar Turqve të rinj, guerilasit (Fedainjtë) në qetësi ju kthyen aktivitetit krijues prodhues, por duke u ndjerë të zhgënjyer, në vitin 1914, përsëri rrëmbyen armët, duke u përfshirë në çetat vullnetare Armene.

Vlera më e madhe e lëvizjes guerilase qëndron në shpëtimin e disa mijëra Armenëve nga jataganët Turq dhe zgjimi i shpirtit liridashës Armen.

## Lëvizjet çlirimtare dhe çështja Armene në vitet 1894 -1896

Pas vitit 1878, për vite me rradhë Lëvizja Armene ishte lënë në mëshirën e fatit. Partitë politike Armene vendosën të ndërmarrin veprime, të cilat do t'i detyronin Fuqitë e Mëdha t'i kushtonin vëmendje kësaj çështje, dhe ta detyronin Sulltanin të mbante premtimet e dhëna lidhur me reformat.

Të tilla veprime ishin demonstratat paqësore të organizuara në Konstantinopol (në vitet 1890 dhe 1895), kryengritja e Sasunit e vitit 1894 dhe ajo e Zejtunit në vitet 1895-1896, marshimi i grupit të Sargis Kukanianit drejt Armenisë Perëndimore (1890), pushtimi i Bankës Otomane brenda në Konstantinopojë nga ana e grupit të revolucionarëve në vitin 1896, etj.

Më së fundmi, Fuqitë e Mëdha vendosen të ndërhyjnë dhe nëpërmjet ambasadorëve të tyre në Konstantinopol, me 11 Maj 1895, i paraqitën Sulltan Hamitit të II<sup>të</sup> programin e reformave, sipas të cilit, reforma duhej të zbatohet brenda 6 vilajeteve të Perandorisë Osmane, të cilat përfshinin pjesën më të madhe të Armenisë Perëndimore.

Këtë program reformash Sulltani e nënshkroi në Tetor të vitit 1895. Ndërkaq, në vend të reformave të premtuara, në vitet 1895-1896 u krye masakrimi i rreth 300 000 Armenëve dhe ndoshta po kaq Armenë ju nënshtruan emigrimit të detyruar. Si pasojë, numri i popullsisë Armene, që banonte brenda kufijve të Perandorisë Osmane, zbriti nga 3 milion banorë në 2,5 milion.

Vetëm grupe të vogla Armenësh arritën t'i shpëtojnë masakrimin duke organizuar luftën vetëmbrojtëse (në Van, Malati, Urfa, etj) dhe falë ndihmës së çetave guerile (të çetave të Fedajve).

## Armenia Lindore në fillim të shekullit XX

Armenët kishin varur shpresa të mëdha tek Rusët, shpresa këto që nuk u justifikuan, pasi sundimtarët Rusë ndiqnin po atë politikë kolonialiste ndaj Armenëve, si edhe ndaj popujve të tjerë të shtypur.

Për të shpërbërë Armenët, për t'i larguar ata nga rrënjët e tyre kombëtare, nga ana e qeveritarëve caristë ishin bërë disa përpjekje për të mbyllur shkollat Armene. Ndër këto tentativa, më e spikatura ishte ajo e 12 Qershorit 1903, ku Car Nikolla i II<sup>të</sup> me anë të një dekreti urdhëronte sekuestrimin e pasurive dhe pronave të kishës. Kjo nënkuptonte mbylljen e shkollave, pasi shkollat mbaheshin me mjetet e kishës.

Kundër këtij vendimi të paligjshëm u ngrit i gjithë populli Armen me në krye Katolikosin e MbarëArmenëve, Mëgërđiçi i Irë Hrimjani. U zhvilluan demonstrata të mëdha dhe veprimtari kundërshtuese, të cilat shpesh degradonin në përplasje të armatosura me policinë dhe ushtrinë.

Të detyruar nga kjo qëndresë e ashpër e Armenëve, qeveritarët caristë, në Gusht 1905, me një dekret (հրովարան) të veçantë shpallën anulimin e dekretit të datës 12 Qershor 1903. Kishës Armene ju rikthyen pronat, u anulua mbyllja e shkollave Armene.

Një tjetër veprim i qëllimshëm antiArmen i ndërmarrë nga qeveria Ruse ishte provokimi i trazirave të dhunshme ndërmjet Armenëve dhe Tatarëve që filluan në Shkurtin e vitit 1905 dhe vazhduan deri në Shtator 1906. Gjatë këtyre trazirave Armenët përsuan humbje të rënda njerëzore dhe materiale.

Drejtimin e lëvizjes Armene për vetëmbrojtje e mori në dorë Partia Revolucionare (Dashnakët), anëtarët e së cilës i ndëshkuan me vdekje zyrtarët e qeverisë cariste, që ishin përgjegjësit kryesorë për këto trazira.

## **Armenia Perëndimore në fillim të shekullit XX**

Masakrat e viteve 1894-1896 nuk mundën ta mposhtin shpirtin e Armenëve të perëndimit. Në vitin 1899 qeveria Turke, nëpërmjet tradhtisë, organizoi vrasjen e udhëheqësit të Lëvizjes Fedaiste, Serob Ahpjurit; ndërkaq në kundërpërgjigje të vrasjes së tij, Kevork Shavushi dhe Antranik Ozaniani organizuan hakmarrjen duke i prerë kokën komandantit të çetës Kurde, Bashar Halilit, që kishte kryer këtë akt, dhe më pas me luftëtarët e tyre, në Nëntor 1901, i dhanë fund me sukses grindjes në Manastirin Apostolik.

Me qëllim që të asgjësonte Sasunin, ku ishin edhe kokat kryesore të lëvizjes çlirimtare Armene, qeveria Turke, në vitet 1902-1903, përqëndroi forca të mëdha përqark Sasunit. Armenët u ngritën në kryengritje. Pavarësisht luftimeve heroike të popullit të Sasunit, qeveria Turke, në vitin 1904, arriti ta shtypë kryengritjen e Sasunit duke e mbytur në gjak.

Partia e Turqve të Rinj “Bashkim dhe Progres” e armatosur me mjete revolucionare, në Korrik të vitit 1908, erdhi në fuqi duke deklaruar se do të ndërtonte një shtet me ligje demokratike. Armenët e pritën me entuziazëm lajmin për këtë ndryshim revolucionar, duke varur shpresa të mëdha në të. Por e ardhmja do të rezervonte përsëri një zhgënjim të madh për ta.

Në Prill të vitit 1909, në vilajetet e Kilikisë dhe Alepos, në zonat e banuara nga Armenët u krye një tjetër masakër e madhe, që pati si rezultat asgjësimin e më shumë se 30 000 Armenëve; fajin për këtë, Turqit e Rinj ja vunë tentativës së dështuar të Sulltan Abdyl Hamitit të II<sup>të</sup> për të rimarrë pushtetin.

Por, edhe pas kësaj, fati i Armenëve Perëndimore nuk ndryshoi. Në vitet 1912-1914 rifilluan diskutimet për çështjen Armene, të lidhura këto edhe me luftërat Ballkanike të viteve 1912-1913 kundër Turqve, që përfunduan me humbje nga ana e Turqisë. Diskutimi i çështjes u shtrua kryesisht ndërmjet Gjermanisë dhe Ruisë, dy aleatëve të vjetër të Perandorisë Osmane, e cila doli me disa përfundime dhe Turqisë ju propozua një program i ri reformash. Me 26 Janar 1914, ndërmjet Ruisë dhe Perandorisë Osmane u nënshkrua një marrëveshje, me anë të së cilës të 7 vilajetet e Armenisë Perëndimore ndaheshin në dy provinca të mëdha; brenda njëres prej tyre përfshiheshin Vani, Baheshi (Bitlisi), Kharperti (Mamuret-ul-Asisi) dhe Tigranakerti (Diarbekiri); në tjetrën përfshiheshin Karini (Erzurumi), Sebastia (Sivasi) dhe Trabizoni. Të dy këto pjesë do të drejtoheshin nga administratorë Europeanë; kandidatët për këto pozicione do të përzgjidheshin nga Fuqitë e Mëdha, kurse Sulltani kishte të drejtën e aprovimit. Armenët, ashtu si edhe gjithë qytetarët e tjerë do gëzonin të drejtën e mobilizimit në ushtri, ndërsa

çetat Hamidiane Turke do të shndërroheshin në forca rezerviste. Edukimi arsimor kombëtar do të bazohej mbi sistemin e taksave të mbledhura në nivel kombëtar.

Në pranverën e vitit 1914, si guvernatorë të përgjithshëm u emëruan: Holandezi L. Vestenenku (me vendqëndrim në Karin) dhe Norvegjezi N. Hof (me vendqëndrim në Van). Guvernatorët ishin bërë gati të fillonin detyrën e tyre, kur filloi lufta e parë botërore. Turqit e Rinj, duke përfituar nga kushtet që u krijuan prej fillimit të luftës, vendosën të vënë në zbatim programin e parashikuar qeveritar për shfarosjen e Armenëve.

## KREU 26

# GENOCIDI ARMEN (1894-1923)

Perandoria Osmane në fillim të shekullit të XIX ishte në rrugën e dobësimit dhe rënies së saj. Duke e ditur këtë, një grup i caktuar veprimtarësh Turq, për ta shpëtuar zotërimin e tyre nga shkatërrimi, dolën me një ideologji të re. Sipas tyre rëndësi primare kishte panOsmanizmi (mbarëOsmanizmi), sipas të cilës të gjithë qytetarët e perandorisë duhet të kishin të drejta të barabarta, të gjithë duhet të konsideroheshin si një popull i vetëm, si popull Osman. Në fakt, ky ishte një program për të shkrirë me mjete paqësore të gjithë popujt në një, një program turqizimi, i cili për shkak të pamundësisë për t'u realizuar praktikisht, gradualisht doli jashtë kornizave të tij.

Sulltan Abdyl Hamiti i II<sup>te</sup>, me rastin e 33-vjetorit të sundimit të tij (1876-1909), e ktheu në ideologji zyrtare mbarëIslamizimin (panIslamizmin), i cili predikonte bashkimin e të gjithë botës Islamike brenda një shteti të vetëm, bërthama e të cilit duhej të ishte Perandoria Osmane. Në realitet, qëllimi i tij ishte që ta kthente energjinë e brendshme të botës Islamike në favor të Shtetit Osman.

Me përmbysjen e Sulltanit dhe ardhjen në fuqi të Turqve të Rinj, këta të fundit teorinë zyrtare PanIslamike e kthyen në teori panTurke (mbarëTurke), me një program sipas të cilit të gjithë Turqishtfolësit duhej të bashkoheshin në një shtet të vetëm, program ky që ishte shfaqur që në shekullin e XIX. Duke qenë një doktrinë nacionaliste dhe fisnore, realizimi i panTurqizmit duhej të kalonte nëpër rrugën

e asgjësimit të popujve të tjerë. Realizimi i kësaj ideologjie ishte parashikuar të kalonte nëpër tre faza: Faza e parë ishte ajo e shndërrimit të Perandorisë Osmane në shtetin Turk; në këtë mënyrë bëhej e mundur që të gjithë njerëzit që banonin brenda kufijve të Perandorisë Osmane të merrnin shtetësinë Turke ose të asgjësoheshin; faza e dytë parashikonte bashkimin e të gjithë banorëve me origjinë lindjeje Turke (kombësi Turke), të cilët ndodheshin në Perandorinë Osmane, Kaukaz, Persi dhe Azinë e Mesme, në një një shtet të vetëm (brenda Oguzistanit); etapa e tretë parashikonte krijimin e Turanit të Madh, shtetit të bashkuar të të gjithë njerëzve turqishtfolës.

Viktima e parë e fazës së parë të këtij programi, e realizimit të mbarëTurqizimit apo asgjësimit, u bë populli i Armenisë Perëndimore.

### **Programi i asgjësimit të Armenëve**

Politika e përndjekjes së Armenëve, e ndjekur për vite me rradhë nga Turqia Osmane për asgjësimin dhe shpërnguljen me forcë të Armenëve, u rigjallërua dukshëm në fund të shekullit të XIX dhe në fillim të shekullit të XX. Të gjitha këto bëheshin mbi bazën e një programi dhe organizimi të hartuar paraprakisht nga qeveria, gjë kjo, e cila nga pikëpamja e së drejtës ndërkombëtare cilësohet Genocid.

Më 9 Dhjetor 1948, Organizata e Kombeve të Bashkuara mori në shqyrtim konkluzionet e analizës me përmbajtje “Për veprimtari Genocidale dhe ndëshkimin e saj”, në të cilën Genocidi (shfarosje racore) konsiderohej veprimtari kriminale ndaj njerëzimit, i cili nuk njihet kufij kohorë.

Në vitin 1878, pas ndërkombëtarizimit të çështjes Armene, Turqit vendosën ta përshpejtojnë politikën e shpërbërjes së Armenëve. U përpunua politika e zgjidhjes “Turke” të çështjes Armene nëpërmjet asgjësimit fizik, të cilat ishin vënë në zbatim që në vitin 1891 me krijimin e çetave Kurde, me grupe kalorësie të financuara nga qeveria, të cilat në momentin e krijimit, u quajtën me emrin “Hamidej” nga Sulltani Abdyl Hamidi i II<sup>të</sup>.



Shkrimtarë Armene, viktimat e Gjenocidit: Grigor Zohrab, Daniel Varuzhan, Siamanto dhe Ruben Sevak

Siç është përmendur edhe më parë, në vitet 1894-1896, ju nënshtruan asgjësimit më tepër se 300 000 Armenë, dhe ndoshta po kaq ju nënshtruan emigrimit të detyruar. Në Prill të vitit 1909, në krahinën e Kilikisë dhe Alepos u krye masakrimi i rreth 30 000 Armenëve, në dy etapa.

Turqit e Rinj shpallën të drejta të barabarta për të gjithë kombet, ndërkohë në fshehtësi po përgatishnin plane për asgjësimin e popullsisë Armene. Një program i tillë u përpunua brenda në Selanik në vitin 1911 në një mbledhje të fshehtë të Turqve të Rinj. Lufta e Parë Botërore i krijoi mundësinë Turqve të Rinj të vinin në zbatim programin e tyre të shfarosjes së Armenëve.

### Realizimi i Genocidit Armen

Në vjeshtën e vitit 1914, nëpërmjet thirrjes për mobilizim të përgjithshëm ushtarak, u dërguan në ushtri rreth 300 000 të rinj Armenë, duke treguar bindje civile. Në fund të vitit 1915 filloi çarmatosja e ushtarakëve Armenë dhe asgjësimi fizik i tyre.

Në 24 Prill 1915, brenda në Konstantinopojë, filloi arrestimi i inteligjencës, i veprimtarëve shpirtërorë, publikë dhe politikë Armeno-perëndimorë, dhe më pas syrgjynosja dhe asgjësimi i tyre. Përgjithësisht në total (unúwúþ) u arrestuan mbi 800 figura të njohura të inteligjencës Armene, të cilët më pas u torturuan dhe u asgjësuan gjatë së ashtuquajturës syrgjynosje. Prej tyre vetëm ndonjë tek tuk arriti të shpëtonte.



Xixernakaberd. Memoriali kryesor i viktimave të gjenocidit në Jerevan

Pas kësaj filloi etapa e syrgjynosjes dhe asgjësimit në masë e shoqëruar kjo me një ashpërsi të paprecedentë në histori. Përgjatë disa muajve pothuajse e gjithë popullsia Armeno-Perëndimore e Armenisë dhe Azisë së Vogël u shpërngul me dhunë dhe u asgjësua. Rreth 800 000 Armenë vdiqën nga uria në rrugëtimin e mundimshëm të syrgjynosjes, shumica u asgjësua në shkretëtirat e Mesopotamisë. Për t'i shpëtuar vdekjes së sigurtë, shumë vetë ishin të detyruar të mohonin përkatësinë e tyre etnike dhe fetare; sipas të dhënave të sigurta, islamizimit të detyruar ju nënshtruan mbi 200 000 Armenë (kryesisht gra dhe fëmijë të vegjël).

Brenda shkretëtirave Arabe, arritën të shpëtojnë disa të mbijetuar, të gjetur dhe të shpëtuar falë mirësisë së Arabëve.

Vetëm gjatë viteve 1915-1916 u asgjësuan më tepër se 1,5 milion Armenë duke arritur kështu kulmin e të ashtuquajturit Asgjësim Armen dhe duke hyrë në histori si “Masakra e Madhe” ose “Gjenocidi Armen” (në gjuhën Armene njihet si “Մեծ Եղեռն – Mex Jegherrn”).

Përveç humbjeve të pakthyeshme njerëzore, Armenët pësuan edhe humbje kolosale materiale. U vodhën dhe u shkatërruan me mijëra vlera historike dhe kulturore, kisha Armene dhe manastire, shkolla dhe vepra të tjera. U sekuestrua e gjithë pasuria e tundshme dhe e patundshme Armene, e cila sipas fakteve të paraqitura në Kongresin e Parisit të vitit 1919 shkonte në 15 miliard Franka Franceze. U mohuan trashëgimitë bankare të Armenëve. Krahinat e boshatisura nga Armenët detyrimisht u populluan me popullsi islame.

Politika genocidale e Turqve vazhdoi edhe në vitet në vijim. Në muajt e parë të vitit 1918, në kohën e fushatave të Turqve brenda Armenisë Lindore, u bënë pre e jataganëve të tyre rreth 500 000 Armenë. Po atë politikë ndoqën edhe Qemalistët në vitet 1920-1923, fillimisht me fushatën kundër Republikës së Armenisë në vjeshtën e vitit 1920, dhe më pas në Kiliki, Izmir dhe Pontos, ku asgjësimi ju nënshtruan Grekët dhe Armenët.

Përgjithësisht në total, gjatë viteve 1894-1923, numri i viktimave Armene të Genocidit Turk shkoi në 2,5-3 milion vetë. Me qindra mijë Armenë ju nënshtruan shpërnguljes dhe emigrimit të detyrueshëm nëpër botë. Armenët u privuan nga pjesa më e madhe e Atdheut të tyre, ku për mijëra vjet me rradhë ishin krijuar vlera të larta qytetërimi.

Në Historinë Botërore, Genocidi Armen konsiderohet si i pari Genocid i kryer, dhe ndoshta një nga krimet më të mëdha të kryera ndaj njerëzimit, i cili duhet të njihet dhe të marrë pjesën e vlerësimit që i takon, pavarësisht kohës që i përket.

### **Gjyqi i organizatorëve të Genocidit**

Në vitin 1919 gjyqi ushtarak Turk dënoi me vdekje një sërë drejtuesish partiakë dhe qeveritarë nga radhët e Turqve të Rinj, që u njohën fajtorë për dy faje të rënda: futjen e Turqisë në luftë dhe shfarrosjen e banorëve Armenë të Perandorisë Osmane. Ndërkaq qeveria Turke nuk i vuri në zbatim vendimet e gjyqit, me përjashtim të dy përgjegjësve të dorës së dytë rrethanorë.

Ndëshkimin e drejtuesve Turq e morën përsipër hakmarrësit Armenë (Solomon Delirjani, Misak Torlakjani, Arshavir Shirakjani, Aram Jerkaniani, Stepan Xahikjani dhe të tjerë), të cilët në vitet 1920-1922 i ndëshkuan me vdekje përgjegjësit kryesorë të Genocidit (Talat Pashën, Enver Pashën, Xhemal Pashën dhe Said Halim Pashën, si edhe Behadedin Shakir, Xhemal Azmi, etj). E kryesuar nga Shahan Natali dhe e emërtuar “Nemesis”, ky grup i krijuar në këto rrethana, dënuan dhe zbatuan dënimin me vdekje edhe për Fatali Han-Hojskin dhe Behbut Han Xhanshir për kanibalizmat e kryera në krahinën e Azerbajxhanit dhe Arcahut. Ndërkaq përgjegjësi kryesor për Genocidin, qeveria Turke, deri më sot qëndron e pandëshkuar dhe vazhdon politikën e Genocidit, duke shkatërruar në vazhdimësi vlerat e kulturës Armene.

## FRONTI KAUKAZIAN NË LUFTËN E PARË BOTËRORE. BETEJAT VETËMBROJTËSE TË POPULLIT ARMEN GJATË VITIT 1915

### **Fronti Kaukazian në Luftën e Parë Botërore**

Në 1 Gusht të vitit 1914 filloi Lufta e Parë Botërore. Dy grupet e mëdha politiko-luftarake, Aleanca (Antanta – ku bënin pjesë Rusia, Britania dhe Franca, në vitin 1917 edhe SHBA) dhe Treshja (në vitin 1915 ishte Katërshja) (ku bënin pjesë Gjermania, Austro-Hungaria, Turqia dhe Bullgaria) kishin shtruar për zgjidhje çështjen e rindarjes së botës. Me Armeninë lidheshin llogaritë që bënin Rusia dhe Perandoria Osmane.

Konturi i vijës së frontit Kaukazian që shtrihej nga Deti i Zi deri në liqenin e Urmias, rreth 720 km. i gjatë, kalonte mospërmas Armenisë. Në këtë vijë fronti Turqia kishte përqëndruar rreth 300 000 ushtarë, kurse Rusia një ushtri të përbërë nga 200 000 vetë. Veprimet ushtarake në këtë zonë filluan në Tetor 1914.

Armenët vazhdonin të ushqenin shpresa të mëdha tek Rusët dhe tek aleatët e saj. Në ushtrinë Ruse ishin thirrur nën armë rreth 200 000 Armenë, ndërsa në ushtritë e vendeve të tjera aleate me të rreth 50 000 Armenë.

Disa muaj pas fillimit të luftës, filluan luftimet edhe në frontin Kaukazian. Në Tetor 1914 dhe Janarin e vitit 1915, në krahinën e Sarikamishit u zhvilluan betejat të ashpra, të cilat përfunduan me një

disfatë të thellë të Turqve. Nga ushtria Turke e përbërë prej 90 000 vetësh vdiqën në fushën e betejës 78 000 vetë, ndërsa nga ushtria Ruse e përbërë prej 60 000 vetësh vdiqën në fushën e betejës 20 000 vetë.

Në muajt e parë ushtria Ruse përparoi me sukses, duke i nxjerrë Turqit jashtë nga hapësirat Perse, pastaj në verën e vitit 1915 i shtyu edhe nga krahinat e Vanit, Shadahut, Arxheshit, Bashkaleja, Manazkertit dhe krahina të tjera. Në verë Turqit arritën ta frenojnë sulmin dhe të kalojnë në kundërsulm. Ndërkohë, ushtria Ruse, e kompletuar, në ditët e para të vitit 1916, kaloi në një sulm të madh dhe në Janar pushtoi qendrën kryesore të Armenisë Perëndimore, Erzurumin, kurse në Prill, Trabizonin.

Por ndërkohë, në frontin perëndimor, ushtria Ruse po pësonte humbje. Turqit ishin mjaft të rraskapitur, kështu që në Maj të vitit 1917, në frontin e Kaukazit, u nënshkrua një marrëveshje armëpushimi e përkohshme. Revolucioni bolshevik i Tetorit 1917 krijoi rrethana të reja. Në 5 dhjetor të vitit 1917, në Erzurum, nëpërmjet komandantëve të të dy ushtrive, u nënshkrua marrëveshja e pushimit të luftës ndërmjet Ruisë dhe Turqisë.

### **Lëvizja vullnetare Armene**

Menjëherë pas fillimit të luftës u krijuan çetat e vullnetarëve Armenë, për formimin e të cilave u kujdes Byroja Kombëtare Armene e Tiflisit. Për çlirimin e Armenisë Perëndimore mbërritën vullnetarë edhe nga jashtë shtetit, madje edhe nga SHBA.

Fillimisht u organizuan katër çeta me vullnetarë, nga të cilat e para udhëhiqej nga Antranik Ozanian, e dyta nga Drastamat Kanajan, e treta nga Hamazasp Srovancjan, e katërta nga Kerri (Arshak Kavafian). Më pas u formuan edhe tre çeta të tjera; çetën e pestë e udhëhiqte Vartani (Sarkis Mehrabian), të gjashtën Arshak Çanpoladian, pastaj Grigor Arshavian dhe pas vdekjes së tij Hajk Pezhishkian (që më pas, në periudhën sovjetike u bë i njohur si komandanti ushtarak, gjenerali Kaj). Komandant i çetës së shtatë ishte Hovsep Arhutian.



a) Antranik Ozaniani me bashkëlufëtaret e tij; b) Hamazasp Servancian (ulur), Kerri (Arshak Kavafian), dhe Vartani (Sarkis Mehrabian)

Nga këto, më e madhja ishte çeta e Antranik Ozanianit. Totali i përgjithshëm i këtyre çetave ishte rreth 10 000 vetë.

Në Prill të vitit 1915 me vendim të Byrosë Kombëtare, çeta e II<sup>të</sup>, III<sup>të</sup> dhe e IV<sup>të</sup> bashkohen me çetën e V<sup>të</sup> dhe formojnë grupimin e quajtur “çeta e Araratit” (nën komandën e komandantit të çetës së V<sup>të</sup> - Vartanit).

Në përbërje të ushtrisë Ruse, vullnetarët Armenë morën pjesë në çlirimin e një pjese të madhe të Armenisë Perëndimore. Ndërkaq sundimtarët caristë, duke pasur frikë se në të ardhmen këto çeta vullnetarësh do të mund të shndërroheshin në ushtri kombëtare Armene, në verën e vitit 1916 vendosën t’i shkrijnë ato. Me luftëtarët e këtyre çetave u formua batalioni i V<sup>të</sup> i qitësve, i cili hyri në përbërje të ushtrisë Ruse.

### Betejat vetëmbrojtëse të Armenëve të vitit 1915

Në fillim të luftës, Armeno-Perëndimorët shfaqën bindje civile; në ushtrinë Osmane u mobilizuan meshkujt e moshës 18-45 vjeçare. Turqit ju përveshën punës për realizimin e programit të hartuar vite më parë për asgjësimin e tyre, fillimisht për asgjësimin e meshkujve të thirrur nën armë në ushtri. Në këtë mashtrim me pasoja të

menjëhershme, Turqit në pjesën më të madhe nuk hasën në ndonjë rezistencë të madhe, dhe ishte vetëm në disa vende të veçura, që Armenët arritën të organizojnë një luftë vetëmbrojtëse.

Në një sërë vendbanimesh brenda Vanit, në verën e vitit 1915, aktet e dhunës u shndrruan në një masakër të vërtetë, e cila u krye nën drejtimin e vetë guvernatorit të Vanit, Xhevdet beut. Rreth lagjeve të banuara nga Armenët ai kishte përqendruar rreth 12 000 forca ushtarake, të cilave ju bashkuan edhe turmat e banditëve Turq dhe Kurdë. Brenda Vanit, Armenët ishin përqendruar në lagjet Ajkestan dhe Kahakamesh duke pasur gjithsej 1500 pushkë dhe kobure. Udhëheqës i trupës ushtarake Armene të Ajkestanit ishte Armenak Jegariani, kurse në Kahakamesh ishte Hajgak Kosoiani. Një rol të rëndësishëm kishte Aram Manukiani. Vetëmbrojtja filloi më 7 Prill 1915 dhe zgjati deri më 6 Maj 1915, kur erdhën në ndihmë forcat vullnetare Armene dhe ushtria Ruse. Më 7 Maj u arrit çlirimi i përkohshëm i Vaspurakanit; guvernator u emërua Aram Manukiani.

Me fitore përfunduan edhe betejat e tjera vetëmbrojtëse të zhvilluara në zona të tjera të provincës së Vanit (në Shatah, nga 1 Prilli deri më 14 Maj; në Gavash, nga 3 Prilli deri më 11 Maj; në Pesandast, 14 Prilli deri më 10 Maj; etj.). Brenda Vaspurakanit shpëtuan rreth 200 000 Armenë nga masakrat Turke. Një qëndresë heroike i bënë Turqve banorët e Sasunit nëpërmjet betejave të zhvilluara nga Marsi i vitit 1915 deri në Gusht 1915. Kur u mbaruan ushqimet dhe municionet, të detyruar, Armenët u futën nëpër pyje dhe hypën nëpër male duke filluar një luftë partizane, falë së cilës rreth 15 000 Armenë i shpëtuan asgjësimit.

Në korrik 1915 filloi vetëmbrojtja e Mushit, të cilën e udhëhiqte Hagop Kotojani. Nga luftëtarët Armenë vetëm një pjesë arritën të çajnë rrethimin Turk dhe të bashkohen me vetëmbrojtësit e Sasunit. Hagop Kotojani luftoi deri në fund dhe me fishekun e fundit kreu vetëvrasje. Turqit i asgjësuan të gjithë banorët e zënë rob në qytet.

Në Janar 1916, ushtria Ruse hyri në Mush, dhe ata pak vetë,

banorë të Mushit dhe Sasunit, që vazhdonin të luftonin nëpër malet e Taronit, arritën të shpëtojnë nga masakra.

Një qëndresë të veçantë heroike i bënë masakruesve Turq Armenët e Shabin Karahisarit (3-29 Qershor 1915), të cilët nën udhëheqjen e Hugas Dovletianit përforcuan një kala të vjetër gjysëm të rrënuar që ndodhej në afërsi. Pas luftimeve heroike, kur mbaruan municionet, ushqimet dhe uji, një pjesë e luftëtarëve arritën të çajjnë rrethimin Turk dhe ikën nëpër male ku vazhdoi lufta edhe për një kohë të gjatë. Ndërsa banorët e pafuqishëm, që nuk patën mundësi të largohen nga fortesa, u therrën nga Turqit.

Një nga momentet më kulmore e domethënëse të luftës vetëmbrojtëse të Armenëve në vitin 1915, është pa dyshim beteja heroike në malin Musa (Musa Dag). Një pjesë e madhe e banorëve Armenë të rrethinave të provincës së quajtur Sueti (Սուլտանի), që ndodhet në veri-lindje të Detit Mesdhe, rreth 4 000 banorë, vendosën të mos i nënshtroheshin urdhërit për t'u dorëzuar, u ngjitën në malin Musa dhe organizuan vetëmbrojtjen. Më 1 Gusht, Turqit filluan sulmin mbi mbrojtjen Armene, por u tërhoqën duke pësuar humbje. Në majë të malit, banorët ngulën dy flamurë; mbi flamurin e bardhë kishin qendisur me pe të kuq një kryq të madh dhe një mbishkrim "Të krishterët ndodhen në rrezik". Në 5 Shtator, malit Musa ju afrua anija luftarake e flotës Franceze "Kishën", e cila i dërgoi komandës së Aleancës informacionin për Armenët e rrethuar. Më 12 Shtator, luftanijet Franceze dhe Britanike ju afruan brigjeve të Suetisë (Սուլտանի) dhe hypën mbi to më tepër se 4 000 banorët e mbetur të rrethuar në malin Musa, për t'i zbritur më pas në portin Egjiptian të Port Said (Փոքր Սուլիս). Një pjesë e tyre, më pas u rikthyen në zonën Armene. Madje edhe sot, një nga fshatrat e malit Musa, Vakëfi, është plotësisht i banuar nga Armenët, natyrisht nën qeverisjen Turke.

Nga Shtatori deri në Tetor të vitit 1915 një qëndresë heroike bënë edhe Armenët e Jetesit (Urfa). Ata, nën kryesinë e Mëgërdiç Jotnehpajranit, i shtynë shpesh herë mbrapsht sulmet e ushtarëve

Turq. Turqit e rrafshuan pothuajse plotësisht lagjen me anë të gjyleve të topave. Rreth 15 000 Armenë të mbetur gjallë u syrgjynosën në shkretëtirat e Der Zorit.

Beteja vetëmbrojtjeje u zhvilluan edhe në krahina të tjera, falë të cilave shumë mijëra Armene arritën t'i shpëtojnë Genocidit.

## REVOLUCIONET RUSE TË VITIT 1917 DHE ARMENIA. SHPALLJA E REPUBLIKËS ARMENE

### **Revolucioni Rus i Shkurtit 1917 dhe Armenia**

Në kushtet e rënduara të Luftës së Parë Botërore, në Shkurt 1917, në Rusi ndodhi një revolucion, i cili përmbysi rendin monarkik dhe shpalli Republikën Demokratiko-Borgjeze. U krijua Qeveria e Përkohshme me në krye princin Gjergj Lvovi, e cila duhej të qeveriste vendin deri në mbledhjen e Asamblesë Kushtetuese.

Qeveria e Përkohshme, në Marsin e vitit 1917 e shkriu mbretërinë e Kaukazit, duke krijuar në vend të saj Komitetin e Posaçëm NdërKaukazian (Ozagum). Fillimet e të ashtuquajturit Revolucion Demokratik, ngjallën entuziazëm në popullsinë Armene të Kaukazit. Në Maj të vitit 1917, brenda Jerevanit, Kongresi i parë i Armeno-Perëndimorëve zgjodhi Këshillin Kombëtar Armeno-Perëndimor (kryetar-Vahan Papazian, ndërsa drejtues i grupit të armatosur-Antranik Ozanian). Në shtator, në Tiflis u mbledh Kongresi i Armeno-Lindorëve, i cili zgjodhi Këshillin Kombëtar Armeno-Lindor me në krye Avetis Aharonian. Brenda në Baku u krijua Këshilli Kombëtar Armen (drejtues-Abraham Kylhantanian). Të gjithë këto Këshilla rregullonin jetën e brendshme të Armenëve dhe luajtën një rol të rëndësishëm. Qeveria e Përkohshme i kushtoi një vëmendje të veçantë çështjes së krahinave të çliruara të Armenisë Perëndimore, drejtimin e të cilave



Përkujtimore e betejave heroike të Sardarapatit

e mori direkt nën kujdestarinë e saj. Komisar i Jashtëzakonshëm për Armeninë Perëndimore u vendos gjenerali Pjotr Averianovi, guvernator-Hagop Zavriani.

Hapësirat e çliruara u ndanë në tre zona: Karini (Erzurumi), Vani dhe Khnusi. U organizua rikthimi i të shpërngulurve apo emigrantëve në vendlindjet e tyre (deri në Dhjetor 1917 u rikthyen rreth 387 000 Armenë).

### **Revolucioni Rus i Tetorit 1917 dhe Armenia**

Krejt i papritur ishte Revolucioni Rus i Tetorit 1917 i udhëhequr nga Vladimir Lenini, pasi Partia Puntore Social-Demokrate e udhëhequr prej tij (më vonë Partia bolshevike, komuniste) deri më atëherë nuk kishte ndonjë influencë të madhe. U përmbys Qeveria e përkohshme dhe filloi lufta civile.

Ashtu si edhe në një pjesë të Ruisë, Qeveria bolshevike nuk u pranua as në Kaukaz. Deri në rivendosjen e rendit qeverisë, forcat

politike NdërKaukaziane, më 15 Nëntor krijuan një trup të ri qeverisë, Komisaratin NdërKaukazin, të përbërë prej 12 komisarësh, nga të cilët tre ishin me origjinë Armene.

Në situatën e krijuar, kur Turqia kishte pësuar humbje, ndërsa në Rusi mbizotëronte një situatë e turbullt, më 5 Dhjetor 1917 në Jerzngaj (Erzinkan - Erzinjan) u nënshkrua armëpushimi, nëpërmjet të cilit parashikohej pushimi i veprimeve luftarake në frontin e Kaukazit.

Qeveria Bolshevike, më 29 Dhjetor 1917 nxorri një deklaratë “Për Armeninë Turke”, nëpërmjet të cilit shpallte njohjen e të drejtës për vetvendosje të popullit Armeno-Perëndimor deri në pavarësi të plotë. Ndërkaq deklarata parashikonte gjithashtu tërheqjen e menjëhershme të trupave Ruse nga Armenia Perëndimore dhe në vend të tyre parashikohej krijimi i milicisë vendase me banorë Armenë në përbërje të saj. Kjo donte të thoshte lëshim i hapësirave të çliruara Armene në dorë të Turqve, pasi ishte e qartë, që pas përjetimit të atij Genocidi mizor dhe në kushtet e një lufte që praktikisht akoma nuk kishte pushuar, popullsia Armene e mbetur nuk do të ishte në gjendje të mund të krijonte një ushtri të madhe.

Me thirrjen e Qeverisë Bolshevike, në të gjitha vijat e frontit rus filloi dezertimi dhe largimi në masë i ushtarëve Rusë, gjë që e vuri përballë një rreziku serioz jo vetëm atdheun e Armenëve-Perëndimorë, por edhe atë të Armenëve-Lindorë.

### **Fushata Turke e vitit 1918 dhe betejat heroike të Majit 1918**

Të ndihmuar nga largimi i trupave Ruse nga fronti i Kaukazit dhe duke e shkelur marrëveshjen e armëpushimit të Jerzngaj (Erzinkan - Erzinjan), më 30 Janar 1918, Turqit kaluan në sulm në frontin e Kaukazit.

Përgjatë një muaj luftimesh Turqit arritën të pushtojnë Jerzngajin (Erzinkan - Erzinjan), Papertin, Mamahatin, dhe qendrën kryesore të Armenisë-Perëndimore, Karinin (Erzurumin). Në 22 Mars ra edhe qyteti i Vanit. Turqit depërtuan në Armeninë Lindore.

Qeveria Bolshevike Ruse, nëpërmjet traktatit të Brest-Litovskit të nënshkruar më 3 Mars 1918, i lëshonte Turqisë jo vetëm Armeninë-Perëndimore, por edhe provincën e Karsit (u njoh kufiri që kishin pasur deri sa filloi lufta e vitit 1877-1878).

Këshilli NdërKaukazian refuzoi ta njihte Traktatin e Brest-Litovskit dhe filloi bisedimet me Turqit, brenda në Trabizon. Ndërkaq Turqit i ndërprejnë bisedimet dhe vazhduan veprimet luftarake.

Me aprovimin e Turqve, më 22 Prill 1918, NdërKaukazi u shpall Republikë e pavarur, kryeministër i së cilës u bë Akaki Shenkeliin (nga 13 ministritë 4 i morën Armenët). Duke pasur pozicionet kyç në qeveri, Gjeorgjianët me ndërmjetësinë e qeverisë gjermane, arritën një marrëveshje të fshehtë me Turqit, sipas së cilës ata lejonin që Turqit të merrnin Karsin duke ju lënë atyre në këmbim Batumin. Për shkak të kësaj intrige, më 25 Prill 1918 Karsi i kaloi Turqve pa kurrfarë rezistence.

Bisedimet e ndërprera në Trabizon rifilluan më 11 Maj 1918 në Batum, ku Turqit parashtuan kërkesa akoma më të rënda. Ata kërkuan që Krahina e Akhalkalakit dhe Akhalcajit, si edhe një pjesë e konsiderueshme e provincës së Jerevanit t'i kalonin atyre. Ndërkohë që bisedimet vazhdonin, Turqit duke e shkelur armëpushimin, më datë 15 Maj filluan luftimet, morën Aleksandropolin (Gymri) dhe morën rrugën drejt Jerevanit. Më 21 Maj ata pushtuan stacionin hekurudhor të Sardarapatit; deri në Jerevan kishin mbetur gjithsej edhe 30 km.

Në këtë situatë dramatike, tërë përgjegjësinë e mori mbi vete një grup njerëzish të devotshëm e mendjendritur i përbërë nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Jerevanit, Aram Manukian, komandanti i grupit luftarak të Jerevanit, gjenerali Movses Silikian, komandanti i betejës së Karakilisit, gjenerali Tovmas Nazarbegian, komandanti i betejës së Sardarapatit, Daniel Beg-Pirumian, komandanti i betejës së Pash Abaranit, gjenerali Trasdamat Ganajan, etj.

Shumë i rëndësishëm dhe mobilizues ishte qëndrimi i Katolikosit të MbarëArmenëve, Kevorkut të II<sup>te</sup> Surenaci (1912-1930); ai refuzoi

propozimin për t'u larguar nga Eçmiadzini dhe qëndroi përkrah luftëtarëve. Në Sardarapat ra në sy entuziazmi i madh shpirtëror i Armenologut të njohur Armen, Karekin Episkopos Hovsepanit, i cili më pas do të emërohej Katolikos i Shtëpisë së Madhe të Kilikisë (1945-1952).

Në 22-26 Maj të vitit 1918 luftëtarët Armenë korrën një fitore të shkëlqyer në betejën e Sardarapatit, gjë që i ngriti moralisht luftëtarët e Bash Aparanit, të cilët në betejat e zhvilluara më 24-29 Maj i shpartalluan Turqit. Jerevani dhe Eçmiadzini ishin shpëtuar; po planifikohej që nga vija e luftimeve të Karakilisit (Vanadzorit) të kalohej në kundërsulm në të gjithë vijën e frontit. Ndërkohë, për fat të keq, rezervat Armene në municione luftarake kishin mbaruar, dhe të detyruar nga kjo situatë, ata u tërhoqën nga Karakilisi (Vanadzori) drejt Dilixhanit, kurse Turqit, pasi hynë në Karakilis, lëvizën drejt Tiflisit. Plani i kundërsulmit dështoi.

Betejat heroike të Majit, jo vetëm që e shpëtuan popullsinë Armeno- Lindore nga asgjësimi Genocidal, por vunë bazat për ringritjen e shtetit Armen.

### **Rimëkëmbja e Pavarësisë së Armenisë**

Brenda vendeve TransKaukaziane, kontradiktat kombëtare sa vinin e bëheshin më të mprehta, gjë që bënte të pashpresë zgjidhjen e problemit të një shteti TransKaukazian. Më 27 Maj, Tatarët shpallën shtetin e tyre, duke e quajtur atë "Azerbejxhan", ndonëse ai praktikisht nuk kishte kurrfarë lidhjeje me Azerbaixhanin historik.

Më 28 Maj 1918 u shpall pavarësia e Armenisë. Ndërmjet të tjerave, brenda Deklaratës së Pavarësisë, Këshilli Kombëtar Armen i Tiflisit e deklaroi veten "Autoriteti i Vetëm dhe Fuqiplotë i provincave Armene".

Më 4 Qershor 1918 ndërmjet Republikës së Armenisë dhe Perandorisë Osmane u nënshkrua Traktati i Paqes, brenda në Batum, nëpërmjet së cilës kufijtë e Armenisë ngushtoheshin shumë (gjithsej jo më shumë se 10 000 – 12 000 km. katror hapësirë). Paqja ishte e

domosdoshme, pasi ishte e vetmja mundësi për t'u rimëkëmbur pas Genocidit dhe shkatërtimeve që la pas lufta, ishte e vetmja mënyrë për të zgjidhur problemin e qindra mijëra refugjatëve dhe jetimëve, që kishin gjetur shpëtim në atë hapësirë që u quajt Republika e Armenisë.

Kështu, më 28 Maj 1918 u ringrit shteti Armen, që kishte pushuar së funksionuari në shekullin e XIV, me të cilin fillon një etapë e re në historinë e Armenisë, epoka e Republikës së Armenisë.

## KULTURA ARMENE NGA SHEKULLI XVIII DERI NË FILLIM TË SHEKULLIT XX

Në shekujt XVIII - XIX kultura Armene vazhdoi të zhvillohej, veçanërisht brenda vendngulimeve Armene. Bashkimi i Armenisë Lindore me Rusinë krijoi disa kushte të caktuara të favorshme për zhvillimin ekonomik dhe kulturor të saj.

Në fushën e arsimit u vërejt përparim. U hapën një numër i madh institucionesh arsimore, nga të cilat më të njohurat ishin shkollat e Venedikut, Konstantinopojës, Eçmiadzinit dhe e manastirit të Zjumrrnit, shkolla Ahapapjan e Astrahanit (1810), Seminari Lazarian i Moskës (1815), Shkolla Nersisjane e Tiflisit (1824), shkolla dioqeziane e Jerevanit dhe Shushisë (1837 dhe 1838), Seminari Skutarian i Konstantinopolit (1838), Seminari Gjeorgjian i Eçmiadzinit (1874), shkolla pedagogjike e Vanit (1878), etj. Në gjysmën e dytë të shekullit të XIX u hapën gjithashtu një sërë shkollash për femrat Armene (Shushi, Jerevan, Tiflis, Akhalchaj dhe Aleksandropol).

Ngjarje e rëndësishme ishte ardhja e shtypit periodik në Jerevan. Në vitin 1794, brenda në Madras, prifti Harutiun Shmavonian filloi shtypjen e të parit botim periodik "Monitor". Numri i botimeve periodike përgjatë shekujve XIX dhe XX u rrit në mënyrë të konsiderueshme.

## Armenologjia

Në fushën e Armenologjisë një moment i rëndësishëm ishte unifikimi i institucioneve të krijuara nga Mhitar Sebastaci në Konstantinopojë në vitin 1701 dhe i atyre të krijuara në ishullin e Shën L Lazarit në Venedik në vitin 1717, të cilën Vatikani e njohu si “Akademia Armene”. Ky unitet i krijuar nën patronazhin e Papës së Romës u njoh me emrin “Mhitarian” dhe po me këtë emër vazhdon edhe sot veprimtarinë patriotike dhe atë në fushën arsimore e kulturore.

Në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit të XVIII përfaqësuesit e letërsisë historike ishin Stepanos Shahumiani (“Historia e David Beut”), Katolikosi Jesai Hasan-Xhalalian (“Histori e shkurtër e krahinës së Ahvankut”) dhe Abraham Kretaci (“Historia e luftrave Turko-Perse”).

*(Ahvanku – Alvanku - Albania e Kaukazit – Shënim i imi)*

Mhitariani Mikael Vrt. Çamiçjani, në vitin 1780 botoi veprën monumentale me tre volume “Historia e Armenisë”, duke dhënë një nga paraqitjet më të shkëlqyera të historisë Armene deri në kohën që ai jetoi. Ai me të drejtë mund të konsiderohet si Babai i historisë së re Armene.

Në vitet 1836-1837 pa dritën e botimit fjalori në dy vëllime “Fjalori i ri i gjuhës Armene”, i cili ishte frut i punës së përbashkët afro 50 vjeçare të Armenëve Mhitarianë dhe që e ruan vlerën e tij shkencore akoma edhe sot.

Një punë të madhe kreu edhe H. Hugas Vrt. Inxhixhian në fushën e studimeve historike dhe gjeografike Armenologjike. E njohur është edhe vepra në dy vëllime “Historia Botërore” e H. Hovsep Vrt. Katrinxhiani.

Ndër Armenët Mhitarianë, dijetari më prodhimtar mbahet Kevont Vrt. Alishani; ai është autor i më tepër së 40 veprave kushtuar historisë, gjeografisë dhe memuarëve (kujtimeve), të cilat sot përbëjnë një vlerë të madhe shkencore.

Kryevepra studimore në tre vëllime e Makakia Ark. Ormanianit “Historia e Kombit” (botuar më 1912 dhe 1914 në Konstantinopolis dhe

1927 në Jeruzalem), përfaqëson një ndërthurje të historisë së kombit Armen dhe Kishës Armene.

Në Seminarin Lazarian të Moskës një meritë të madhe pati Mëgërdiç Jemini; ai jo vetëm që botoi studime shkencore Armenistike me vlerë, por përktheu në gjuhën Ruse dhe Franceze një sërë veprash të autorëve Armenë.

Garegin Eps. Servandjaci u shndrrua në themeluesin e shkollës folklorike Armene; ishte ai, që për herë të parë botoi përmbledhjen me legjendat e kreshnikëve “Մասիսի Ծնէք - Kreshnikët e Sasunit” ose e emërtuar ndryshe (“Ջոզուղ Տնւ - Shtëpia e Kreshnikëve).

Një dobi të madhe në zhvillimin e Armenologjisë patën studimet e Kerovp Badgarian, Grigor Halatian, Anton Karakashian, Aleksandër Jerician dhe të tjerë. Në periudhën për të cilën bëhet fjalë, një ndikim shumë të madh patën Leon, Nikolajos Atonci, Hrashja Axhariani, Manuk Apekiani dhe të tjerë, vlera e vërtetë e veprimtarisë të të cilëve doli në dritë vetëm pas viteve 1918.

## Letërsia

Periudha që po shqyrtohet (shekujt XVIII - XIX) është periudha më prodhimtare për letërsinë Armene. Në shekullin e XVIII jetonin e punonin Baltasar Tibir, Petros Kapanc dhe mjeshtri i paarritshëm i rapsodisë popullore Armene, Sajat Nova (Harutiun Sajatian). Në



Sajat Nova



Hovhanes Tumanian



Komitas

shekullin e XIX kemi krijimet e Harutiun Alamtarian dhe Mesrop Takiatian.

Në gjysmën e parë të shekullit të XIX, Khaçatur Abovian vuri bazat e gjuhës së shkruar moderne dhe të letërsisë së re Armene. Kryevepra e tij është romani historik “Plaga e Armenisë, dhimbja e Patriotit”.

Në gjysmën e dytë të shekullit të XIX dhe në njëzetvjeçarim e parë të shekullit të XX u dallua një yjësi e tërë e ndritshme letrarësh si: Mikael Nalbandian, Rafael Badganian, Raffi, Muracan, Mëgërdiç Beshiktashian, Hagop Baronian, Gabriel Sundukian, Arpiar Arpiarian, Hovhanes Tumanian, Petros Turian, Misak Mexarenc, Hovhanes Hovhanesian, Daniel Varuzhan, Siamanto, Grigor Zohrabi, Jervant Odjan, Arshak Çobanian, Avedis Aharonian, Kazaros Ahajan, Berxh Broshian, Aleksander Shirvanzade, Vahan Derian, Jegishe Zarenc, Avedik Isahakian etj. Kryeveprat e krijuara prej tyre jo vetëm që e pasuruan thesarin e letërsisë, por zënë një vend të nderuar edhe në letërsinë botërore.

## Arti

Në fushën e krijimtarisë muzikore një vend të rëndësishëm zë Hamparc Limonxhian, i cili në vitet 1813-1815 krijoi notat Armene, duke shfrytëzuar emërtimet e notave muzikore të lëna në mëshirën e fatit nga harresa. Njëpërmjet tyre morën rrugën e shkrimit dhe shpëtuan nga harresa vlera të rëndësishme.

Një nga figurat më gjennale dhe të papërsëritshme të artit muzikor dhe kompozimit është Komitas (Solomon Solomonian), i cili përpara vitit 1915 kishte mbledhur dhe, duke i pastruar nga elementët e huaj kishte përpunuar rreth 3 000 këngë. Ai arriti të dëshifrojë edhe nota Armene të fshehura nga harresa të Mesjetës së vonë.

Një kontribut të rëndësishëm patën edhe Kristofor Kara-Murza dhe Makar Jekmalian.

Autor i operës së parë Armene (“Arshaku i II<sup>të</sup>”) ishte Tigran Çuhaxhian. Aleksandër Sbentarian themeloi artin e simfonisë Armene (operën “Almast”), kurse Armen Tigraniani shkroi operan “Anujsh” (bazuar në poemën me të njëjtin emër të Hovhanes Tumanianit), shfaqja e parë e të cilit u dha në vitin 1912 në Aleksandropol.

Popullaritet të madh vazhdonte të gëzonte edhe rapsodia, ku ndër figurat më të spikatura ishin Çivan dhe Sheram.

Udhëtarë nga vende të ndryshme që kanë kaluar nëpër Armeni në shekujt XVII - XVIII kanë qenë dëshmitarë okularë të teatrove popullore, të cilët e kanë origjinën që në kohët e hershme. Në shekullin e XIX teatro të specializuar kishte në Konstantinopol dhe Tiflis. Në zhvillimin e artit teatral një rol të rëndësishëm luajtën aktorët Petros Atamian, Kevork Çamishkian, Siranushi, Hovhanes Apelian, etj.

Në fushën e pikturës, në shekullin e XIX, u bënë të famshëm Hagop dhe Akaton Hovnatanian. Po atë shekull jetoi dhe krijoi edhe piktori me famë botërore me origjinë Armene, Hovhanes Ajvazovski (Ajvazian, 1817-1900), i cili krahas temave të detit trajtoi në pikturën e tij edhe tema Armene. Në fund të shekullit të XIX dhe në fillim të shekullit XX, në artet e bukura Armene, ndër figurat e shquara ishin edhe Panos Terlemezian, Vartkes Surenian, Kevork Pashinçagian, etj.

Arkitektura dhe skulptura Armene vazhdoi të zhvillohej brenda kornizave të saj tradicionale vetëm se në përmasa më të vogla (jo më me kisha të mëdha, por me kisha të vogla të ashtuquajtura “kapela”, gurrkryqe, gurë varresh, etj).

Në fillim të shekullit XX figurat më të shquara të arkitekturës Armene ishin Gabriel Ter Melikov, Kristofor Ter Sarkisov, Hovhanes Kaçaznun, Aleksandër Tamanian, etj. Studjues i palodhur i artit të arkitekturës ishte edhe Toros Toramian.

Përfaqësuesi më i shquar Armen në fushën e shkencave natyrore ishte Hovhanes Atamian, i cili ishte një largpamës i madh dhe autor i shumë shpikjeve të ndryshme.

Genocidi Armen i shkaktoi dëme të pakthyeshme kulturës Armene. U asgjësuan një numër i madh krijuesish, u asgjësuan me mijëra monumente historiko-arkitekturore, dorëshkrime të lashta si edhe vlera të tjera.

## KREU 30

# REPUBLIKA E ARMENISË [1918 – 1920]

**Rilindja e shtetit Armen. Gjendja e brendshme e Republikës së Armenisë**

Në vitin 1918 u ringrit shteti Armen. Asgjë nuk ishte ruajtur nga organizimi shtetëror i periudhës mesjetare, kështu që çdo gjë duhej nisur nga pika zero. Duhej krijuar një lloj i ri organizimi shtetëror – Republika.

Këshilli Kombëtar Armen dhe antarët e qeverisë së posakrijuar të Republikës së Armenisë gjendeshin në Tiflis, që tashmë ishte shndërruar në kryeqytetin e Republikës së Gjeorgjisë. Përderisa ata të mund të çvendoseshin në Jerevan, udhëheqjen e vendit e mori përsipër Këshilli Kombëtar Armen i Jerevanit, në krye të së cilës ishte Aram Manukian. Nuk është e rastit, që pikërisht Aram Manukianit i takoi të ishte themeluesi i Republikës së Armenisë.

Kryeministër i parë i Republikës së Armenisë u zgjodh Hovhanes Kaçaznuni, kurse Aram Manukiani u emërua Ministër i Punëve të Brendshme.

Më 1 Gusht 1918 filloi nga puna trupa më e lartë shtetërore ligjëvënëse, Këshilli Legjislativ i Armenisë (Kuvendi, Parlamenti), i cili përbëhej nga anëtarë të Këshillave Kombëtare Armene të Tiflisit dhe Jerevanit. Në Qershorin e vitit 1919, brenda në Armeni u zhvilluan zgjedhjet e para parlamentare. Parlamenti i posazgjedhur i përbërë nga 80 antarë zhvilloi aktivitetin e tij në periudhën 1 Gusht 1919 deri në rënien e Republikës së Armenisë.

U përcaktuan simbolet shtetërore. Në Korrik 1918 u deklarua

flamuri shtetëror i Republikës së Armenisë, i cili do ishte trengjyrësh (kuq, blu, portokalli), në Korrik 1920 u vendos simboli i forcave të armatosura të Republikës së Armenisë (autorët e tij ishin Aleksandër Tamanian dhe Hagop Goçojan), kurse himni Armen u krijua mbi bazën e poezisë “Atdheu ynë” i Mikael Nalbandianit.

Një ngjarje e rëndësishme për historinë e Armenisë ishte, padyshim, dita e përvjetorit të parë të Pavarësisë dhe shpalljes së Armenisë së Bashkuar dhe të Pavarur, 28 Maji i vitit 1919. Brenda deklaratës thuhej: “Për të rimëkëmbur tërësinë e Armenisë dhe për të siguruar lirinë e plotë dhe mirëqenien e popullit, Qeveria e Armenisë, në përputhje të plotë me vullnetin dhe dëshirën e popullit Armen, deklaroi, që duke filluar nga kjo ditë, pjesët e ndara të Armenisë do të jenë përfundimisht të bashkuara në një Shtet të vetëm të pavarur”.

Detyrat kryesore të qeverisë së posakrijuar ishin krijimi i forcave të rregullta të armatosura ushtarake, eliminimi i urisë dhe epidemive, përkujdesja për afro 200 000 refugjatë dhe 50 000 fëmijë të mbetur jetimë, përmirësimi i kushteve arsimore-kulturore, etj.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes së paqes, u shkrinë çetat e mëparshme dhe u vendos shërbimi i detyrueshëm ushtarak me qëllim krijimin e një ushtrie të rregullt e të organizuar. Në vjeshtën e vitit 1920 ushtria Armene numëronte 25 000 vetë.

U vendosën bazat e sistemit juridik hartuar në gjuhën Armene, por autoritetet shtetërore nuk arritën të vënë në zbatim legjislacionin kombëtar të Republikës së Armenisë. U krijuan gjykata me juri (me antarë jurie të betuar). Për të parandaluar krizën e urisë u shpall monopoli i shtetit mbi mallrat e domosdoshmërisë jetësore; kryeministri i vendit Hovhanes Kaçaznuni zhvilloi një aktivitet të fuqishëm në SHBA, prej nga erdhën ndihma, të cilat bënë të mundur të kapërcehej me sukses kriza e urisë.

Themeluesit e Republikës së Armenisë e dinin fare mirë që e ardhmja e popullit Armen ndodhej brenda një mendjeje të zhvilluar mirë. Për këtë arsye, ndonëse akoma në kushtet e urisë dhe epidemive,

ata vunë në rend të ditës ngritjen e një Universiteti. Ky vendim u mor më 16 Maj 1919, ndërsa hapja e Universitetit u inagurua më 31 Janar 1920 në qytetin e Aleksandropolit. Vitin tjetër mësimor Universiteti u transferua në Jerevan.

Në Karakilis (Vanadzori i sotëm) në Nëntor të vitit 1919 u hap Universiteti Popullor. Parashikohej, që në vjeshtën e vitit 1920, brenda në Jerevan të hapej një shkollë muzike (konservator), ndërsa në Kars të hapej shkolla e mesme ushtarake. Duke pasur këto synime, u ftuan që të vinin në Armeni një sërë intelektualësh të shquar që banonin jashtë Armenisë.

Një vëmendje e veçantë ju kushtua veprimtarisë për krijimin e bibliotekave dhe muzeve dhe për këtë qëllim u krijua edhe Komiteti i Mbrojtjes së Antikiteteve.

### **Trazirat e brendshme**

Përgjatë gjithë historisë së ekzistencës së Republikës së Armenisë një rol tepër destabilizues kanë luajtur rebelimet provokative antishtetërore të Tatarëve (Azerbajxhanas) dhe Kurdëve. Pas armëpushimit të Mudrosit (30 Tetor 1918), Turqia e mundur i largoi forcat ushtarake nga Kaukazi, por në të njëjtën kohë fshehurazi vazhdonte t'i inkurajonte forcat nacionaliste Turko-Tatare në hapësirat që administroheshin nga Republika e Armenisë. Me pjesëmarrjen e Turqisë dhe Azerbajxhanit, në Korrik të vitit 1919 brenda Armenisë shpërtheu një kryengritje e përgjithshme Turko-Tatare, e cila u shtyp. Kryengritje të ngjashme vazhduan deri në vjeshtën e vitit 1920.

Faktor i dytë destabilizues u shndrruan Bolshevikët, të cilët i drejtonte Rusia Sovjetike. Kjo e fundit ndërkohë që përparonte me sukses në frontet e luftës civile, synonte të rivendoste kufijtë e mëparshëm të Perandorisë Ruse. Më 28 Prill 1920, Azerbajxhani u shndrrua në shtet Sovjetik, pas së cilës, me porosi të Moskës, bolshevikët Armenë vendosin ta marrin pushtetin në Republikën e Armenisë me forcën e armëve.

Në muajin maj të vitit 1920, trupa drejtuese e bolshevikëve, Komiteti Usharak Revolucionar Armen shpalli shtetin Sovjetik brenda në Aleksandropol (sot Gumri), por kjo zgjati vetëm disa ditë. Me 14 maj, qeveria legjitime rivendosi kontrollin mbi qytet.

### **Situata e jashtme e Republikës së Armenisë**

Marrëveshjen e parë ndërkombëtare Republika e Armenisë e nënshkroi me Turqinë (4 qershor 1918, në Batum), e cila mbeti në fuqi deri në përfundimin e Luftës së Parë Botërore.

Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, Republika e Armenisë përforcoi lidhjet me shumë vende. Britania e Madhe, Franca, Italia, Qeveria e Ruisë Jugore, Persia, Gjeorgjia dhe Azerbajxhani kishin përfaqësitë e tyre të përhershme në Republikën e Armenisë. Po kështu edhe Republika e Armenisë kishte përfaqësitë e saja në vendet sipërpërmendur si edhe në SHBA, Gjermani, Zvicër, Japoni, Egjipt, Etiopi, etj.

Çështjet më të rëndësishme që kishin të bënin me Armeninë u diskutuan në vitin 1919, në Kongresin e Paqes së Parisit, dhe në vitin 1920, në Konferencat e San Remos dhe Sevrës.

Pavarësisht disa vendeve të veçanta, Këshilli i Lartë i Aleatëve, në Janar të vitit 1920 e njohu (de facto) legjitimitetin e Qeverisë së Republikës së Armenisë.

Nga vendet fqinje, vetëm me Persinë u arrit që të konsolidoheshin marrëdhëniet reciproke të fqinjësisë së mirë. Me vendet e tjera fqinje në bazë të kontradiktave qëndronin çështjet e hapësirave kufitare dhe qëndrimet e kundërta politike.

Gjeorgjia kishte pretendime territoriale që lidheshin me toka historikisht Armene dhe të banuara aktualisht nga Armenë, siç ishin Lori dhe Xhavahku. Në Dhjetor 1918, kur ushtritë Turke u larguan nga Kaukazi, ushtritë Gjeorgjiane pushtuan Lorin dhe Xhavahkun, gjë që i dha shkas fillimit të luftës Armeno-Gjeorgjiane. Ushtria

Armene arriti që ta pastrojë Lorin nga pushtuesit Gjeorgjianë brenda disa ditësh. Me ndërmjetësinë e Anglisë dhe Francës u nënshkrua armëpushimi, i cili përcaktoi brenda Lorit një “zonë neutrale” nën kontrollin Anglez, kurse Xhavahku, pavarësisht ankesave të palës Armene, ju dha përkohësisht Gjeorgjisë.

Me Azerbajxhanin marrëdhëniet ishin akoma më të ngatërruara, gjë që lidhej me pretendimet territoriale të Azerbajxhanit ndaj hapësirave Armene (Arcah, Zangezuri, Nahiçevan), pretendime të cilat gjenin edhe mbështetjen e Turqisë. Me synimin e largët për t’u bërë zotërues të naftës së Bakusë, mbështetëse e Azerbajxhanit në këto pretendime u bë edhe Qeveria Britanike, e cila pak më herët nuk kishte lejuar hyrjen e çetës së Antranikut në Arcah, ndërsa në Janarin e vitit 1919 i dha miratimin emërimit të udhëheqësit ekstremist të mbarëTurqve në atë zonë, Khosrov Bej Sulltanov, në pozicionin e Guvernatorit të Arcahut dhe Zangezurit, njeri ky, i cili ra shumë shpejt në sy të të gjithëve për masakrat që kreu ndaj Armenëve në Arcah dhe veçanërisht në Shushi.

Duke filluar nga muaji Maj i vitit 1920 Republika e Armenisë u përpoq të forconte marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë me Rusinë Sovjetike, por më kot. Më 28 Prill 1920, pas sovjetizimit të Azerbajxhanit, Rusia filloi të ndihmojë Azerbajxhanin. Nga ana tjetër, Rusia Sovjetike u afrua edhe me Turqinë Qemaliste.

Në këtë situatë, qeveria e Republikës së Armenisë vazhdonte t’i mbante sytë nga Perëndimi, me shpresë se vendimet e Traktatit të Sevres do të bëheshin realitet.

## **Rënia e Republikës së Armenisë**

Turqia, ndonëse doli e mundur nga Lufta e Parë Botërore, arriti të ndryshojë me shpejtësi kursin e politikës së saj të jashtme dhe të vendosë marrëdhënie miqësore me fuqitë e mëdha që dolën fituese në këtë luftë, madje edhe me Rusinë Sovjetike. Jo pa aprovimin e kësaj të fundit, Turqia Qemaliste në vjeshtën e vitit 1920 filloi luftën kundër Armenisë, e cila përfundoi me humbjen e Armenisë.

Më 18 Nëntor 1920 u vendos armëpushimi dhe filluan bisedimet, nga njëra anë me Turqit dhe nga ana tjetër me Rusinë Bolshevike. Më 2 Dhjetor 1920, në Jerevan u nënshkrua marrëveshja, sipas së cilës qeveria e Republikës së Armenisë i kalonte të gjithë pushtetin e saj Bolshevikëve, kurse më 2 duke u gdhirë 3 Dhjetor, në Aleksandropol, u nënshkrua marrëveshja me palën Turke. Kjo e fundit nuk u ratifikua, rrjedhimisht, nuk pati fuqi ekzekutive.

Pasojë e këtyre marrëveshjeve, ishte fakti që Republika e Armenisë u tkurr dhe u detyrua të lëshojë toka. Provinca e Karsit dhe krahina e Surmalit i kaluan Turqisë, kurse hapësirat Armene në lindje tek lumenjtë Ahur dhe Araks i kaluan Ruisë Sovjetike. Duke qenë nën pushtetin Sovjetik, Arcahu dhe Nahiçevani ju hoqën Armenisë Sovjetike dhe ju dhanë Azerbajxhanit, kurse Xhavahku ju dhurua Gjeorgjisë.

## ÇËSHJTJA ARMENE NË VITET 1919 - 1923. PROBLEMI I KUFIJVE TË ARMENISË

**Çështja Armene në Kongresin e Parisit dhe në Konferencën e San Remos**

Lufta e Parë Botërore filloi si rezultat i konfliktit të interesave të Fuqive të Mëdha. Kuptohet, që pas përfundimit të luftës, Fuqitë fituese të ndërtonin një organizim të ri botëror. Për këtë qëllim u organizua në Paris Kongresi i Paqes, i cili i filloi punimet në Janar 1919.

Më 25 Shkurt të vitit 1919, Kongresit ju parashtrua memorandum me kërkesat e Armenëve (hartuar nga Bogos Nubar), të cilin e kishin nënshkruar kryetari i delegacionit të Republikës së Armenisë, Avetis Aharonian dhe përfaqësuesi i interesave të Armenëve të perëndimit, kryetari i Delegacionit Kombëtar, Bogos Nubar. Në këtë memorandum parashikohej që brenda kufijve të Armenisë Shtetërore të përfshiheshin Republika e Armenisë, shtatë vilajetet e Armenisë Perëndimore si edhe Kilikia. Në program ata pretendonin që protektorë të zbatimit të këtij memorandumit të ishin Britania e Madhe dhe SHBA.

Çështjet, që kishin lidhje me Turqinë, ju nënshtruan diskutimeve në Prill 1920 në Konferencën e mbledhur në San Remo. U vendos që Republika e Armenisë mund të bashkohej me një pjesë të Armenisë Perëndimore dhe skicuan konturet e kufijve të saj, të cilat u pasqyruan në Traktatin e Sevrës. U diskutua edhe patronati (mandati i kujdestarisë) i Armenisë, pretendent kryesor i së cilës ishte SHBA.



Avetis Aharonian



Bogos Nubar Pasha

Udrou Uillson  
(Woodrow Wilson  
President i SH.B.A)

### Traktati i Sevrës dhe zgjidhja arbitrare e Udrou Uillsonit

Sakaq, koha nuk po punonte aspak në favor të Armenëve. Senati i SHBA në Qershor 1920 e refuzoi marrjen e mandatit të patronatit mbi Armeninë, kurse brenda Turqisë lëvizja Qemaliste gradualisht vazhdonte të bënte përpara me hapa të shpejta.

Më 10 Gusht në zonën periferike të Parisit, në Sevër, ndërmjet Fuqive të Mëdha fituese në Luftën e Parë Botërore dhe Turqisë u nënshkrua Traktati i Paqes (i përbërë nga 433 pika). Çështjes Armene i kushtoheshin pikat 88-93, sipas të cilave Turqia e njihte Armeninë si shtet të lirë dhe të pavarur; Armenisë i kalonin provincat e Erzurumit, Vanit, Bitlisit dhe Trabizonit, dhe në përputhje me këto do të përvijoheshin vijat e kufijve ndërmjet Armenisë dhe Turqisë, ndërsa ndërmjetës dhe garant për realizimin e sa më sipër do të ishte Presidenti i SHBA, Udrou Uillson.

Zgjidhja arbitrare e Udrou Uillsonit u nënshkrua më 22 Nëntor 1920. Me katër krahinat e përmendura më sipër që i bashkoheshin Republikës së Armenisë nga territoret e Armenisë Perëndimore, Republika e Armenisë përfitonte një hapësirë prej afro 90 000 km. katror si edhe dalje në Detin e Zi. Në total sipërfaqja e Republikës së Armenisë do të shtrihej në një hapësirë prej afro 160 000 km. katror.

Traktati i Sevres dhe zgjidhja arbitrare e Udrou Uillonit praktikisht nuk u vunë në zbatim, pasi Turqia Qemaliste me të shpejtë e ndryshoi kursin e politikës së saj të jashtme, fillimisht duke u afruar me Rusinë Sovjetike, pastaj me Britaninë e Madhe dhe Francën, bëri disa lëshime ndaj tyre dhe në këmbim mori “varrosjen” e çështjes Armene. Ndërkohë, Armenët, në një masë të madhe, vazhdonin t’i mbanin varur shpresat tek respektimi i vendimeve të Fuqive të Mëdha...

Sidoqoftë Traktati i Sevres dhe zgjidhja arbitrare e Udrou Uillonit kanë një rëndësi të madhe historike dhe juridike. Njëpërmjet tyre, bota e shekullit XX njohu të drejtat e Armenëve në lidhje me Atdheun e tyre historik. Ato dokumente nuk e kanë humbur rëndësinë e tyre juridike.

### **Çështja Armene në Traktatin e Londrës dhe të Lozanës**

Vetëm disa pak muaj pas nënshkrimit të Traktatit të Sevres, nga 21 Shkurti deri më 14 Mars 1921, brenda në Londër u mbledh një Kongres, në të cilin u diskutua përsëri çështja Armene. Drejtuesit e delegacionit Armen, Avetis Aharonian dhe Bogos Nubar, prisnin realizimin e Traktatit të Sevres dhe zgjidhjen arbitrare të Udrou Uillonit, vënien në dispozicion të mjeteve për çlirimin e Armenisë Perëndimore. Përkundër asaj që pritej, Kongresi ja besoi Turqisë gjetjen e një zgjidhjeje në pjesën lindore të saj për “vatrën kombëtare Armene”, por edhe kjo madje pa asnjë përcaktim se ku do të gjendej kjo pjesë toke.

Fundi i trishtë i diskutimeve mbi Çështjen Armene u shkrua në Konferencën Ndërkombëtare të organizuar në qytetin Lozanë të Zvicrës në periudhën 20 Nëntor 1922 - 24 Korrik 1923. Në këtë mbledhje nuk u lejua pjesëmarrja e përfaqësuesve të Delegacionit Kombëtar, që përfaqësonte interesat e qeverisë në mërgim të Republikës së Armenisë dhe interesat e Armenëve Perëndimorë, të cilët pretendonin krijimin e “vatrës kombëtare Armene” sipas skicimit të Udrou Uillonit, ose brenda në Kiliki.

Me Konferencën e Lozanës vdiq edhe ideja e “vatrës kombëtare Armene”. Çështja e të shpërngulurve ju delegua Lidhjes së Kombeve,

kurse Çështja Armene u hoq nga rendi i ditës. Ishte Konferenca e Lozanës, ajo që fiksoi kufijtë e sotëm të Turqisë, me përjashtim të sanxhakut të Aleksandretës, i cili ju dhurua Turqisë në vitet 1938-1939, duke i kthyer asaj vilajetin e Hatës.

### **Çështja e kufijve të Armenisë Sovjetike në vitin 1921**

Bolshevikët Armenë kishin lidhur shpresa të mëdha me qeverinë Sovjetike, për më tepër, kur Qeveria Sovjetike e Azerbajxhanit, më 30 Nëntor të vitit 1920, doli me deklaratën që shpallte Karabakun, Zangezurin dhe Nahiçevanin si pjesë përbërëse dhe e pandashme e Armenisë Sovjetike. Siç rezultoi më vonë, ky nuk ishte gjë tjetër veçse një mashtrim për Armenët.

Marrëdhëniet Turko-Bolshevike e arritën kulmin më 16 Mars 1921 me nënshkrimin e Traktatit të “vëllazërisë dhe miqësisë” në Moskë. Me këtë dokument sigurohej kalimi i provincës së Karsit dhe krahinës së Surmalit nën Turqinë, kurse hapësira e Nahiçevanit u shpall krahinë vetqeverisëse nën patronazhin e Azerbajxhanit. Me imponimin e Rusisë Sovjetike, ishin pothuajse po këto pika, që u vendosën në marrëveshjen ilegale të datës 13 Tetor 1921 ndërmjet Armenisë Sovjetike dhe Turqisë Qemaliste. Në të ardhmen, Nahiçevani hyri në përbërjen e Azerbajxhanit në formën e Republikës Autonome.

Azerbajxhani Sovjetik zhvilloi një luftë të ashpër për të marrë në zotërim krahinën e Karabakut (Arcahun) e cila përbëhej në masën 95% nga banorë Armenë. Që në Qershor të vitit 1918, Armenët e Arcahut, në mbledhjen e tyre të parë kishin deklaruar vetqeverisjen e Arcahut dhe si qeveri Armene kishte krijuar Këshillin Kombëtar, kurse në 25 Prill 1920, në mbledhjen e nëntë të Armenëve të Arcahut shpallën ribashkimin me Nënë Armeni. Këtë fakt e njohu edhe Qeveria Sovjetike, kryesia e së cilës, e vendosur në Byronë Kaukaziane të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste (Bolshevike), me vendimet e datës 3 Qershor dhe 4 Korrik 1921 i pranoi ato. Ndërkohë, vetë Byroja Kaukaziane, më datë 5 Korrik (pra një ditë më pas), mori një vendim krejt të kundërt; e përfshiu

Karabakun brenda kufijve të Azerbajxhanit. Në këtë veprim një rol jashtëzakonisht negativ luajti Diktatori i ardhshëm, Josif Stalini, i cili arriti që të organizojë një aleancë të antarëve Gjeorgjianë dhe Azerbajxhanas të Byrosë Kaukaziane kundër Armenëve. Më datë 5 Korrik, ata së bashku, votuan që Karabaku t'i kalonte Azerbajxhanit, ndërsa pas dy ditësh, më 7 Korrik, votuan që Xhavahku t'i kalonte Gjeorgjisë. Kështu dy krahina të territorit Armen ju shkëputën Armenisë Sovjetike. Më pas, më 7 Korrik 1923, Nagorno-Karabaku (Arcahu) "inaguroi" marrjen e statusit të krahinës autonome, brenda shtetit të Azerbajxhanit.

Në Nëntor të vitit 1921, ndërmjet qeverive Sovjetike të Armenisë dhe Gjeorgjisë u nënshkrua një marrëveshje, në bazë të së cilës krahina e Lorit i mbetej Armenisë, ndërsa Akhalkalaku, Xalkani dhe Bolnis-Kaçeni i kalonin Gjeorgjisë.

Në të ardhmen, kur Armenia Socialiste hyri në përbërjen e BRSS si njësi administrative e Republikës Socialiste Federative Sovjetike NdërKaukaziane (1922-1936), disa prej krahinave kufitare, me vendime të brendshme, u hoqën nga Armenia Sovjetike dhe i kaluan Azerbajxhanit.

Pretendimet ndaj Armenëve nuk arritën të bëhen realitet vetëm në rastin e krahinave të Sjunik-Zangezurit, popullsia e së cilës, në vitet 1918-1921 zhvilloi një betejë heroike, në sajë të së cilës u arrit që këto krahina të mbeteshin brenda kufijve të shtetit Armen. Këtë betejë e udhëhoqi fillimisht Antranik Ozanian (nga vera e vitit 1918 deri në pranverën e vitit 1919), pastaj Arsen Shahmazian, ndërsa nga Tetori i vitit 1919 deri në Korrik 1921 e udhëhoqi Karekin Nezhtehu.



## POPULLI ARMENI NË VITET E LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

### **Armenia në prag të Luftës së Dytë Botërore**

Periudhën e shkurtër të Armenisë së Pavarur e pasuan disfata dhe humbje të vazhdueshme. Çështja Armene u “varros” brenda Konferencës së Lozanës, kurse qeveritë sovjetike jo vetëm që i copëzuan hapësirat Armene duke e lënë Armeninë Sovjetike me vetëm 30 000 km. katror, por edhe vendosën diktaturën njëpartiake, duke syrgjynosur shumë prej intelektualëve.

Diktatura Sovjetike e arriti kulmin e saj në vitet e qeverisjes së Josif Stalinit, veçanërisht në vitet 1936-1938, kur krahas me dhjetra mijëra viktima të pafajshme populli Armen humbi edhe shumicën e ajkës së inteligjencës së saj (Jegishe Zarenc, Aksel Bagunc, etj) dhe të veprimtarëve politiko-shoqërore (Agasi Hanxhian, Sahak Ter Gabrielian, etj). Brenda në Armeni, përndjekjeve politike ju nënshtruan rreth 15 000 vetë, nga të cilët një pjesë e konsiderueshme u pushkatua. Veçanërisht shumë u rëndua gjendja e Kishës Apostolike Armene; në vitin 1938, brenda Selisë së Nënës së Shenjtë në Eçmiadzin, në rrethana krejt të panjohura vdiq Katolikosi i MbarëArmenëve, A. Muratbegian (1932-1938).

Pavarësisht gjithë këtyre, në vitet e paqes të periudhës 1921-1941 u realizuan edhe një sërë vlerash pozitive, nga të cilat vlen të veçohet rimëkëmbja ekonomike dhe zhvillimi gradual, krijimi i një rrjeti të gjerë arsimor, organizimi i kthimit të Armenëve në Armeni.

Në vitet 1920-1930, nga vendet e tjera hynë (imigruan) në Armeni rreth 42 000 Armenë.

### **Pjesëmarrja e Armenëve në Luftën e Dytë Botërore në përbërje të BRSS (Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike)**

Më 1 Shtator 1939, sulmi i Gjermanisë Hitleriane kundër Polonisë shënoi fillimin e Luftës së Dytë Botërore. Në vitet 1939-1940, Gjermania kishte pushtuar pjesën më të madhe të Europës, ndërsa më 22 Qershor 1941 sulmoi BRSS-në. Luftën e filluar, Bashkimi Sovjetik e deklaroi “Lufta e madhe Patriotike”, e cila përfundoi me humbjen e Gjermanisë më 9 Maj të vitit 1945. Më 2 Shtator 1945, me kapitullimin e Japonisë, që ishte aleat i Gjermanisë, përfundoi edhe Lufta e Dytë Botërore.

Në këtë luftë të paprecedentë morën pjesë 61 shtete me 1,7 miliard banorë, nga të cilët 110 milionë shërbenin në forcat e armatosura. Vdiqën më tepër se 50 milion njerëz dhe mbetën invalidë më tepër se 95 milion vetë.

Pjesëmarrja e Armenëve në luftë në përbërje të forcave të armatosura të BRSS ishte e kushtëzuar jo vetëm për shkak të bindjeve politike apo ndjenjës së detyrimit qytetar. Turqia kishte bërë aleancë me Gjermaninë; nëqoftëse kjo e fundit do të fitonte në betejën për marrjen e Stalingradit (pra, me rënien e Stalingradit – që sot njihet me emrin Volgograd), forcat ushtarake Turke, të përbëra prej 26 njësi ushtarake të përqëndruara në kufi me Armeninë Sovjetike, do të fillonin luftën kundër BRSS fillimisht me sulmin mbi Armeninë; kjo do të thoshte vazhdim i asgjësimit të Armenëve (pra vazhdim i Genocidit Armen) brenda Armenisë Lindore në vitet 1940. Dhe nuk është e rastit që Armenët morën pjesë me përkushtim jo vetëm në përbërje të ushtrisë së BRSS (mbi 450 000 vetë), por edhe në ushtritë e vendeve të tjera aleate antihitleriane.

Në luftë morën pjesë 6 njësi ushtarake Armene. Përveç tyre, Armenët ndodheshin në përbërje edhe të shumë formacioneve të tjera luftarake. Armenët morën pjesë pothuajse në të gjitha betejat e rëndësishme të luftës.



Aksel Bagunc



Jegishe Zarenc



Agasi Kandian

Brenda hapësirave të pushtuara të BRSS ra në sy edhe aktiviteti i partizanëve Armenë, të cilët kishin krijuar çeta luftarake të vetat (siç ishin çetat “Fitorja”, “Ylli i Kuq”, si edhe ajo me emrin e Mikojanit).

Luftës së Madhe Patriotike populli Armen i dha 107 heronj të BRSS, 27 medalje të të tre shkallëve të Lavdisë, 70 000 luftëtarë dhe oficerë të dekoruar me medalje të ndryshme. Vetëm në periudhën e Luftës Armenët patën 70 gjeneralë. Nga këta, 4 vetë u ngritën në gradën e Marshallit; Marshalli Hovhanes Bagramiani, dy herë “Hero i Bashkimit Sovjetik”; Marshalli i forcave ajrore, Sergej Hudiakov (Armenak Hanperianc); Marshalli i forcave tankiste dhe të blinduara, Hamazasp Papaçanian dhe Admirali i flotës detare të BRSS, Hovhanes Isakov (Ter Isahakian).

### **Pjesëmarrja e Diasporës Armene në Luftën e Dytë Botërore**

Armenët që jetonin jashtë Armenisë morën pjesë aktivisht në luftë, duke kontribuar me luftëtarë në beteja, si edhe duke ndihmuar Armeninë Sovjetike me mjete materiale në formë donacionesh. Me shumat e mbledhura nga Diaspora u krijuan grupet e blinduara “Davidi i Sasunit” dhe “Gjeneral Bagramiani”. Brenda Francës, së bashku me popullin Francez, Armenët morën pjesë aktivisht në luftën kundër fashizmit, luftë kjo që u njoh me emrin Lëvizja e Rezistencës. Një nga



Marshalli Hovhanes  
Bagramian



Misak Manushian



Artashes Abeghian

faqet më të ndritura në historinë e kësaj lëvizjeje e shkroi verprimtaria e çetës së Misak Manushianit (i cili u shpall “Hero Kombëtar i Francës”, pas vdekjes).

Partizanët Armenë luajtën një rol të rëndësishëm si në Armeni ashtu edhe në vendet e tjera që zhvillonin luftën për çlirim. Në ushtritë ndërluftuese Aleate morën pjesë rreth 100 000 Armenë të Diasporës (vetëm në ushtrinë e SHBA kishte rreth 18 500 ushtarë dhe oficerë).

### **Bashkëpunimi i detyrueshëm i Armenëve me rregjimin Hitlerian**

Turqit, duke u afruar në aleancë me Gjermanët, në vitin 1939 u përpoqën t’i bindnin këta të fundit, se gjoja Armenët kishin origjinë semite dhe si rrjedhim duhet të asgjësoheshin së bashku me çifutët. Armenët e Europës i dolën përpara këtij veprimi falë Këshillit Kombëtar Armen të Berlinit (kryetar i së cilës ishte profesori i Universitetit të Berlinit, Artashes Apegian), publikimet e të cilit, si edhe të studimeve të shkencëtarëve të tjerë Europeanë që mbështesnin tezën “Armenët janë racë Ariane”, të cilët arritën të bindin elitën shoqërore hitleriane që Armenët ishin racë Ariane (IndoEuropiane).

Në fillim të luftës, Gjermania për një kohë të gjatë nuk pati ndonjë humbje serioze, kështu që, nuk kishte asnjë garanci, që përparimi i Gjermanëve do të frenohej. Ndërmjet Gjermanisë dhe Turqisë kishte një

marrëveshje paraprake, sipas së cilës, pas rënies së Stalingradit, Turqia do të futej në luftë kundër BRSS, duke pushtuar fillimisht Armeninë dhe Gjeorgjinë. Dhe kjo do të thoshte, mundësi për realizimin e planit për asgjësimin e plotë të Armenëve brenda në Armeninë Lindore.

Të ndodhur në këto kushte, forca të caktuara Armene (veçanërisht “Tashnakcutjunët”) vendosën të bashkëpunojnë me qeverinë naziste. Gjermanët, prej robërve të luftës të kombësive të ndryshme, formonin legjione me qëllim që t’i dërgonin kundër pushtetit Sovjetik. Me këtë dhe iniciativën e të tjerëve, në Dhjetor të vitit 1941 u krijua “Legjioni Armen”, numri i luftëtarëve të të cilit arriti në afërsisht 25 000 vetë. Pak më vonë, kësaj iniciative ju bashkua edhe Karekin Nezhdehu, kryeministri i dytë i Republikës së Armenisë, Aleksander Hatisiani, dhe të tjerë.

Për fat të mirë, Gjermanët u mundën në Stalingrad, kështu që ndërhyrja e Turqve nuk u bë e mundur. Sidoqoftë u duhet dhënë vlera që u takon antarëve të Këshillit Kombëtar Armen të Berlinit dhe iniciatorëve të formimit të “Legjionit Armen”, të cilët fillimisht shpëtuan Armenët që banonin në Europë, pastaj, në rast se në të ardhmen ngjarjet do të zhvilloheshin në sensin negativ (pra, në rast se Gjermanët do kishin arritur ta merrnin Stalingradin), do të përpiqeshin t’i dëlnin përpara realizimit nga ana e Turqisë të planeve për masakrimin e Armenëve.



## BETEJA E ARCAHUT PËR LIRI. RIVENDOSJA E PAVARËSISË SË ARMENISË

### Zgjimi kombëtar në vitet 1960-1980

Në vitin 1956, tre vjet pas vdekjes së Josif Stalinit, udhëheqësi i ri i BRSS, Nikita Hrushovi kritikoi sistemin diktatorial të vendosur prej tij, dhe të dënuarit e pafajshëm u rehabilituan. Filloi një epokë relativisht lirie, gjatë së cilës u bë e mundur të ngriheshin edhe probleme me karakter kombëtar. Në vitin 1965 u dha një leje gjysëmzyrtare për ndërtimin e përkujtimeve të viktimave të Genocidit, të cilin Qeveria Sovjetike e kishte ndaluar në vitin 1926. Në vitin 1964 u krijua Komiteti i Lidhjeve Kulturore me Diasporën Armene. Në vitin 1964 përfundoi ndërtimi i kompleksit përkujtimor “Մի ժեռնասկաբերդի – Xixernagaberd – Kështjella e Dallëndyshes”. Në vitin 1968 u përkujtua 50 vjetori i betejës heroike të Sardarapatit dhe me këtë rast u hap përkujtimorja e ngritur mbi vendin ku u zhvillua beteja. Në realizimin e këtyre programeve me karakter progresist kombëtar, një kontribut të ndjeshëm pati edhe Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Armenisë, Jakov Zarobian.

Në vitet 1960, Armenët e ngritën përsëri çështjen e Karabakut. Çështjen e ribashkimit të Nagorno-Karabakut dhe Nahiçevanit me Armeninë Sovjetike, udhëheqja e Armenisë Sovjetike e ngriti deri në organet më të larta të BRSS, por asnjëra nga çështjet e ngritura nuk mori përgjigje pozitive.

Me qëllim plotësimin e kërkesave kombëtare, në vitet 1960-1980, brenda në Armeni u krijuan organizata dhe grupime të fshehta, nga të cilat më e madhja dhe më me influencë ishte “Partia e Bashkimit Kombëtar”, e cila botonte fletushkën ilegale “Երկունք - Dhimbjet e Lindjes” dhe “Փայուր - Fari”. Qeveritarët u sollën egër dhe me ashpërsi ndaj këtyre disidentëve. Në këto vite, në masë të ndryshme u dënuan me burgim ose internim më tepër se 70 disidentë.

Zgjimim kombëtar e ndihmoi edhe kthimi në masë të madhe e Armenëve të Diasporës në Armeni në vitin 1946. Ndërmjet viteve 1940-1980 u kthyen në Armeni rreth 130 000 Armenë të Diasporës. Në rradhët e të ardhurve kishte shkencëtarë, mjeshtër të zotë, intelektualë të fushave të ndryshme.

### **Lufta e Armatosur në emër të Gjyqit Armen**

Zgjimi kombëtar MbarëArmen mori hov në mesin e viteve 1970 edhe me luftën e armatosur që kishte filluar në mesin e Diasporës në emër të Gjyqit Armen. Sinjalin e kësaj beteje e dha 78-vjeçari Gurgjen Janikian në 27 Janar të vitit 1973, kur qëlloi për vdekje dy diplomatë Turq brenda në qytetin Santa Barbara të Kalifornisë në SHBA.

Nga Janari i vitit 1975 deri në Dhjetor të vitit 1990, vepra të tilla ndaj shenjestrave Turke, u kryen nga “Ushtria e Fshehtë Armene për Çlirimin e Armenisë” (Հ.Ս.Հ.Գ.Բ. – e transkriptuar do ishte ASALA), “Luftëtarët për Drejtësi ndaj Genocidit Armen”, “Ushtria Revolucionare Armene”, si dhe organizata të tjera. Shumë prej luftëtarëve Armenë u viktimizuan (Zohrab Sarkisian, Levon Ekmekxhian dhe Mëgërdiç Matarian – brenda në Turqi, “Të Pestët” në Lisbonë, e të tjerë), të tjerë u burgosën. Beteja e dha frutin e vet. Në vitet 1980, një numër i madh vendesh, organizata ndërkombëtare si edhe njësi administrative të veçanta shtetërore apo lokale e njohën Genocidin Armen. Ndër më të parat organizata ndërkombëtare që njohën Genocidin Armen ishin “Gjykata e Përherëshme e Popujve” (Ժողովուրդներու Մշտական Դատական Աստևան - Permanent People’s Tribunal (TPP) (18 Prill

1984) dhe Këshilli i Europës (13 Qershor 1987). Ndër shtetet, i pari që e njohu atë ishte Uruguaji në vitin 1965, në ditët përkujtimore të 50-vjetorit të Genocidit.

### **Etapa e re e betejës për çlirimin e Arcahut**

Për të fituar kohën e humbur nga mbyllja në qeverisjen Sovjetike, në vitin 1985 në krye të BRSS erdhi një udhëheqës i ri, Mihail Gorbaçov, me politikën e “demokratizimit” të jetës së vendit dhe “Riorganizimit”. Filluan të shprehen me zë të lartë problematika të shumta, të cilat kishin qëndruar të ndrydhura përgjatë dhjetëvjeçarëve të diktaturës. Një nga të parat që shpërtheu ishte çështja e Arcahut.

Në Shkurt të vitit 1988 në Stepanakert dhe Jerevan shpërthyen mitingje popullore me kërkesën për bashkimin e Krahinës Autonome të Nagorno-Karabakut me Armeninë Socialiste. Në 20 Shkurt të vitit 1988, organi më i lartë i qeverisjes shtetërore të Nagorno-Karabakut, në seancën e 20<sup>te</sup> të Këshillit Krahinor, në mbështetje të vullnetit popullor dhe të Kushtetutës së BRSS, ju drejtua Armenisë, Azerbajxhanit dhe Këshillit Suprem të BRSS me kërkesën për ribashkimin e Krahinës Autonome të Nagorno-Karabakut me Armeninë Socialiste. Nën presionin popullor, Këshilli Suprem i Republikës Socialiste Sovjetike të Armenisë në 15 Qershor 1988 mbajti qëndrim pozitiv ndaj kësaj kërkesë, gjë që solli reagimin armiqësor të Azerbajxhanit dhe Moskës.

Për të thyer shpirtin Armen filluan të vihen në lëvizje mekanizma nga më të paimagjinueshmit. Më 27-29 Shkurt 1988, me porosi dhe bashkëpjesëmarrje të qeverisë u organizua Genocidi Armen në qytetin Azerbajxhanas të Sumgaitit. Në vitin 1989, Azerbajxhani mbylli kufijtë me Armeninë, duke mbyllur njëkohësisht të gjitha rrugët, nëpërmjet të cilave në vend hynin rreth 80% e mallrave të importit; nga hapësirat Azerbajxhanase u dëbuan me forcë një numër i madh banorësh Armenë.

Ndërkaq shpirti unik Armen fitoi, si mbi provokacionet e qeveritarëve Sovjetikë, ashtu edhe ndaj përpjekjeve të forcave proTurke Azerbajxhano-Turke. Për mbrojtjen e Atdheut, luftëtarë vullnetarë Armenë që ju

përgjigjën vullnetarisht thirrjes, të frymëzuar nga shpirti heroik dhe amanetet e të parëve, jo vetëm që e frenuan armikun, por edhe e çliruan Nagorno-Karabakun si edhe krahinat kufitare autoktone Armene.

Më 1 Dhjetor 1989, Këshilli Suprem i Republikës Socialiste Sovjetike të Armenisë dhe Këshilli Kombëtar i Nagorno-Karabakut, duke u bazuar në parimin e vetvendosjes së kombeve dhe duke ju përgjigjur vullnetit të popullit Armen, ndërморën vendimin historik për ribashkimin e Republikës Socialiste Sovjetike të Armenisë dhe Krahinës Autonome të Nagorno-Karabakut.

Duke marrë në konsideratë ngjarjet e viteve 1990-1991 si edhe atmosferën politike ndërkombëtare, qarqet politike Armene vendosën që zgjidhjen e problemit të bashkimit të këtyre dy shteteve Armene ta kërkonin me rrugën e bashkimit të tyre si dy shtete fillimisht të pavarur.

Më 2 shtator 1991, sesioni i përbashkët i delegatëve të popullit të Krahinës Autonome të Nagorno-Karabakut dhe krahinës së Shahumianit deklaruan krijimin e Republikës së Nagorno-Karabakut (Arcahut). Po atë vit, më 10 Dhjetor, në prani të vëzhguesve ndërkombëtarë në Republikën e Nagorno-Karabakut të posaformuar u zhvillua referendum i përgjithshëm popullor, ku shumica dërmuese e pjesëmarrësve u shpreh hapur në favor të pavarësisë së Republikës së Nagorno-Karabakut (Arcahut).

Çlirimi i Shushisë dhe Bercorit (Laçinit) në datat respektive 9 dhe 18 Maj të vitit 1992 ishin dy nga ngjarjet që shënuan kthesë në betejën për çlirimin e Arcahut, pasi që të dyja këto zona ishin zona me të cilat të dy Republikat Armene kishin pasur lidhje të përherëshme dhe të sigurta tokësore.

Forcat Armene zhvilluan një sërë betejash të suksesshme kundër një armiku që kishte forca disa herë më të mëdha si në numër ashtu edhe në teknikë luftarake. Me ndërmjetësinë e Rusisë dhe Organizatës Europiane për Sigurinë dhe Bashkëpunimin, në Mbledhjen e Minskut të datës 12 Maj 1994, u nënshkrua armëpushimi. Çështja e Arcahut u vendos mbi tryezën e bisedimeve diplomatike dhe deri më sot vazhdojnë të diskutohen variante të ndryshme zgjidhjesh.

## Shpallja e Pavarësisë së Republikës së Armenisë

Bazat e lëvizjes për pavarësi brenda Republikës Socialiste Sovjetike të Armenisë i kishin hedhur disidentët Armenë që në vitet 1960-1970. Kjo betejë mori një hov të ri me fillimin e betejës për pavarësinë e Arcahut.

“Komiteti Armen i Lëvizjes Karabakiane” (Komiteti i “Karabakut”), që ishte në krye të veprimtarisë së Lëvizjes Arcahiane, dhe që në objektivat që i kishte vënë vetes kishte përfshirë një sërë prioritetesh kombëtare, në vitin 1989 u riorganizua në Lëvizja MbarëKombëtare Armene. Kjo e fundit vendosi që të vinte në pushtet me rrugë paqësore, nëpërmjet zgjedhjeve popullore. Në parlamentin e posazgjedhur filloi një betejë ndërmjet Lëvizjes MbarëKombëtare Armene dhe Partisë komuniste Armene, e cila përfundoi me fitoren e Lëvizjes MbarëKombëtare Armene; më 4 Gusht të vitit 1990, President i Këshillit Suprem u zgjodh antari i Komitetit të “Karabak-ut”, një nga drejtuesit e Lëvizjes MbarëKombëtare Armene, Levon Ter Petrosian.

Këshilli Suprem i Armenisë Sovjetike, më 23 Gusht të vitit 1990, publikoi dokumentin me titull “Për shpalljen e Pavarësisë së Armenisë”, i cili njoftonte fillimin e procesit të pavarësimit të Armenisë. Me këtë dokument, Republika Socialiste Sovjetike e Armenisë riemërohej “Republika e Armenisë”. Në dokument ishte futur edhe një pikë e veçantë, që kishte lidhje me Genocidin Armen.

Pas pak më shumë se një viti, në 21 shtator 1991, çështja e pavarësisë mori zgjidhjen e saj përfundimtare, kur brenda Armenisë u zhvillua referendumi për daljen nga përbërja e BRSS dhe për çështjen e pavarësisë. Nga pjesëmarrësit me të drejtë votimi në referendum, më tepër se 94% (2 043 000 vetë) votuan në favor të pavarësisë. Mbi bazën e rezultateve të referendumit, Këshilli Suprem i Armenisë Sovjetike, më 23 Shtator 1991 e shpalli Republikën e Armenisë “Shtet të Pavarur”.

Pas një kohe të shkurtër, në Republikën e Armenisë u instalua drejtimi presidencial. Më 16 Tetor 1991, me referendum popullor, president i parë i Republikës së Armenisë u zgjodh Levon Ter Petrosian.

Degradimi i BRSS sa vinte e po bëhej më i dukshëm. Në 8 Dhjetor

të vitit 1991, në afërsitë e Minskut, brenda Pelovezhskit, ndërmjet udhëheqësve të Rusisë, Ukrainës dhe Bjellorusisë u nënshkrua një marrëveshje për ndërprerjen e ekzistencës së BRSS dhe për të krijuar “Bashkëveprimin e Shteteve të Pavarura”.

Më 21 Dhjetor 1991, në kryeqytetin e Kazakistanit, Alma Ata, 11 ish Republika të BRSS së asaj kohe, Rusia, Ukraina, Bjellorusia, Armenia, Kazakistani, Uzbekistani, Taxhikistani, Kirgistani, Turkmenistani, Moldavia dhe Azerbajxhani, u mbledhën dhe nënshkruan marrëveshjen e antarësimit në organizimin “Bashkëveprimi i Shteteve të Pavarura”. Me këtë u mbyll kapitulli i fundit i historisë afro 70-vjeçare të Bashkimit Sovjetik.

Nga fundi i vitit 1991 filloi edhe procesi i njohjes ndërkombëtare të Republikës së Armenisë. Pothuajse të gjitha vendet e botës e njohën Republikën e Armenisë dhe lidhën marrëdhënie diplomatike me të. Më 2 Mars 1992, Armenia u pranua antare me të drejta të plota në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Aktualisht, Armenia sot është antare e një sërë organizatash ndërkombëtare.

## KREU 34

## KULTURA ARMENE NGA VITI 1918 DERI NË DITËT E SOTME

### Kultura në Republikën Socialiste Sovjetike të Armenisë në vitet 1920-1945

Qeveria Sovjetike, në fillimet e veta, theksin kryesor në fushën e kulturës e vendosi në krijimin e një sistemi ideologjik, qëllimi i të cilit ishte krijimi i një shoqërie të brumosur me ideologjinë komuniste. Për këtë, detyrimisht, duhej të kishte një shoqëri të arsimuar, prandaj qeveritarët i kushtuan vëmendje të madhe fushës së arsimit. Falë një veprimtarie të orientuar dhe të programuar, në vitin 1940, brenda në Armeninë Sovjetike, në tërësinë e vet, analfabetizmi ishte zhdukur.

Në vitin 1922, në Jerevan, u themelua Biblioteka Publike e Republikës (e cila në vitin 1925 mori emrin e Aleksandër Miasnikianit). Në vitin 1940, brenda Armenisë kishte 900 biblioteka publike, vepronin 9 institucione të arsimit të lartë, me rreth 11 000 studentë.

Një kujdes i madh ju kushtua zhvillimit të shkencës. Në vitin 1921 u themelua Instituti i Shkencave i Armenisë, i cili në vitin 1925 u shndrrua në Instituti i Shkencave dhe i Arteve i Armenisë.

Në vitin 1935 u themelua Dega Armene e Akademisë së Shkencave të BRSS.

Në vitin 1939, biblioteka e Selisë së Nënës së Shenjtë u transferua në Jerevan dhe në bashkëveprim me Arkivin Shtetëror të Dorëshkrimeve mori statusin i institucionit.

Në fushën e letërsisë, krahas krijuesve të mëdhenj, në vitet 1920 sollën zërin e tyre të ri Jegishe Zarenc, Aksel Bagunc, Gurken Mahari e të tjerë. Në vitin 1932 u themelua Lidhja e Shkrimtarëve të Armenisë, nëpërmjet së cilës qeveria synonte që t'i shndrronte shkrimtarët Armenë në makinën e saj propagandistike.

Në vitin 1932 u themelua Lidhja e Artistëve Sovjetikë të Armenisë, brenda së cilës u futën edhe artistë shumë të talentuar të kohës, si Mardiros Marian, Hagop Goçojan, Jegishe Tadevosian, Panos Terlemezian, e të tjerë.

Përfaqësuesi kryesor i arkitekturës dhe urbanistikës qytetare të asaj kohe ishte Aleksandër Tamanian. Ai hartoi planimetrinë bazë të Jerevanit si edhe projektoi një numër të madh ndërtesash madhështore (ndërtesën e qeverisë së Armenisë, ndërtesën e Teatrit Shtetëror të Operas dhe Baletit, etj.).

Në vitin 1923 u hap në Jerevan shkolla shtetërore e muzikës (Konservatori, i cili më pas mori emrin e Komitas-it), më pas u krijua Filarmonia Shtetërore, kurse në vitin 1933 u hap Teatri Shtetëror i Akademisë së Operas dhe Baletit.

Në vitin 1922 u hap në Jerevan Teatri Dramatik Shtetëror, i cili në vitin 1937 mori emrin “Gabriel Sundukian”.

Lindi një lloj i ri arti Armen, filmi (kinemaja). Prodhimi i parë Armen ishte filmi pa zë “Namuz” i shfaqur më 1925. Filmi i parë me zë ishte filmi “Pepo”, që u shfaq për shikuesit në vitin 1935.

Në fushën e shkencës dhe kulturës, arritje të madhe pati edhe gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore. Mbi bazën e Degës Armene të Akademisë së Shkencave të BRSS, në vitin 1943 u themelua Akademia Armene e Shkencave (antarët themelues ishin: Armenologu Armeno-Lindor, Hovsep Orbel; fiziologu, Levon Orbel; vëllezërit fizikantë, Abraham dhe Artem Alihanian; astronomi Viktor Hambarcumian; gjuhëtari Hrasha Axharian; kritik letrar Manuk Apekian; historiani Hagop Manantian; poet Avetik Isahakian). Kryetar i parë i Akademisë u zgjodh Hovsep Orbel. Në vitin 1947, atë e zëvendësoi Viktor

Hambarcumiani, i cili qëndroi në atë detyrë deri në vitin 1994 (1994 – 1996 ishte Kryetar Nderi).

Edhe letërsia Armene pati një prodhimtari të bollshme gjatë viteve të luftës. U shkruan tregime historike dhe legjenda (Derenik Demirçiani me “Vartanank”, Stepan Zorjani me “Baba Mbreti”), të cilat duke pasur në epiqendër bëmat heroike të paraardhësve, ishte menduar të ngrinin lart frymën heroike të popullit dhe luftëtarëve Armenë, që ishin në frontin e luftës.

Gjatë kësaj kohe u botuan shumë krijime me nivel të lartë artistik me tema lirike dhe patriotike nga Avetik Isahakian, Nairi Zarian, Hovhanes Shiraz, e të tjerë.

### **Jeta kulturore në Republikën Socialiste Sovjetike të Armenisë pas Luftës së Dytë Botërore**

Vazhdonte të zgjerohej sistemi arsimor; në vitin 1980, brenda në Armeni, vepronin 1500 shkolla, 14 Institucione të Arsimit të Lartë me rreth 50 000 studentë dhe mbi 1300 biblioteka.

Pavarësisht nga presionet dhe kufizimet e pranishme ideologjike, rezultate serioze u arritën edhe në fushën e Armenologjisë. Një realizim i rëndësishëm ishte botimi i veprës në 8 vëllime “Historia e popullit Armen”, ku historia e Armenëve u paraqit në nivelin e njohurive shkencore bashkëkohore, duke filluar nga fillesat e hershme të njohura shkencërisht deri në vitet 1980.

Në vitet e pasluftës u themelua edhe Observatori i Burakanit, i cili nën drejtimin e Viktor Hambarcumianit u shndrrua në një nga qendrat kryesore të astronomisë botërore. Në vitin 1967 u realizua përshpejtimi i elektroneve, i pari i këtij lloji brenda BRSS.

Një ndër realizimet më të mëdha ishte botimi i “Enciklopedia e Armenisë Sovjetike” (1974 -1988), e përbërë prej 12 volumesh (një volum shtesë ju kushtua vetëm Armenisë Sovjetike). Në prag të pavarësisë së Armenisë dhe menjëherë pas tij arriti të shtypej një

Enciklopedi e re në 4 volume (1990 – 2003), nëpërmjet të cilës u tentua të pastrohej Enciklopedia paraardhëse nga gabimet ideore që mund të kishin zënë vend në të, të korrigjohej dhe të plotësoheshin boshllëqet që mund të viheshin re në të.

Në fushën e letërsisë u krijuan vepra të reja me vlera të rëndësishme nga Avetik Isahakian, Terenik Demirçian, Hrashja Koçar, Lerr Kamsar, Stepan Zorian, Gurgun Mahar, etj. Ndër shkrimtarët e brezit të ri, veçanërisht të njohur u bënë poetët Hovhanes Shiraz, Parujr Sevak, Silva Kaputikian, Vahak Datian, Kevork Emin, Hamo Sahian, etj., ndërsa ndër prozatorët, Hrant Matevosian, Musheh Galshojan, Sero Hanzadian, Vartkes Petrosian, etj.

Kohët e reja kërkonin zgjidhje të reja urbanistike dhe arkitekturore për qytetet, gjë që u realizua me sukses nga arkitektët Armenë, duke kombinuar arkitekturën tradicionale me atë të epokës moderne. U ngritën ndërtesa me vlera të konsiderueshme funksionale dhe artistike si p.sh. ndërtesa e Matenadaranit (Biblioteka e shkrimeve të vjetra) dhe ndërtesa e Muzeut Shtetëror Historik Kombëtar, Përmendoret e Viktimave të Genocidit Armen dhe ajo e Betejës heroike të Sardarapatit. U ndërtua i ri stadiumi “Hrazdan”, dhe aeroporti “Zvartnoc”, metroja nëntokësore e Jerevanit, kompleksi sportiv-koncertainal, etj. Ndër arkitektët më në zë të kohës ishin: Rafael Israelian, Mark Grigorian, Garo Halapian, Xhim Torosian, Sashur Kalashian dhe të tjerë.

Në fushën e skulpturës lanë gjurmën e tyre Jervant Koçar, Nikollaj Nikohosian, Levon Tokmaxhian e të tjerë.

Zhvillime të dukshme pati edhe fusha e Arteve Figurative (Artet e Bukura) ku u shquan Martiros Sarian, Grigor Hanxhian, Minas Avedisian, Jetvart (Eduard) Isabegian, Hagop Hagopian e të tjerë.

Krahas përfaqësuesve të njohur në fushën e teatrit si Vagram Papazian, Hrashja Nersisian, Avet Avetian, dolën në pah edhe përfaqësues të brezit të ri si Metaksia Simonian, Babgen Nersisian, Horen Abrahamian, Sos Sarkisian, Mher Mëgërđician, Vartuhi Varteresian, Karp Haçvankian, Armen Xhikarhanian, etj.

U prodhuan një sërë filmash me vlera të larta si “Prijësi”, “Cori Miron”, “Ne jemi shkëmbinjtë tanë”, “Kënga e ditëve të shkuara”, “Ngjyra e tyre”, etj. Gjatë kësaj periudhe u dalluan aktorët Henrik Malian, Frunze Tonlatian, Sergej Paraxhanov, etj.

Në fushën e muzikës, përfaqësuesit më të shquar u bënë Aram Haçatryan, Arrno Babaxhanian, Avet Terterian, Jetvart (Eduard) Mirzojan, Tigran Mansurian, Robert Amirhanian, etj.. Ndër këngëtarët u shquan Lusine Zakarian, Kohar Kasparian, Hajrik Muratian, Hovhanes Patalian, Ofelia Hamparcumian, Ruben Matevosian, etj.

Pas pavarësimit të Armenisë, u krijuan mundësitë për një zhvillim të lirë dhe të pakufizuar nga ana ideologjike. Por ndërkohë, gjendja e luftës, pasojat e tërmetit shkatërrimtar dhe bllokada e vendosur nga vendet kufitare armike krijuan kushte të vështira ekonomiko-shoqërore, të cilat frenuan rrjedhën natyrale të zhvillimit të jetës në Armeni. Në fushën e kulturës, madje, u krijua një situatë tepër e vështirë, mund të thuash me plot gojë një situatë krize; u larguan nga vendi me mijëra intelektualë, u mbyllën një sërë institucionesh kërkimoro-shkencore dhe biblioteka publike. Intelektualët e mbetur brenda vendit u përpoqën të ruanin vlerat e krijuara me sakrifica tepër të mëdha.

Në fundin e viteve 1990, gradualisht filloi të stabilizohej jeta ekonomiko-shoqërore e vendit, gjë që ndikoi pozitivisht në jetën kulturore-shkencore të vendit. Gradualisht u rimëkëmbën dhe morën rrugën e ngjitjes shumë nga sferat e jetës.

Pavarësia krijoi mundësinë që në mënyrë të lirë dhe pa pengesa t’i riktheheshin disa çështjeve themelore që i përkisnin historisë së Armenisë (si lindi kombi Armen, historia e kohëve të vjetra, çështjes Armene dhe Genocidit Armen, Republikës së parë Armene, historisë së Kishës Armene, etj), të cilat ishin bllokuar ose nuk ishin lejuar të trajtoheshin në vitet e qeverisë sovjetike.

## Kultura në Diasporën Armene

Për shkak të Genocidit, përpara Armenëve të shpërndarë në të gjithë botën, një nga çështjet themelore ishte ruajtja e ekzistencës. Së pari duheshin siguruar kushtet për mbajtjen gjallë të elementit njerëzor të të gjitha moshave, pas së cilës, si çështje themelore dilte ruajtja e identitetit Armen të brezit të ri që po rritej.

Pavarësisht tërë këtyre vështirësive, në vitet 1920, brenda Diasporës u shënuan arritje kulturore. U hapën me qindra shkolla, të cilat u bënë garancia kryesore për edukimin e brezit të ri me kulturën Armene.

Veçanërisht i madh ishte roli i shtypit periodik. Krahas shtypshkrimeve të periudhës para Genocidit, u shfaqën edhe shtypshkrime të reja. Sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, shtypi periodik i Diasporës mori një hov të madh; në vitet 1980, brenda Diasporës botoheshin rreth 225 emra periodikësh, kishte orë transmetimi radiofonike në gjuhën Armene. Në vitet 1990 u bënë të dukshme, gjithashtu, edhe stacione televizive Armene, të cilat luanin një rol të madh në ruajtjen e identitetit Armen.


Përveç Armenologëve, përfaqësues të degëve të ndryshme të shkencës dhe kulturës, si për shembull juristët, u përfshinë në shkencën dhe kulturën e vendeve ku ata banonin, dhe kjo është një nga arsytet që ata shpesh nuk përmenden si përfaqësues të shkencës dhe kulturës Armene.

Ekzistenca e kulturës Armene brenda diasporës lidhet kryesisht me letërsinë dhe Armenologjinë. Pas sovjetizimit të Armenisë, brenda diasporës, veprimtarinë e tyre e vazhdoi Armenologu shumë i njohur Nikollaj Atonc, duke themeluar brenda universitetit të Brukselit degën e Armenologjisë. Sot, brenda universiteteve në shumë vende të botës, veprojnë bërthama Armenologjie, të cilat në bashkëpunim me institucionet studimore Armene të Armenologjisë, mund të arrijnë rezultate të larta në rang botëror në fushën e gjuhësisë.

Letërsia e Diasporës nxorri një plejadë të talentuar përfaqësuesish si Avetis Aharonian, Levon Shant, Jervant Otjan, Zabel Jesajan, Vasken Shushanian, Shahan Shahnur, Vahan Tekejan, Arshak Çobanian, Jenovk



Nikolas Atonc



Uilliam Sarojan



Sharl Aznavur

Armen, Uiljam Sarojan, Hamasteh, Aram Hajkaz, Vahe Hajk, Antranik Xarukian, Musheh Ishhan, Vahr-Vahjan dhe të tjerë.

Armenët e Diasporës u dalluan edhe në fushën e artit në vendet ku aktualisht banonin. Ndër ta mund të përmendim aktorët e njohur në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare të filmave, si Ruben Mamulian dhe Ashot Malakian (Anri Verno), kompozitorët Alan Hovhanes dhe Zhorzh Garvarianc, këngëtarët Rozi Armen, Lili Xhugasian, Liz Sarian dhe të tjerë. Sot aktualisht vazhdon të gëzojë një famë të madhe si këngëtar dhe kompozitor, artisti i madh Sharl Aznavour.

Pas arritjes së pavarësisë së Armenisë nga B.R.S.S., panorama e diasporës pësoi një ndryshim të madh si rezultat i emigrimit nga Armenia të rreth një milion banorëve Armenë, brenda të cilëve kishte me mijëra intelektualë. Sot ata vazhdojnë të japin kontributin e tyre në ruajtjen e kulturës Armene brenda kushteve të Diasporës.


- Fund -








FUSHATAT E ALEKSANDRIT TË MADH DHE ARMENIA




ARMENIA NË SHEKULLIN E II-TË PARA KRISHTIT






ARMENIA NË VITET 298 DERI 387






ARMENIA NË SHEKUJT VII – IX




MBRETËRIA BAGRATIDE NË PERIUdhËN E ASHOTIT TË I-RË DHE SIMBADIT TË I-RË



PRINCIPATA E ZAKARIANËVE



# SHTETI ARMENI KILIKISË NË PERIU DHËN E LEVONIT TË MADHËRISHËM



CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Movsisyan, Artak

Historia e Armenisë, Artak Movsisyan ; përkth. nga origj.,  
përshtat e red. Berzh Piranjani. - Tiranë : Albpaper, 2019  
228 f. : me foto ; 14 x 21 cm.

ISBN: 978-9928-05-266-7

1.Historia 2.Armeni

94(479.25)





Çmimi 900 Lekë